

RREGULLORJA E BURSËS SHQIPTARE TË
TITUJVE

TABELA E PËRMBAJTJES

KAPITULLI 1: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	6
1.1. PËRKUFIZIME.....	6
1.2. INTERPRETIMI.....	9
1.3. GJUHA	10
1.4. ZBATIMI DHE NDRYSHIMI I RREGULLORES	10
1.5. PUBLIKIMI DHE KOMUNIKIMET	11
1.6. DETYRIMET E ALSE SI TREG I RREGULLUAR.....	11
1.7. PËRJASHTIMI I PËRGJEGJËSISË.....	12
1.8. KONFIDENCIALITETI I INFORMACIONIT	12
1.9. HYRJA NË FUQI	13
KAPITULLI 2: ANËTARËSIMI NË BURSËN SHQIPTARE TË TITUJVE	14
2.1. ANËTARËSIMI DHE KATEGORITË E ANËTARËSIMIT NË ALSE.....	14
2101 Anëtarësimi në ALSE	14
2102 Kategoritë e Anëtarësimi	14
2.2. KËRKESAT PËR ANËTARËSIMIN NË ALSE.....	14
2201 Kriteret e Pranueshmërisë për Anëtarësim	14
2202 Llojet e Anëtarësimi në ALSE	15
2203 Brokerat e Bursës	15
2204 Përdoruesit/Brokerat në Sistemin ETS	16
2.3. PROCEDURA E APLIKIMIT	16
2301 Depozitimi i Aplikimit	16
2302 Dosja e Aplikimit	17
2303 Vendimi për Aplikimin	17
2.4. DETYRIMET E VAZHDUESHME TË ANËTARËVE	17
2401 Anëtarët	17
2402 Përdoruesit në Sistemin ETS.....	18
2.5. REGJISTRI I ANËTARËVE	19
2.6. NDËRPRERJA E STATUSIT TË ANËTARIT DHE PEZULLIMI NGA TREGTIMIT NË ALSE.....	19
2601 Mënyra e Ndërprerjes së Statusit të një Anëtar	19
2602 Dorëheqja e një Anëtar	19
2603 Pezullimi dhe Largimi i një Anëtar	19
2604 Dorëheqja e një Brokeri	21
2605 Pezullimi i një Brokeri.....	22
2606 Njoftimi i Dorëheqjes, Pezullimit dhe Përfundimit të Anëtarësimi.....	22
KAPITULLI 3: RREGULLAT E AKSESIT NË TREG	23
3.1. AKSESI NË TREG PËR PJESËMARRËSIT.....	23
3101 Kriteret për Pjesëmarrësit në Treg.....	23
3102 Llojet e Pjesëmarrësve në Treg.....	23
3103 Mënyrat e Aksesit në Treg	23
3.2. AKSESI ELEKTRONIK PËR ANËTARËT E ALSE	23
3205 Aksesimi në Sistemin ETS nëpërmjet Terminalit “Observer”	24
3.3. MJETET E AKSESIMIT ELEKTRONIK PËR KLIENETËT	24
KAPITULLI 4: RREGULLAT E TREGTIMIT TË TITUJVE	26
4.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	26
4101 Objekti i Kapitullit 4	26
4102 Ditët e Tregtimit dhe Oraret e Tregtimit.....	26
4103 Valuta e Tregtimit	26
4104 Simbolet e Tregtimit	26
4105 Rregullat dhe kërkesat e Sistemit	26
4106 Përgjegjësia e Anëtarit.....	26
4.2. STATUSI I TREGTIMIT.....	26
4201 Statusi i Tregtimit të Anëtarit.....	26
4202 Statusi i Tregtimit të Titujve.....	26
4203 Statusi i Urdhrave	27
4.3. URDRAT	27
4301 Objekti i Seksionit 4.3	27
4302 Kërkesat dhe Kushtet e Përgjithshme	27
4303 Llojet e Urdhrave.....	29

4304 Parametrat e Urdhrave	29
4305 Mënryra e Ekzekutimit dhe Menaxhimit të Urdhrave.....	30
4306 Përparësia e Ekzekutimit të Urdhrave	30
4307 Llogaritë e Tregtimit	30
4.4. ÇIKLET E TREGTIMIT NË LIBRIN QËNDROR TË URDRHAVE (COB).....	31
4401 Përshkrim i Përgjithshëm	31
4402 Tregtimi i Vazhdueshëm	32
4403 Ankandet	32
4404 Menaxhimi i Librit të Urdhrave pas Tregtimit	32
4405 Tregtimi në Bllok	32
4406 Tregtimi Jashtë Orarit Zyrtar	33
4.5. MEKANIZMAT E TREGUT	34
4501 Përputhja dhe Ekzekutimi i Urdhrave në Librin Qendror të Urdhrave	34
4502 Transaksionet e Kryqëzuara	34
4503 Kufizimet e Çmimit, Urdhrave dhe Ndëprerjet e Tregtimit.....	35
4504 Pezullimet e Tregtimit	36
4505 Anulimi ose Ndryshimi i Tregtimit.....	37
4.6. KONFIRMIMI, RAPORTIMI DHE PUBLIKIMI	38
4601 Konfirmimi	38
4602 Raportimi i Transaksioneve	38
4603 Publikimi	38
4.7. KLERIMI DHE SHLYERJA	39
4701 Institucionet e Klerimit dhe Shlyerjes	39
4702 Kushtet e Shlyerjes së Transaksioneve në ALSE	39
4703 Klerimi dhe Shlyerja për Transaksionet në Bursë dhe Jashtë Burse	40
4704 Përcjellja e Informacionit Institucioneve të Klerimit dhe Shlyerjes	40
4705 Formati i Informacionit	40
4706 Parimi DVP për Klerimin dhe Shlyerjen	40
4707 Periudha e Klerimit dhe Shlyerjes	40
4708 Procedurat në rast Dështimi (default)	40
KAPITULLI 5: SEGMENTET E TREGUT DHE KLASIFIKIMI I TITUJVE	41
5.1. SEGMENTET DHE NËNSEGMENTET	41
5101 Segmentet e Tregut.....	41
5102 Nënsegmentet e Tregut sipas Titujve	41
5.2. KLASIFIKIMI DHE TRANSFERIMI I TITUJVE NË SEGMENTET E TREGUT	42
5201 Vendimmarrja për Klasifikimin e Titujve.....	42
5202 Fillimi i Tregtimit të Titujve	42
5203 Transferimi i Titujve në Segmentet e Tregut	42
KAPITULLI 6: PRANIMI NË LISTIM/TREGTIM DHE DETYRIMET E VAZHUESHME TË EMETUESVE .	44
6.1. OBJEKTI I KAPITULLIT 6.....	44
6101 Dispozita të Përgjithshme	44
6102 Përkufizimi i Pranimin në Listim dhe Tregtim	44
6103 Vazhdimësia e Listimit/Tregtimit	44
6104 Detyrimet e Emetuesve	44
6105 Raportimi mbi Emetuesin tek AMF.....	45
6.2. PROCEDURA E APLIKIMIT NGA EMETUESI	45
6201 Formulari i Aplikimit të Emetuesit	45
6202 Grafiku Kohor	45
6203 Agjenti i Listimit/Tregtimit.....	45
6204 Aplikimi për Listimin/Tregtimin e Dëftesave të Depozitari të Titujve	45
6205 Kërkesat shtesë për Listim/Tregtim.....	45
6.3. MARRJA E VENDIMIT NGA ALSE	45
6301 Periudha për marrjen e vendimit	45
6302 Vlefshmëria e Vendimit.....	45
6303 Njoftimi për Pranimin në Listim/Tregtim	46
6.4. ARSYET PËR REFUZIM.....	46
6401 Refuzimi i Aplikantit për Listim/Tregtim	46
6402 Informimi i Aplikantit për Refuzimin	46
6403 Apelimi i Vendimit të Refuzimit	46
6.5. DOKUMENTACIONI I PËRGJITHSHËM QË DUHET TË JEPET NË KOHËN E APLIKIMIT.....	46
6.6. KËRKESAT E PËRGJITHSHME TË LISTIMIT/TREGTIMIT PËR TITUJ T	47
6601 Kërkesa për Listim në Listën Zyrtare të ALSE dhe Tregtimi i Titujve	47

6.7. KËRKESA SHITESË LISTIMIN/TREGTIMIN E KLASAVE TË VEÇANTA TË TITUJVE	49
6702 Aksionet, Dëftesat e Depozitarit për Aksionet dhe Titujt e Kapitalit	49
6703 Obligacionet dhe Titujt të tjerë Afatshkurtër Borxhi	50
6704 Kuotat e Shoqërive të Investimit të Emetuara nga Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive	52
6705 Fondet e Investimit dhe Fondet e Investimit të Tregtuara Elektronikisht në Bursë të Emetuara nga Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive	53
6706 Tituj të Tjerë të Transferueshëm	53
6.8. MASAT PËR LISTIMIN/TREGTIMIN	53
6801 Të Përgjithshme.....	53
6802 Ndarjet Specifike - Segmenti i Rikuperimit dhe Segmenti Nën-Mbikëqyrje	53
6803 Heqja nga Listimi dhe/ose Tregtimi.....	53
6.9. DETYRIMET E VAZHUESHME	55
6901 Dispozita të Përgjithshme	55
6902 Listimi/Tregtimi i Titujve të së Njëjtës Klasë të Emetuar Rishtazi.....	55
6903 Marrëdhëniet me Investitorët	55
6904 Administrimi i Veprimeve Korporative dhe i Veprimeve të Tjera me Tituj.....	55
KAPITULLI 7: KOMISIONI DHE PROCEDURAT E ARBITRAZHIT	57
7.1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	57
7101 Trajtimi i Mosmarrëveshjeve	57
7102 Paanshmëria në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve	57
7103 Selia e Komisionit të Arbitrazhit	57
7.2. PËRBËRJA E KOMISIONIT TË ARBITRAZHIT	57
7201 Përbërja e Komisionit të Arbitrazhit	57
7202 Sekretari i Komisionit të Arbitrazhit	58
7.3. VENDIMARRJA E KOMISIONIT TË ARBITRAZHIT	58
7301 Panelet e Arbitrazhit.....	58
7302 Fusha e Veprimtarisë së Paneleve	58
7.4. HAPJA E PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT.....	58
7401 Ankimi për Mosmarrëveshjen	58
7402 Mbrojtja ndaj Ankimeve.....	58
7.5. EMËRIMI I PANELIT TË ARBITRAZHIT	59
7501 Emërimi i Arbitrave.....	59
7502 Pavarësia e Arbitrave.....	59
7.6. SEANCAT E PANELIT TË ARBITRAZHIT	59
7601 Seancat e Arbitrazhit.....	59
7602 Procesverbali	59
7.7. VENDIMI I PANELIT TË ARBITRAZHIT	60
7701 Zgjidhja e Mosmarrëveshjes me Mirëkuptim.....	60
7702 Vendimi i Arbitrazhit.....	60
7.8. SHPENZIMET DHE TARIFAT E PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT.....	60
7801 Përgjegjësia për Mbulimin e Shpenzimeve të Arbitrazhit.....	60
7.9. RËNDËSIA E VENDIMIT TË ARBITRAZHIT	60
7901 Zbatimi i Vendimit të Arbitrazhit	60
KAPITULLI 8: MONITORIMI I ANËTARËVE TË ALSE	62
8.1. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR ZBULIMIN DHE PARANDALIMIN E ABUZIMIT ME TREGUN	62
8101 Objekti i Kapitullit	62
8102 Ndalimi i Abuzimit me Tregun në ALSE	62
8103 Parandalimi dhe Zbulimi i Manipulimit me Tregun	62
8104 Roli i Sistemit të Informacionit në Parandalimin dhe Zbulimin e Manipulimit të Tregut	63
8.2. MONITORIMI I ANËTARËVE DHE TRANSAKSIONEVE NË ALSE.....	63
8201 Monitorimi i Anëtarëve	63
8202 Monitorimi i Transaksioneve	64
KAPITULLI 9: RREGULLAT E SJELLJES.....	66
9.1. TË PËRGJITHSHME	66
9101 Objekti i Kapitullit	66
9102 Detyrimet e Përgjithshme të Integritetit, Trajtimit të Drejtë dhe Kujdesit	66
9103 Bashkëpunimi me ALSE	66
9104 Moslejimi i Mashtrimit ose Keqinformimit	66
9105 Përdorimi i Sistemit të Tregtimit të ALSE	67
9106 Kontrolllet e Brendshme	67
9.2. GJURMUESHMËRIA E AUDITIMIT	68

9201 Regjistrimi i Detajeve të Urdhrit.....	68
9202 Mbajtja e Informacionit.....	69
KAPITULLI 10: MASAT NË RASTIN E SHKELJES SË RREGULLAVE.....	70
10.1. OBJEKTI I KAPITULLIT 10	70
10103 Masa të Menjëhershme.....	70
10.2. PROCEDURA.....	70
10201 Shqyrtimi	70
10202 Konfidencialiteti.....	70
10203 Raporti	70
10204 Takimi Sqarues.....	71
10.3. KORRIGJIMI, PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI	71
10.4. RAPORTIMI DHE PUBLIKIMI	72
10401 Raportimi	72
10402 Shkelja e Ligjeve Shqiptare	72
10.5. PËRGJEGJËSIA PAS PËRFUNDIMIT TË ANËTARËSIMIT OSE PAS DORËHEQJES	72
KAPITULLI 11: KOMITETI I DISIPLINËS	73
11.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	73
11101 Trajtimi i Rasteve për Shkelje	73
11102 Paanshmëria në Marrjen e Vendimeve.....	73
11103 Selia e Komitetit të Disiplinës.....	73
11.2. PËRBËRJA E KOMITETIT TË DISIPLINËS	73
11201 Përbërja e Komitetit të Disiplinës	73
11202 Sekretari i Komitetit të Disiplinës.....	74
11.3. VENDIMARRJA E KOMITETIT TË DISIPLINËS.....	74
11301 Vendimarrja	74
11302 Fusha e Veprimtarisë së Komitetit të Disiplinës.....	74
11.4. NISJA E MBLEDHJES SË KOMITETIT TË DISIPLINËS	75
11401 Kërkesa për Marrjen e Masave Penalizuese	75
11.5. SEANCAT E PANELIT TË KOMITETIT TË DISIPLINËS	75
11501 Seancat e Komitetit të Disiplinës.....	75
11502 Procesverbali	75
11.6. VENDIMI I KOMITETIT TË DISIPLINËS	75
11601 Vendimi i Komitetit të Disiplinës.....	75
11.7. SHPENZIMET DHE TARIFAT E PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT	76
11701 Përgjegjësia për Mbulimin e Shpenzimeve të Arbitrazhit	76
11.8. RËNDËSIA E VENDIMIT TË KOMITETIT TË DISIPLINËS.....	76
11801 Zbatimi i Vendimit të Komitetit të Disiplinës	76
SHTOJCA.....	78
Shtojca 1 Marrëveshje Pranimi për Anëtarësim në Bursa Shqiptare e Titujve ALSE.....	78
Shtojca 1.1 Formular Aplikimi për Anëtarësim në Bursa Shqiptare e Titujve ALSE	79
Shtojca 2 Komisione dhe Tarifa të Bursa Shqiptare e Titujve ALSE (LEK).....	82
Shtojca 2.1 Përmbledhje e Komisioneve dhe Tarifave sipas Kategorisë së Anëtarësimit	85
Shtojca 4 Marrëveshje Pranimi për Listim/Tregtim në Bursa Shqiptare e Titujve ALSE	86
Shtojca 4.1 Marrëveshje Pranimi për Listim/Tregtim në Bursa Shqiptare e Titujve ALSE	87
Shtojca 5 Kostot e Arbitrazhit për t'u Paguar tek Bursa Shqiptare e Titujve ALSE nga Palët në Mosmarrëveshje	90
Shtojca 6 Kostot e Komitetit të Disiplinës për t'u Paguar tek Bursa Shqiptare e Titujve ALSE nga Palët përkatëse.....	91

KAPITULLI 1: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

SEKSIONI 1.1. PËRKUFIZIME

Në këtë Rregullore, termat që fillojnë me germë të madhe kanë kuptimet në vijim, nëse nuk parashikohet ndryshe në mënyrë specifike:

"Marrëveshje Pranimi": një marrëveshje me shkrim e lidhur ndërmjet ALSE dhe një Anëtarit ose një Anëtarit kandidat, me anë të së cilës Anëtarit ose Anëtarit kandidat, sipas rastit, bëhet ose aplikon për t'u bërë Anëtar dhe pranon, ndër të tjera, t'i përmbahet në çdo kohë Rregulloreve, Udhëzimeve dhe Njoftimeve në fuqi apo dhe ato të cilat do të nxirren rishtazi nga ALSE;

"Titull i Pranuar në Tregtim (ose titull i tregtuar)": çdo Titull i listuar në listën zyrtare të ALSE dhe i pranuar për t'u tregtuar në tregjet e ALSE, në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 "*Për Titujt*";

"Titull i Pranuar në Listim (ose titull i listuar)": çdo Titull i regjistruar në listën zyrtare të ALSE, në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 "*Për Titujt*";

"AFISaR": Sistemi Qendror i Regjistrimit dhe Shlyerjes së Titujve, i cili është shtëpia e klerimit për Titujt e emetuar nga Qeveria në Republikën e Shqipërisë, i cili administrohet dhe operohet nga Banka e Shqipërisë (banka qendrore);

"AMF": Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si autoriteti kompetent shqiptar për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të Titujve në Shqipëri;

"Ligjet Shqiptare": secili veç e veç, dhe tërësia e ligjeve e rregulloreve të zbatueshme në Shqipëri;

"Bursa Shqiptare e Titujve - ALSE": tregu i rregulluar shqiptar i bursës së Titujve, që zotërohet dhe operohet nga Bursa Shqiptare e Titujve ALSE sh.a., një shoqëri aksionare e organizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe e licencuar nga AMF për të vepruar si bursë;

"Tregu ALSE": Bursa Shqiptare e Titujve – ALSE.

"Regjistri Shqiptar i Titujve - ALREG": një shtëpi klerimi dhe regjistrimi Titujsh, që zotërohet dhe operohet nga Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG sh.a., një shoqëri aksionare e organizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe e licencuar nga AMF dhe Banka e Shqipërisë për të kryer regjistrimin, klerimin dhe shlyerjen e Titujve të ndryshëm nga ato të emetuara nga Qeveria Shqiptare;

"Aplikant": një Emetues që bën një kërkesë ose aplikon për pranim në listimin dhe/ose në tregtimin e Titujve të tij në ALSE;

"Formular Aplikimi": një formular i depozituar nga një Aplikant pranë ALSE, ku kërkon pranimin në listim dhe/ose tregtim të Titujve, në mënyrë të veçantë ku përcaktohen angazhimet e Aplikantit përballë ALSE në lidhje me këtë proces;

"Sistem i Automatizuar i Orientimit të Urdhrave (AutORS)": çdo sistem kompjuterësh, softuerësh ose pajisjesh të tjera, i cili mundëson që urdhrat të dërgohen nga një Klient (Pjesëmarrës i Sponsorizuar) tek një Anëtar (Sponsor) dhe të përcillen në Sistemin ETS pa ndërhyrjen thelbësore të njerëzve;

"Çmimi më i Mirë": për transaksionet e kryera në Tituj është çmimi më i lartë në anën e Blerjes dhe çmimi më i ulët në anën e Shitjes së tregtimeve (urdhrave) të paraqitura nga pjesëmarrësit e tregut që janë pjesë e këtyre transaksioneve;

"Transaksion në Bllok": në lidhje me ALSE, është çdo transaksion i llojit të përcaktuar në Nenin 4405 të kësaj Rregulloreje;

"Këshilli": Këshilli Mbikëqyrës i ALSE;

"Broker": një individ i licencuar nga AMF në bazë të Ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 "*Për Titujt*", i cili punësohet nga një Anëtar dhe autorizohet prej tij që të regjistrohet në ALSE për të vepruar si personi përgjegjës për tregtimin në emër të Anëtarit që e ka caktuar dhe të klientëve të këtij Anëtar;

"Shoqëri Komisionere": çdo Person juridik që është i licencuar nga AMF për të ushtruar aktivitetin në tregun e Titujve, në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 "*Për Titujt*";

"Rregullorja e Klerimit dhe Shlyerjes": është Rregullorja e Klerimit dhe Shlyerjes e nxjerrë nga ALREG, e cila rregullon veprimet e klerimit dhe shlyerjes së ALREG dhe është miratuar nga AMF;

"Libri Qendror i Urdhrave (COB)": libri i urdhrave i Sistemit ETS, në të cilin regjistrohen të gjithë urdhrat dhe ndryshimet deri në përputhjen, skadimin ose tërheqjen e tyre;

"Marrëveshje Klerimi dhe Shlyerjeje": marrëveshja me shkrim ku përcaktohen, midis të tjerash, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të një Anëtarit dhe të një Agjenti të Klerimit dhe Shlyerjes (CSM) në lidhje me klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve të ekzekutuara në zbatim të Nenit 4702 të kësaj Rregulloreje;

"Institucion Klerimi dhe Shlyerjeje": ALREG, AFISaR ose çdo shtëpi klerimi e caktuar nga ALSE dhe e autorizuar dhe/ose e njohur ligjërisht nga Autoriteti Kompetent përkatës për klerimin e transaksioneve në Tituj dhe/ose në mjete monetare (*cash*), sipas rastit;

"Autorizim Klerimi dhe Shlyerjeje": një deklaratë e bërë në formën e përcaktuar nga ALSE, që bëhet nga një Anëtar në favor të një Agjenti Klerimi dhe Shlyerjes (CSM), ku shprehet se Anëtarit ka caktuar CSM-në që të veprojë në emër të tij për të kleruar dhe shlyer transaksionet që Anëtarit në fjalë ka ekzekutuar në ALSE;

"Agjent Klerimi dhe Shlyerjeje (CSM)": çdo bankë dhe/ose shoqëri komisionere e licensuar nga AMF dhe e autorizuar nga Institucioni i Klerimit dhe Shlyerjes për klerimin e transaksioneve në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Rregulloreje dhe të Rregullores së Klerimit dhe Shlyerjes;

"Klient": çdo Person që përdor shërbimet e një Anëtarit në lidhje me një ose më shumë urdhra blerje ose shitje të një ose më shumë Titujve të Pranuar në Tregtim;

"Kontrolle": në kuptim të kësaj Rregullore do të kuptojë shqyrtimin edhe një herë me kujdes i një pune, zhvillimin procesi apo procedurë etj, rishikimi i vëmendshëm i dokumenteve a i diçkaje tjetër për të parë gjendjen, dhe/apo për nxjerrjen e përfundimeve të sakta/të vërteta; kontroll i detajuar i të gjithë proceseve të punës të cilat lidhen me objektin e ushtrimit të aktivitetit të subjektit i cili është i Anëtarësuar dhe/apo titujt e të cilit janë listuar apo tregtohen në tregun e Bursës ALSE;

"Shoqëri Investimi" (closed-ended fund): sipërmarrje me pjesëmarrje të mbyllur, të cilat janë themeluar dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 "*Për sipërmarrjet e investimeve kolektive*", i ndryshuar;

"Autoritet Kompetent": autoriteti publik ose organi rregullator që ka juridiksion mbi çështjen përkatëse;

"Tregtim i Kryqëzuar": një transaksion i ekzekutuar në përputhje me kërkesat (përfshirë ato në lidhje me çmimin) e përcaktuara në Rregullore sipas të cilave i njëjti Anëtar ekzekuton transaksionet në Tituj ndërmjet llogarive të cilat administrohen nga vetë Anëtarit;

"Dëftesa Depozitari" janë ato instrumente financiare të cilat janë të negociueshme në tregun e kapitalit dhe të cilat përfaqësojnë pronësinë e instrumenteve financiare të një emetuesi të huaj, por që mund të pranohen për tregtim në një treg të rregulluar dhe që tregtohen në mënyrë të pavarur nga instrumentet financiare të emetuesit të huaj;

"Sistemi Elektronik i Tregtimit (ETS)": është platforma elektronike e tregtimit që kryen tregtimin (përputhjen e urdhrave) e të gjithë Titujve të tregtuar në ALSE, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, menaxhimin e AutORS dhe të COB.

"Shteti i Originës": shteti në të cilin një Person ka zyrën e tij të regjistruar, ose në mungesë të saj, selinë ose, në rastin e një individi, shteti në të cilin ky individ ka vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë tregtare;

"Terminal Individual Tregtimi (ITW)": çdo identifikues i aksesit në treg që i caktohet një Brokери në Bursë për të kryer veprime në Sistemin ETS për të cilin ai është përgjegjës;

"Kuotë Fondi Investimesh": një certifikatë pjesëmarrjeje në një Fond Investimi;

"Emetues": çdo person juridik, Titujt e të cilit (ose çdo klasë Titujsh) janë pranuar ose i nënshtrohen një aplikimi për t'u pranuar në listim dhe/ose tregtim në ALSE;

"Agjent Listimi/Tregtimi": një person juridik i caktuar nga Emetuesi për të ndihmuar dhe udhëzuar Emetuesin përkatës në lidhje me pranimin në listim dhe/ose tregtimin e Titujve të tij në ALSE;

"Marrëveshje Listimi": një marrëveshje që duhet të lidhet ndërmjet Emetuesit dhe ALSE përpara pranimit në listim, sipas së cilës Emetuesi pranon se është i detyruar ligjërisht të zbatojë Rregulloren e ALSE;

"Kapitalizimi i Tregut": në lidhje me një Titull të veçantë në një ditë të veçantë:

- (i) çmimi i shumëzuar me numrin e Titujve të atij lloji të caktuar, në një periudhë kohe të caktuar, duke qenë objekt i një numri total maksimal të Titujve të atij lloji të tregtuar në ALSE, ose
- (ii) në rastin e Obligacioneve, vlera e përfituar nga shumëzimi i vlerës nominale të një Titulli të caktuar me sasinë totale të emetuar dhe të pa shlyer ende për atë Titull;

"Anëtar": çdo Person që është Anëtarësuar në ALSE dhe Anëtarësimi i të cilit nuk ka përfunduar ende;

"Njoftim/Udhëzim": çdo komunikim i shkruar, me etiketën "Njoftim", i nxjerrë nga ALSE në përgjithësi për Anëtarët apo Emetuesit apo për ndonjë lloj kategorie Anëtarësh apo Emetuesish, për qëllime të interpretimit apo zbatimit të Rregulloreve dhe udhëzimeve apo për çdo qëllim tjetër të parashikuar në këtë Rregullore;

"Fond Investimi (open-ended fund)": sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur të themeluara në përputhje me ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", me ndryshimet e herëpashershme të tij.

"Transaksione në Bursë": janë transaksione në Tituj, të kryera ndërmjet Anëtarëve të ALSE për llogari të tyre dhe klientëve të tyre në Tregun ALSE dhe nëpërmjet Sistemit ETS brenda orareve zyrtare të tregtimit.

"Transaksione jashtë Burse": janë transaksione në Tituj, të kryera ndërmjet Anëtarëve të ALSE për llogari të tyre dhe klientëve të tyre, jashtë tregjeve të organizuara të Titujve dhe jashtë orareve zyrtare të tregtimit në Bursë (*p.sh. transaksione të negociuara, Marrëveshje Riblerjeje, Marrëveshje Riblerjeje e Anasjelltë, etj.*).

"Person": çdo individ, korporatë, partneritet, shoqëri apo subjekt, siç pranohet apo kërkohet nga konteksti;

"Segmenti i Rikuperimit": një ndarje e veçantë që mbahet nga ALSE, ku grupohen Emetuesit që u nënshtrohen procedurave të paafëtisë paguese;

"Rregullorja": tërësia e rregullave të përcaktuara në këtë Libër Rregullash, të interpretuara apo të zbatuara me anë të Njoftimeve/Udhëzimeve;

"Listë e Sanksioneve": lista që përmban emrat dhe të dhënat e identifikimit të të gjithë personave, grupeve dhe subjekteve, të cilët janë objekt i kufizimeve financiare, sanksioneve ose masave të tjera të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë nr. 718, datë 29.10.2004 të Shqipërisë "*Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit*";

"Titull": çdo Titull i transferueshëm i njohur shprehimisht si i tillë ose i përcaktuar nga AMF në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.02.2008 "*Për Titujt*", me ndryshimet e herëpashershme të tij;

"Akses i Sponsorizuar": në lidhje me veprimtaritë e një Klienti dhe vetëm për qëllimet e kësaj Rregulloreje, është një mënyrë aksesit e kryer përmes një AutORS, me anë të së cilës ky Klient ("Pjesëmarrësi i Sponsorizuar") mund të përdorë aplikacione të lidhjes së drejtpërdrejtë, me pëlqimin dhe nën përgjegjësinë e një Anëtar ("Anëtar i Sponsorizues"), sipas kushteve të përcaktuara në Seksionin 3.3.;

"Anëtar Sponsorizues": një Anëtar që merr përsipër përgjegjësinë për të gjitha veprimet (sponsorizon) e një Pjesëmarrësi të Sponsorizuar sipas Seksionit 3.3.;

"Pjesëmarrës i Sponsorizuar": një Klient që përfiton nga aplikacionet e lidhjes së drejtpërdrejtë sipas Seksionit 3.3.;

Shënjim kohor (time stamp): është një renditje e karaktereve ose informacioneve të koduara të cilat identifikojnë ndodhjen e një ngjarjeje të caktuar, duke dhënë datën dhe kohën e ditës, ndonjëherë me fraksione sekondash. Në këtë Rregullore nënkupton datën dhe kohën e saktë kur një urdhër është i regjistruar në Librin Qendror të Urdhrave(COB).

"Ditë Tregtimi": çdo ditë kur ALSE është e hapur për tregtim;

"Orare Tregtimi": orët e tregtimit në çdo Ditë Tregtimi, të njoftuara me anë të një Njoftimi të ALSE;

"Transaksion": çdo blerje apo shitje e një Titulli të Tregtuar në ALSE;

"Segment nën-Mbikëqyrje": një ndarje e veçantë që mbahet nga ALSE, ku grupohen Emetuesit që nuk veprojnë në përputhje me Rregulloren;

"Terminali Observer": platforma elektronike, e cila mundëson akses të kufizuar në Sistemin ETS duke u dhënë mundësinë përdoruesve të autorizuar nga ALSE të vëzhgojnë në kohë reale lëvizjen e çmimeve dhe/ose tregtimeve të ekzekutuara;

"Titull Bazë" – një titull i transferueshëm, instrument financiar, indeks, normë interesi, mall ose një shportë apo kombinim i këtyre instrumenteve dhe vlerave, si dhe lloje të tjera të aseteve, nga ku vlera e instrumenteve të tjera financiare bazohet/varion (instrumentet financiare derevativ).

SEKSIONI 1.2. INTERPRETIMI

Neni 1201

Referimet e bëra në ndonjë ligj, rregullore, direktivë ose rregull, duke përfshirë ndryshimet e tyre, do të interpretohen si referime në dispozitat në fuqi në kohën përkatëse.

Neni 1202

Nëse nuk parashikohet specifikisht ndryshe, referimet e ndërthurura në Rregulla, Kapituj ose Seksionet në këtë Rregullore interpretohen se i referohen Kapitujve, Seksioneve ose Neneve të kësaj Rregulloreje.

Neni 1203

Emërtimet e Kapitujve ose të Seksioneve në këtë Rregullore ose në Njoftime/Udhëzime janë vetëm për lehtësi referimi; ato nuk janë pjesë e përmbajtjes së Kapitullit apo Seksionit përkatës dhe për rrjedhojë nuk kanë asnjë ndikim në interpretimin e tyre.

Neni 1204

Termtat që fillojnë me germa kapitale të përdorura në këtë Rregullore interpretohen se i përkasin gjinisë ose numrit që pranon ose kërkon konteksti.

Neni 1205

Termtat që fillojnë me germa kapitale të përkufizuara në Seksionin 1.1 dhe që përdoren por nuk përkufizohen ndryshe në Njoftime/Udhëzime ose komunikime të tjera të ALSE kanë të njëjtin kuptim që u jepet në Seksionin 1.1.

Neni 1206

Nëse nuk parashikohet specifikisht ndryshe, çdo orë që specifikohet në këtë Rregullore ose në Njoftime/Udhëzime apo komunikime të tjera të ALSE është sipas Orës Zyrtare të Evropës Qëndrore (CET).

Neni 1207

Nëse nuk parashikohet specifikisht ndryshe, çdo periudhë kohore e deklaruar në këtë Rregullore ose në Njoftimet/Udhëzimet ose komunikimet e tjera të ALSE llogaritet nga mesnata në mesnatë. Periudhat kohore konsiderohen se fillojnë në ditën pasardhëse të ditës në të cilën ndodh ngjarja që shkakton fillimin e kësaj periudhe. Nëse data në të cilën përfundon periudha në fjalë nuk është Ditë Tregtimi, periudha kohore përkatëse përfundon në Ditën pasardhëse të Tregtimit. Periudhat kohore të deklaruara si muaj ose vite llogariten nga data e nisjes deri në datën që i paraprin datës korresponduese në muajin ose vitin pasardhës përkatës.

SEKSIONI 1.3. GJUHA**Neni 1301**

Kjo Rregullore hartohet në gjuhën shqipe dhe po në këtë gjuhë bëhen edhe Njoftimet/Udhëzimet. Kur konsiderohet e nevojshme, ALSE mund të propozojë përkthimin e kësaj Rregulloreje dhe të Njoftimeve/Udhëzimeve në gjuhë të tjera të huaja. Këto versione gjuhësore janë njëlloj autentike, por në rast mospërputhjeje midis versioneve gjuhësore mbizotëron versioni në shqip.

Neni 1303

Çdo aplikim, depozitim kërkesë dhe çdo korrespondencë e dorëzim dokumentacioni pranë ALSE nga Anëtarët, Emetuesit dhe Anëtarët ose Emetuesit kandidatë do të bëhet në shqip.

SEKSIONI 1.4. ZBATIMI DHE NDRYSHIMI I RREGULLORES**Neni 1401**

Kjo Rregullore zbatohet dhe interpretohet sipas:

- (i) Njoftimeve dhe Udhëzimeve të nxjerra nga ALSE;
- (ii) Vendimeve të veçanta të miratuara nga ALSE dhe Këshilli Mbikëqyrës i ALSE në zbatim të kësaj Rregulloreje.

Njoftimet dhe Udhëzimet hyjnë në fuqi dhe bëhen detyruese pas botimit të tyre nga ALSE në mënyrën e përcaktuar në Nenin 1501 ose në datën që specifikohet në botimin e tyre.

Me qëllim funksionimin e përshtatshëm e të duhur të ALSE dhe për mbrojtjen e interesave të pjesëmarrësve në treg, ALSE mund të ndryshojë Rregulloren, duke përfshirë miratimin e rregullave të tjera shtesë, sa herë që ajo e gjykon se ndryshimet janë të nevojshme ose të përshtatshme.

Çdo ndryshim i rregullores miratohet nga nga ALSE, dhe në çdo rast duke qenë objekt edhe i miratimit nga AMF. Ndryshimet hyjnë në fuqi dhe bëhen detyruese për të gjithë Anëtarët dhe Emetuesit pas botimit të tyre nga ALSE në mënyrën e përcaktuar në Nenin 1501 ose në një datë të mëvonshme që do të specifikohet në ndryshimin e botuar.

Nëse një ndryshim i Rregullores, duke përjashtuar ndryshimet që kërkohen nga Ligjet Shqiptare, nuk dakordësohet dhe/apo nuk përputhet me interesat ose Anëtarëve në përgjithësi apo të një kategorie të caktuar Anëtarësh, atëherë çdo Anëtar i prekur mund ta ndërpresë Anëtarësimin në ALSE me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar ALSE brenda pesë (5) Ditëve Tregtimi nga data e botimit të ndryshimit në fjalë.

SEKSIONI 1.5. PUBLIKIMI DHE KOMUNIKIMET

Neni 1501

ALSE do të garantojë publikimin e kësaj Rregulloreje, të ndryshimeve pasuese të saj dhe të Njoftimeve e Udhëzimeve nëpërmjet shpërndarjes tek Anëtarët e saj dhe/ose Emetuesit apo te çdo kategori përkatëse e Anëtarëve ose Emetuesve, përmes publikimit në faqen zyrtare të internetit, publikimit në botimet periodike të saj ose përmes njoftimeve individuale, sipas rastit.

Neni 1502

Nëse nuk parashikohet specifikisht ndryshe, çdo njoftim ose komunikim tjetër specifik për një Anëtar ose Emetues, që sipas një rregulli ose ligji duhet bërë me shkrim, mund të bëhet me çdo mënyrë komunikimi që krijon ose lejon riprodhimin e tekstit të shkruar ose të printuar të njoftimit.

Çdo njoftim ose komunikim i tillë konsiderohet i marrë kur dërgohet me sukses në adresën e marrësit ose dërgohet me sukses në numrin e tij të faksit ose adresën e postës elektronike, sipas rastit.

Çdo njoftim ose komunikim i tillë drejtuar një Anëtar ose një Emetuesi do të bëhet në adresën e selisë ose në adresën e postës elektronike të specifikuar me shkrim nga ky Anëtar ose Emetues. Për Anëtarët, ky regjistrim duhet bërë sipas Seksionit 2.5, sipas rastit.

SEKSIONI 1.6. DETYRIMET E ALSE SI TREG I RREGULLUAR

Neni 1601

Në zbatim të Ligjeve Shqiptare, ALSE duhet:

- (i) të ketë rregulla të qarta dhe transparente që:
 - (a) parashikojnë kuotim/tregtim të drejtë dhe të rregullt dhe që vendosin kritere objektive për ekzekutimin efikas të urdhrave; dhe
 - (b) garantojnë se Titujt e pranuar për tregtim mund të tregtohen në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe efikase;
- (ii) të vendosë dhe të zbatojë marrëveshje dhe procedura efikase për monitorimin e rregullt të respektimit të Rregullores nga ana e Anëtarëve dhe Emetuesve; dhe
- (iii) të monitorojë aktivitetet e ndërmarrë nga Anëtarët me qëllim identifikimin e shkeljeve të Rregullores, kuotimit/tregtimit të Titujve në kushte jo të rregullta ose të sjelljeve që mund të shkaktojnë abuzim në treg;
- (iv) të vendosë dhe të zbatojë marrëveshje dhe procedura efikase për monitorimin e rregullt të përputhshmërisë së aktivitetit të ALSE me Ligjet Shqiptare.

Neni 1602

Kur sipas gjykimit të ALSE janë zhvilluar apo po zhvillohen rrethana që kërkojnë veprim emergjent dhe, sa herë është e mundur, pas konsultimit me AMF (por në çdo rast pasi t'i jepet njoftim AMF-së), ALSE mund të ndërmarrë hapa të përkohshëm për të parandaluar, korrigjuar ose kontrolluar zhvillimet e mëtejshme të këtyre rrethanave me qëllim mbrojtjen ose rivendosjen e kushteve që mundësojnë respektimin e procedurave të drejta dhe të rregullta të kuotimit/tregtimit, si dhe ekzekutimin efikas të urdhrave. Hapat e ndërmarrë në zbatim të Nenit 1602 shpallen me anë të Njoftimit ose me mënyra që konsiderohen të përshtatshme dhe më pas konfirmohen nëpërmjet Njoftimit.

Neni 1603

Për qëllime të Nenit 1602, "rrethana që kërkojnë veprim emergjent" do të thotë çdo rrethanë e paparashikuar që çënon ose që mund të çënojë aftësinë e ALSE për të përmbushur përgjegjësitë e saj si operator i tregut (përfshirë dhe ndarjen e përgjegjësive të tyre sipas kategorive) të rregulluar për të ruajtur sjelljen e drejtë, të rregullt dhe efikase të biznesit në këto tregje, si dhe për realizimin e duhur të kontratave. Këto rrethana përfshijnë, por pa u kufizuar me, luhatjen ekstreme të çmimit të Titujve, prishjen ose dëmtimin e sistemeve kritike të Teknologjisë dhe Informacionit (IT) dhe problemet materiale të sistemit brenda tregjeve financiare. Hapat e ndërmarrë në zbatim të Nenit 1602 mund të përfshijnë, por të mos kufizohen vetëm në masat e përmendura në Nenin 1601.

Neni 1604

Neni 1602 nuk çënon kompetencat e AMF-së që të kërkojë nga ALSE ndërmarrjen e hapave ose ndërprerjen e tyre.

SEKSIONI 1.7. PËRJASHTIMI I PËRGJEGJËSISË

Neni 1701

Në zbatim të përgjegjësave të ALSE si operator i tregjeve të rregulluara, duke përfshirë përgjegjësitë e përmendura në Nenin 1601, ekzistojnë një sërë masash që mund të merren ose jo nga ALSE, qoftë me vendim të vetë asaj ose me kërkesë të një Anëtari, Emetuesi ose të Autoritetit Kompetent përkatës. Më poshtë jepet një listë e këtyre masave, por pa u kufizuar në:

- (i) pezullimi ose ndonjë lloj kufizimi në aktivitetin e ALSE, në zbatim të Nenit 4503 dhe 4504;
- (ii) mbyllja për një periudhë të pacaktuar e ALSE;
- (iii) anulimi dhe/ose modifikimi i tregtimit(eve) në ALSE, në zbatim të Nenit 4505;
- (iv) shqyrtimin e veprimeve, auditimi ose kontrolli i një Anëtari ose Emetuesi për të garantuar përputhshmërinë me Rregulloren, sipas Seksionit 10.2, Nenit 6105 dhe/ose Nenit 6801; dhe
- (v) pezullimi i të drejtave të Anëtarësimit dhe/ose ndërprerja e Anëtarësimit sipas Seksionit 2.6 dhe/ose Seksionit 10.3.

Kjo mund të shkaktojë pamundësinë e një apo më shumë Anëtarëve dhe, nëpërmjet tyre, të një apo më shumë Klientëve që të hyjnë në transaksione.

Neni 1702

Për atë që nuk parashikohet ndryshe nga Ligjet Shqiptare apo në Rregullore apo në një marrëveshje tjetër midis ALSE dhe një Anëtari apo Emetuesi, ALSE mban përgjegjësi për ndonjë mashtrim, pakujdesi të rëndë dhe shkelje me dashje vetëm kur një përcaktim i tillë vendoset nga një gjykatë me juridiksion kompetent dhe nuk mban përgjegjësi në asnjë rast tjetër.

Neni 1703

Anëtarët kanë detyrim që të sjellin në vëmendje të Klientëve të tyre deklaratimet e cituara në Nenin 1701 dhe 1702.

Neni 1704

Për qëllime të Seksionit 1.7, referimet e bëra për "ALSE" përfshijnë çdo zyrtar, punëmarrës, agjent dhe përfaqësues të ALSE.

SEKSIONI 1.8. KONFIDENCIALITETI I INFORMACIONIT

Neni 1801

Të gjitha informacionet në lidhje me aktivitetin e një Emetuesi, një Anëtari ose një Aplikanti për Anëtarësim të marra nga ALSE do të trajtohen si konfidenciale ,me përjashtim të rasteve kur i jep këto informacione sipas përcaktimeve të Nenit 1802, nuk do t'i jepen një pale të tretë pa miratimin e dhënë shprehimisht me shkrim nga Personi në fjalë.

Neni 1802

ALSE mund t'i japë informacion konfidencial në lidhje me këtë Person (pa kërkuar paraprakisht miratimin e Personit):

- (i) Institucioneve të Klerimit dhe Shlyerjes dhe/ose një Agjenti Klerimi dhe Shlyerjeje (CSM);
- (ii) në rastin e një Emetuesi, Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikëqyrës, Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve dhe ose një Personi të autorizuar ligjërisht nga Emetuesi në fjalë;
- (iii) Autoritetit Kompetent, në rast se nxjerrja e këtij informacioni kërkohet nga Ligjet Shqiptare; ose
- (iv) çdo Personi ose organi që sipas Ligjeve Shqiptare konsiderohet se ushtron një funksion ligjor ose rregullator ose një funksion që përfshin ose lidhet me ushtrimin e një funksioni të tillë,

me kusht që çdo Person që merr informacion konfidencial sipas Nenit 1802 t'i nënshtrohet detyrimeve të sekretit profesional dhe t'i kërkohet që të respektojë konfidencialitetin e këtij informacioni.

Neni 1803

ALSE mund t'i japë Emetuesit informacion konfidencial në lidhje me kuotimin/tregtimin e Titujve të tij në ALSE, me kushtin që Emetuesi ta trajtojë këtë informacion si konfidencial dhe të mos ia japë palëve të treta.

SEKSIONI 1.9 HYRJA NË FUQI**Neni 1901**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e shpallur nga ALSE përmes Njoftimit dhe në çdo rast pas marrjes së miratimit të AMF-së.

KAPITULLI 2: ANËTARËSIMI NË BURSËN SHQIPTARE TË TITUJVE

SEKSIONI 2.1. ANËTARËSIMI DHE KATEGORITË E ANËTARËSIMIT NË ALSE

Neni 2101 ANËTARËSIMI NË ALSE

2101/1 Çdo shoqëri komisionere e licensuar nga AMF që dëshiron të Anëtarësohet në Tregun e ALSE duhet të aplikojë për t'u Anëtarësuar, në përputhje me dispozitat e Kapitullit 2. Pranimi i një shoqërie komisionere të licensuar nga AMF për t'u Anëtarësuar në ALSE i nënshtrohet më parë miratimit me shkrim nga ALSE. ALSE u jep të drejta hyrjeje të barabarta në Tregun e ALSE të gjithë Aplikantëve të përshtatshëm që plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara në këtë Rregullore dhe në Ligjet Shqiptare përkatëse. Pasi pranohet nga ALSE sipas Kapitullit 2, një shoqëri komisionere e licensuar nga AMF quhet Anëtar i ALSE.

2101/2 Privilegjet e tregtimit dhe detyrimet e një Anëtari përcaktohen në këtë Rregullore, në Marrëveshjen e Pranimit (Shtojca 1) dhe në marrëveshje të tjera specifike që lidhen me zbatimin e kësaj Rregullore.

2101/3 Anëtarësimi ose çdo privilegj tregtimi që lind nga ky Anëtarësim nuk mund të transferohet (përveçse nëpërmjet ristrukturimit korporativ të Anëtarit pa asnjë ndryshim të pronësisë përfituese, pas marrjes së miratimit paraprak me shkrim të ALSE për transferimin) ose të barrësohet nga/ose në emër të Anëtarit.

2101/4 Kriteret e pranueshmërisë të specifikuara në Nenin 2201/1 ose në vijim të tij, zbatohen jo vetëm në momentin e aplikimit për Anëtarësim, por edhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së Anëtarësitimit të Personit në fjalë.

Neni 2102 KATEGORITË E ANËTARËSIMIT

2102/1 Kategoritë e Anëtarësitimit përcaktohen nga objekti i licencës, regjistrimit, njohjes së dhënë Anëtarit nga AMF, në rast se kërkohet një licencë, regjistrimit, njohjes e tillë, por megjithatë një Anëtar, nëse dëshiron, mund ta kufizojë objektin (llojin e Anëtarësitimit) në lidhje me ALSE.

SEKSIONI 2.2. KËRKESAT PËR ANËTARËSIMIN NË ALSE

Neni 2201 KRITERET E PRANUESHMËRISË PËR ANËTARËSIM

2201/1 ALSE përcakton nëse një Aplikant që nuk është ende Anëtar i ALSE përmbush kriteret e mëposhtme:

- (i) në rastin e një banke dhe/ose një shoqërie komisionere:
 - (a) është i autorizuar nga Autoritetet Kompetente të Shtetit të Origjinës për ushtrimin e aktivitetit në tregun e Titujve, pa rënë në kundërshtim me gërmat (b) dhe (c) të kësaj pike;
 - (b) është i licensuar, i regjistruar, i njohur nga AMF dhe kur është e nevojshme, nga ndonjë Autoritet Kompetent tjetër për ushtrimin e aktivitetit në tregun e Titujve në Shqipëri;
 - (c) aktiviteti i tij është në një gjendje financiare të mjaftueshme për t'u pranuar për Anëtarësim, në përputhje me rregulloren e AMF, nr.41, datë 28.05.2009 "*Mbi likuiditetin minimal të shoqërive të brokerimit të letrave me vlerë*" si dhe me kriteret shtesë që mund të kërkojë ALSE në përputhje me llojin e Anëtarësitimit;
- (ii) stafi i tij ka përvojën dhe kualifikimet e duhura për të ushtruar aktivitetin, si dhe zbatuar e ruajtur procedura dhe kontrolle të brendshme të përshtatshme lidhur me aktivitetin që ai synon të ushtrojë në tregun e Titujve;
- (iii) ka lidhur, sipas rastit, çdo marrëveshje të parashikuar nga kjo Rregullore dhe ka përmbushur të gjitha kërkesat teknike të specifikuara nga ALSE;

- (iv) është i mirëpajisur nga pikëpamja e organizimit si dhe zotëron sistemet e teknologjisë të informacionit të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit. Gjithashtu të vërtetojë se ka burime të mjaftueshme për rolin/et që synon të luajë në treg; dhe
- (v) përmbush çdo kriter tjetër që AMF dhe/ose ALSE mund të përcaktoj(n)ë në lidhje me Anëtarësimin e të shpallë/in me anë të Njoftimit.

2201/2 Pranimi për Anëtarësim në ALSE nuk jep ndonjë të drejtë për të marrë pjesë apo për të votuar në mbledhjet e ALSE, ose të drejta mbi aksione të ALSE apo përgjegjësi për detyrimet e ALSE.

Neni 2202 LLOJET E ANËTARËSIMIT NË ALSE

2202/1 Pasi të ketë përmbushur të gjitha kriteret e Anëtarësimin të përcaktuara në Nenin 2102/1, një bankë dhe/ose shoqëri komisionere e licensuar nga AMF, përfshi dhe Bankën e Shqipërisë, mund të aplikojë për një ose disa nga kategoritë e Anëtarësimin në ALSE të përcaktuara në Nenin 2202/2, në bazë të Titujve që kandidati është i gatshëm të tregtojë në Sistemin ETS.

2202/2 Kategoritë e ndryshme të Anëtarësimin në ALSE janë si më poshtë:

- (i) Anëtar në Tituj të Emetuar nga Qeveria (GSM) – një Anëtar i autorizuar për të tregtuar vetëm Tituj borxhi të Qeverisë (bono thesari, obligacione thesari, bono të emetuara nga Banka e Shqipërisë) të pranuar për t'u tregtuar në ALSE. Nuk përfshihet tregtimi i Titujve të borxhit ose i aksioneve të emetuara nga shoqëritë në pronësi të shtetit;
- (ii) Anëtar në Titujt e Kapitalit (ESM) - një Anëtar i autorizuar për të tregtuar vetëm llojet e Titujve të kapitalit (aksione, garanci, të drejta dhe/ose Dëftesat e depozitarit të cilat si Tituj bazë kanë Tituj kapitali) të pranuar për t'u tregtuar në ALSE. Përfshihet tregtimi i Titujve të kapitalit të emetuara nga shoqëritë në pronësi të shtetit;
- (iii) Anëtar në Titujt e Borxhit (DSM) - një Anëtar i autorizuar për të tregtuar vetëm llojet e Titujve të borxhit, duke përfshirë Titujt e borxhit të Qeverisë (të gjitha llojet e obligacioneve, letrave tregtare afatshkurtra dhe/ose Dëftesat e depozitarit të cilat si Tituj bazë kanë Tituj borxhi) të pranuar për t'u tregtuar në ALSE. Përfshihet tregtimi i Titujve të borxhit të emetuara nga shoqëritë në pronësi të shtetit;
- (iv) Anëtar në Tituj të Tjerë (OSM) – një Anëtar i autorizuar për të tregtuar vetëm Tituj që nuk janë përfshirë në pikat (i), (ii) dhe (iii) më sipër, siç janë kuotat e fondit të investimit, kuotat e fondeve të investimit të tregtuara elektronikisht në bursë (ETF) etj.
- (v) Anëtar në të Gjithë Titujt (ASM) - një Anëtar i autorizuar për të tregtuar të gjithë Titujt e pranuar për t'u tregtuar në ALSE.

2202/3 Një Anëtar i ALSE mund të autorizohet që të tregtojë në emër të tij dhe/ose në emër të klientëve të tij. Brokëri i Anëtarit vepron vetëm në emër të Anëtarit dhe/ose klientëve të Anëtarit. Brokëri nuk ka të drejtë të veprojë për Persona të tjerë të cilët nuk janë klientë të Anëtarit.

2202/4 Një Anëtar i ALSE mund të operojë njëkohësisht sipas një ose më shumë prej kategorive të Anëtarësimin.

Neni 2203 BROKERAT E BURSËS

2203/1 Një Anëtar duhet të garantojë se punëson një numër të mjaftueshëm Brokerash sipas natyrës dhe shkallës së aktivitetit të tij në Tituj, por në çdo rast, sipas Ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 "Për Titujt", duhet të punësojë të paktën një (1) Brokëri. Brokëri mban përgjegjësi për aktivitetin e kryer në ALSE nëpërmjet Terminalit/eve të tij që ndodhen në zyrën e Anëtarit të ALSE për të cilin tregton ai Brokëri.

2203/2 Për të siguruar përputhshmërinë me Nenin 2203, në përputhje me kërkesat e ALSE, një Brokëri duhet të licencohet nga AMF si dhe të trajnohet siç duhet e të njohë mirë Rregulloret e ALSE

dhe procedurat e kuotimit/tregtimit të përcaktuara në të. ALSE mund të vendosë kërkesa (dhe t'i shpallë ato përmes Njoftimit) në lidhje me trajnimin dhe kompetencat e Brokerave.

2203/3 Tregtimi në Sistemin ETS duhet të kryhet, duke iu nënshtruar të gjitha kufizimeve të vendosura nga ALSE, vetëm nga Brokerat ose nga pjesëmarrës të tjerë të sponsorizuar që janë pjesë e Anëtarit, siç përcaktohet në Seksionin 3.3, sipas gjykimit të Anëtarit, me kusht që të gjithë këta individë të jenë të përshtatshëm dhe të trajnuar siç duhet në përputhje me Rregulloren e miratuar nga ALSE posaçërisht për këtë qëllim.

Neni 2204 PËRDORUESIT/BROKERAT NË SISTEMINETS

2204/1 Një përdorues i Sistemit ETS është një Broker i autorizuar me shkrim nga një Anëtar për të regjistruar (fatur) urdhra tregtimi në Sistemin ETS për llogari të Anëtarit dhe/ose të klientëve të Anëtarit.

2204/2 Një Anëtar mund të autorizojë për të vepruar si përdorues të Sistemit ETS vetëm atë Broker që përmbush kriteret e mëposhtme:

- (i) ka licencë të vlefshme, të lëshuar nga AMF, për të kryer detyrat e Brokerit, dhe
- (ii) ka kaluar me sukses testin e vlerësimit të aftësive për Sistemin ETS pranë ALSE.

2204/3 Një përdorues i Sistemit ETS i autorizuar nga një Anëtar me seli të regjistruar në një shtet të ndryshëm nga Shqipëria, mund të ushtrojë aktivitetin në ALSE vetëm pas miratimit paraprak nga AMF.

2204/4 Një përdorues i Sistemit ETS mund të autorizohet të regjistrojë (fatur) urdhra tregtimi vetëm në emër të Anëtarit për të cilin punon dhe është i lidhur në kontratë (marrëveshje).

SEKSIONI 2.3. PROCEDURA E APLIKIMIT

Neni 2301 DEPOZITIMI APLIKIMIT

2301/1 Aplikantët depozitojnë pranë ALSE një aplikim me shkrim ku përfshihen dokumentet si më poshtë vijojnë:

- (i) Aplikimi me shkrim, duke përdorur formularin standard të miratuar nga ALSE (Shtojca 1.1);
- (ii) Ekstrakt i përditësuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
- (iii) Kopje të licencës së lëshuar nga AMF që autorizon Aplikantin për të ushtruar aktivitetin në tregun e Titujve.
- (iv) Kopje të licencës së lëshuar nga AMF për Brokerin/at e Aplikantit.
- (v) Kopje të kontratës së lidhur ndërmjet Aplikantit dhe Brokerit të tij për secilin nga tregjet ku do të operojë, duke përfshirë rezultatin e testit të vlerësimit të aftësive të Brokerit/ave për të vepruar si përdorues i Sistemit ETS në ALSE.
- (vi) Kopje të marrëveshjeve-tip (kur është e zbatueshme), që do të lidhen ndërmjet Aplikantit dhe klientëve të tij, për llogari të të cilëve do të tregtojnë.
- (vii) ALSE ka të drejtë t'i kërkojë aplikantit për anëtarësim infomacione dhe dokumenta shtesë që ALSE, sipas gjykimit të saj të vetëm, i konsideron si të rëndësishme për shqyrtimin e aplikimit.

2301/2 Një Anëtar ekzistues, i cili dëshiron të veprojë në një cilësi tjetër të ndryshme nga ajo për të cilën është autorizuar ose i cili dëshiron të zgjerojë aktivitetin e tij në ALSE, duhet të bëjë aplikim me shkrim pranë ALSE, shoqëruar me dokumentet e nevojshme që vërtetojnë aftësinë e tij për të përmbushur kriteret e kategorisë së Anëtarësimit për të cilën po aplikon.

Neni 2302 TRAJTIMI/SHQYRTIMI I DOSJES SË APLIKIMIT

2302/1 Aplikantët depozitojnë pranë ALSE aplikimin me shkrim për Anëtarësim, duke përdorur formularin standard të miratuar nga ALSE, në gjuhën shqipe.

2302/2 ALSE mund t'i kërkojë Aplikantit informacione dhe dokumente shtesë dhe mund të kërkojë verifikimin e informacionit të dërguar prej tij, nëse e gjykon të nevojshme. ALSE mund t'i kërkojë njërit apo disa përfaqësuesve të Aplikantit që të paraqiten për intervistë pranë ALSE.

2302/3 Çdo Aplikant dhe çdo Anëtar në bazë të kësaj Regulle pranon dhe i jep të drejtën ALSE ose një Person të jashtëm të autorizuar ligjërisht prej ALSE, që të kryejnë, gjatë orarit normal të punës, inspektime në terren në lidhje me aktivitetin e tij në ALSE, nëse ALSE e konsideron të përshtatshme sipas gjykimit të saj të vetëm. Gjithashtu, çdo Aplikant dhe çdo Anëtar angazhohet t'i japë ALSE të gjithë informacionin ose të bëjë të gjitha ndryshimet në sistemet e tij të informacionit që mund të kërkohen nga ALSE si rezultat i këtyre inspektimeve, duke vepruar në mirëbesim.

2302/4 Aplikanti zotohet se çdo informacion që i përcjell ALSE-s nëpërmjet dokumentacionit, informacioneve shtesë që ALSE kërkon dhe/apo ato informacione të cilat i jep gojarisht të jetë i vërtetë, i plotë dhe të mos ketë asnjë qëllim keqdashje, mashtrimi, fshehje të të dhënave në lidhje me informacionin e dhënë.

Neni 2303 VENDIMI PËR APLIKIMIN

2303/1 ALSE pasi merr një aplikim për Anëtarësim dhe çdo informacion shtesë të kërkuar prej saj, e miraton ose e refuzon aplikimin sipas gjykimit të saj të vetëm ose e miraton me disa kushte dhe/ose kufizime që i gjykon të përshtatshme. ALSE e njofton Aplikantin me shkrim për vendimin e saj, duke dhënë edhe arsyet e këtij vendimi. ALSE duhet ta miratojë vendimin e saj dhe t'ia bëjë atë të ditur Aplikantit brenda një afati prej tridhjetë (30) ditësh pune pas datës në cilën ka marrë të gjithë informacionin, që në gjykimin e saj, e ka konsideruar të nevojshëm për vlerësimin e aplikimit.

Në rastin e miratimit të Anëtarësimit, vendimi i ALSE përfshin edhe autorizimin që lejon Brokerin/atë Anëtarit të veprojnë si përdorues i/të Sistemit ETS.

Anëtarësimi në ALSE është i vlefshëm për një periudhë të pacaktuar në rast se nuk specifikohet ndryshe në vendim.

2303/2 Pa cënuar Nenin 2303/3 dhe në zbatim të Seksionit 1.8, ALSE do të ruajë konfidencialitetin e informacionit të dërguar nga një Anëtar ose një Aplikant në lidhje me një aplikim për Anëtarësim ose të marrë prej saj gjatë shqyrtimit të aplikimit.

2303/3 ALSE njofton AMF dhe sipas rastit, Institucionin/et e Klerimit dhe Shlyerjes, për pranimin e Anëtarëve të rinj, si dhe publikon Njoftimin në faqen zyrtare të ALSE.

2303/4 Në rast se ALSE vendos të refuzojë një aplikim, ajo njofton menjëherë Aplikantin me shkrim. Aplikanti në fjalë mund ta apelojë vendimin e ALSE për refuzimin e Anëtarësimit pranë AMF, në përputhje me Ligjet Shqiptare në fuqi.

SEKSIONI 2.4. DETYRIMET E VAZHDUESHME TË ANËTARËVE

Neni 2401 ANËTARËT

Anëtari në mënyrë të vazhdueshme:

- (i) respekton Rregulloren, siç mund të ndryshohet herë pas here, dhe ndërmerr të gjitha veprimet e përshtatshme që parashikohen në të;
- (ii) përmbush detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Pranimit dhe sipas çdo marrëveshjeje tjetër, nëse ka, në të cilën ALSE dhe Anëtari janë palë;
- (iii) paguan tarifën dhe detyrimet e vendosura nga ALSE në përputhje me kushtet e vendosura prej tij, e që u janë komunikuar Anëtarëve. Tarifën e anëtarësimit në ALSE janë vjetore (1 Janar - 31 Dhjetor). Subjektet që do të anëtarësohen pas datës 1 Korrik të çdo viti do të paguajnë gjysmën e tarifës vjetore (Shtojca 2.1).

- (iv) i jep të drejtën ALSE ose një Personi të jashtëm të autorizuar ligjërisht prej ALSE që të bëjnë kontrole në terren gjatë orarit normal të punës, në çdo vend ku Anëtari kryen aktivitet dhe jep sa më parë, çdo informacion ose dokument që ALSE ose Personi të jashtëm të autorizuar ligjërisht prej ALSE e konsiderojnë të nevojshëm për këto kontrole;
- (v) vepron në pajtim me kërkesat teknike të Sistemit ETS dhe të çdo sistemi ose rrjeti tjetër të teknologjisë së informacionit që përdoret nga ALSE, siç përcaktohet në marrëveshjet përkatëse;
- (vi) është përgjegjës për ruajtjen e elementeve të identifikimit dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që hidhen në Sistemin ETS nga Broker(i)at e tij;
- (vii) është përgjegjës për aktivitetin e tij dhe/apo të klientëve të tij, përfshirë por pa u kufizuar në: abuzimit të tregut, si dhe çdo aktiviteti tjetër të konsideruar të tillë nga ALSE;
- (viii) njofton ALSE sa më shpejt të jetë e mundur dhe me shkrim për çdo ndryshim të rëndësishëm në informacionin e dorëzuar gjatë aplikimit për Anëtarësim, duke përfshirë në veçanti, por pa u kufizuar në: të dhënat që lidhen me licencën, regjistrimin, njohjen për të ushtruar aktivitetin në tregun e Titujve;
- (ix) njofton paraprakisht me shkrim ALSE për çdo fakt ose rrethanë që mund të ndikojë në formën juridike ose në organizimin e Anëtarit ose të aktivitetit të tij tregtar në ALSE, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: konsolidimin, riorganizimin, shkrirjen, ndryshimin e emrit, ndryshimin e kontrollit ose çdo ngjarje të ngjashme ku Anëtari është ose do të bëhet palë dhe ofron informacione shtesë për këto fakte sipas kërkesave të ALSE;
- (x) njofton menjëherë ALSE për fillimin ose pritjen për fillimin e një procedure falimentimi, paaftësie paguese, likuidimi, administrimi të kontrolluar ose një procedure të ngjashme (duke përfshirë zgjidhjet miqësore) në çdo juridiksion përkatës, të cilit i nënshtrohet Anëtari ose në të cilin Anëtari është palë;
- (xi) i jep ALSE të dhënat e kontaktit të përfaqësuesve të Anëtarit siç mund të përcaktohet nga ALSE dhe njofton pa vonesa ALSE për çdo ndryshim të këtyre të dhënave (duke përfshirë ndryshimet e adresës së Anëtarit);
- (xii) garanton se çdo përshkrim i Anëtarësimit të tij ose shërbimeve që ai është në gjendje të ofrojë, sipas formës dhe kontekstit në të cilin shfaqen ose përdoren, nuk shtrembëron fushën e kompetencave që ai gëzon sipas Rregullores në lidhje me ALSE;
- (xiii) njofton menjëherë ALSE për pezullimin ose zgjidhjen e një Marrëveshjeje Klerimi dhe Shlyerjeje në të cilën ai është palë;
- (xiv) njofton menjëherë ALSE për paaftësinë e tij për të vepruar në pajtim me Nenin 4702/2; dhe
- (xv) zbaton dhe mban në fuqi procedura dhe kontrole të brendshme të përshtatshme për aktivitetin e tij në treg.

Neni 2402 PËRDORUESIT E SISTEMIT ETS

2402/1 Përdoruesit e Sistemit ETS kanë të drejtë:

- (a) të përdorin Sistemin ETS dhe të regjistrojnë urdhra tregtimi në emër të Anëtarit dhe/ose klientëve të Anëtarit;
- (b) të marrin informacionet që u komunikohen përdoruesve të tjerë të Sistemit ETS nga ALSE.

2402/2 Detyrat e përdoruesve të Sistemit ETS janë:

- (i) të respektojnë dhe të zbatojnë Rregulloret dhe Udhëzimet që jepen nga ALSE;
- (ii) të mos u japin palëve të treta elementët e identifikimit të tyre personal në mënyrë që ato të mund të hyjnë e të përdorin Sistemin ETS përmes Terminaleve të tyre;
- (iii) të njoftojnë ALSE për çdo parregullsi të regjistruar në Sistemin ETS (defekte ose avari teknike).

SEKSIONI 2.5. REGJISTRI I ANËTARËVE

Neni 2501

ALSE mban një regjistër të Anëtarëve, ku përfshihen të paktën të dhënat e kontakteve dhe kategoritë e kompetencat e Anëtarëve, duke përfshirë por pa u kufizuar me, të dhënat e kontakteve dhe kategoritë e kompetencat e Brokerave, të cilët operojnë për llogari të këtyre Anëtarëve.

Neni 2502

Anëtari konsiderohet se e ka selinë në adresën që ai ka deklaruar në Marrëveshjen e Pranimit ose, sipas rastit, në adresën më të fundit që i ka njoftuar me shkrim ALSE.

SEKSIONI 2.6. NDËRPRERJA E STATUSIT TË ANËTARIT DHE PEZULLIMI NGA TREGTIMI NË ALSE

Neni 2601 MËNYRA E NDËRPRERJES SË STATUSIT TË NJË ANËTARI

2601/1 Statusi i Anëtarësimit të një Anëtari të ALSE ndërpritet përfundimisht ose përkohësisht në bazë të sa më poshtë vijon:

1. Dorëheqjes së shkruar, ose
2. Pezullimit.

2601/2 Në rast të ndërprerjes së statusit të Anëtarësimit të një Anëtari të ALSE, ndërpritet përfundimisht apo përkohësisht (sipas rastit) edhe autorizimi i privilegjeve për tregtim të Brokerit/ave që Anëtari ka caktuar për të vepruar në Sistemin ETS.

2601/3 Në rast të ndërprerjes së statusit të Anëtarësimit të një Anëtari të ALSE, përfundon edhe autorizimi i privilegjeve për monitorimin e tregut të ALSE nëpërmjet terminalit "Observer" (nëse ka).

Neni 2602 DORËHEQJA E NJË ANËTARI

2602/1 Një Anëtar mund t'i japë fund Anëtarësimit në ALSE duke i dërguar ALSE një njoftim me shkrim ku shpreh dëshirën e tij për të hequr dorë nga Anëtarësimi ("*njoftim dorëheqjeje*") dhe ku cilëson edhe datën e hyrjes në fuqi të dorëheqjes, e cila në çdo rast hyn në fuqi jo më herët se pas dy (2) muajsh nga data kur ALSE merr në dorëzim njoftimin e dorëheqjes.

2602/2 ALSE sipas gjykimit të saj të vetëm, mund të shtyjë datën e hyrjes në fuqi të dorëheqjes nëse ajo konsideron se kjo është e nevojshme për mbrojtjen e klientëve, ose në interes të tregut të Titujve. Nëse ALSE e bën diçka të tillë, ajo ia heq Anëtarit detyrimin për pagesën e tarifave dhe detyrimeve (plotësisht ose pjesërisht) për periudhën që pason datën në të cilën do të kishte hyrë në fuqi njoftimi i tij i dorëheqjes sipas Nenit 2602/1 më sipër e deri në datën e hyrjes në fuqi. ALSE me anë të një vendimi me shkrim i specifikon Anëtarit tarifën dhe detyrimet që duhet të paguajë deri në datën e përfundimit të Anëtarësisë.

2602/3 Pas marrjes së njoftimit të dorëheqjes të një Anëtari, sipas Nenit 2602/1, të gjitha shumat që ky Anëtar i detyrohet ALSE bëhen menjëherë të pagueshme. Gjithashtu, me kërkesë të ALSE, Anëtari i kthen menjëherë kësaj të fundit, çdo pajisje dhe dokumentacion që i është vënë në dispozicion nga ALSE.

2602/4 Pavarësisht nga dispozitat e Nenit 2602/1, dorëheqja e një Anëtari hyn në fuqi vetëm në datën që i është konfirmuar Anëtarit me shkrim nga ALSE.

Neni 2603 PEZULLIMI DHE LARGIMI I NJË ANËTARI

2603/1 *Pezullimi dhe Largimi nga Anëtarësimi*

Pavarësisht Neneve të Kapitullit 10, kur ato gjejnë zbatim, ALSE pezullon (plotësisht ose pjesërisht, për një periudhë të caktuar) privilegjet e një Anëtari për tregtim dhe mund t'i japë fund (largojë/përfundojë) Anëtarësimit të tij në ALSE, në rastin:

- (i) e heqjes nga AMF të licencës, regjistrimit, njohjes së ushtrimit të aktivitetit në tregun e Titujve në Republikën e Shqipërisë; ose
- (ii) kur shkaku i parashikuar nga pika (ii) e Nenit 2603/4 të kësaj Rregullore ndodh dy herë gjatë një periudhë të pandërprerë prej gjashtë (6) muajsh; ose
- (iii) kur shkaku i parashikuar nga pika (iii) e Nenit 2603/4 të kësaj Rregullore ndodh dy herë radhazi brenda një (1) muaji; ose
- (iv) kur Anëtari është në shkelje të rëndë të kësaj Rregullore; ose
- (v) kur pezullimi nga Anëtarësimi është i nevojshëm për të siguruar një kuotim/tregtim të drejtë dhe të rregullt në bursën ALSE; ose
- (vi) kur Anëtari është pezulluar nga tregtimi sipas Nenit 2603/4 më poshtë, në mënyrë të pandërprerë për më shumë se 6 muaj; ose
- (vii) e shpërbërjes së Anëtarit si person juridik; ose
- (viii)
- (ix) kur për një Anëtar është nisur apo miratuar një procedurë falimenti, administrimi të kontrolluar apo likuidimi (përveç likuidimit vullnetar për qëllime shkrirjeje ose riorganizimi, i cili ka marrë miratimin paraprak nga ALSE) ose kanë nisur procedurat për shpërbërjen e tij; ose
- (x) kur një Anëtar gjendet në paaftësi paguese ose ndodh një ngjarje tjetër e ngjashme; ose
- (xi) kur zbulohet se aplikimi i Anëtarit për Anëtarësim ka pasur gabime, pasaktësi, informacion të rremë, mungesa të konsiderueshme ose shtrembërime të përmbajtjes; ose
- (xii) kur Anëtari nuk është më i aftë të përmbushë kërkesat e Anëtarësimit që parashikohen në këtë Rregullore (duke përfshirë por pa u kufizuar në Nenin 2201 më sipër) ose në akte të tjera të ALSE, në varësi edhe të kategorisë së Anëtarit;
- (xiii) kur Anëtari kërkon në mënyrë të argumentuar pezullimin e përkohshëm.

2603/2 Çdo pezullim ose largim sipas Nenit 2603/1 vendoset nga ALSE, duke marrë në konsideratë sa e rëndë është ose sa zgjat ngjarja në fjalë. Vendimi për pezullim ose largim i njoftohet Anëtarit me shkrim.

2603/3 Pavarësisht Neneve të Kapitullit 10, kur ato gjejnë zbatim, ALSE gëzon të drejtën t'i japë fund ose të pezullojë Anëtarësimin e çdo Anëtari në rast se Anëtari ka ndaluar së kryeri veprime me Tituj në sistemin ETS, për një periudhë prej gjashtë (6) muajsh të njëpasnjëshëm.

2603/4 Pezullimi i Anëtarit nga Tregtimi

ALSE pezullon një Anëtar nga tregtimi në bursë në rastet e mëposhtme:

1. Menjëherë pas marrjes së njoftimit për ekzistencën e një shkaku të parashikuar nga Neni 2601 i kësaj Rregulloreje;
2. Menjëherë pas marrjes së njoftimit nga AMF për marrjen e një mase ndaj një Anëtari të ALSE, duke e ndaluar në këtë mënyrë atë përkohësisht nga kryerja e aktivitetit për të cilin është licensuar;
3. Menjëherë pas marrjes së njoftimit nga një Agjent Klerimi dhe Shlyerje (CSM) ose nga AFISaR dhe/ose ALREG për mospërmbushjen nga Anëtari i ALSE të detyrimeve të tij të shlyerjes;
4. Menjëherë pas marrjes së njoftimit nga një Anëtar që ky person juridik ka hyrë në procedurat e falimentimit;
5. Nëse kjo do të jetë e nevojshme për të siguruar kuotimin/tregtimin e drejtë dhe të rregullt në bursë.

ALSE mund të pezullojë ose jo një Anëtar nga tregtimi në bursë në rastet e mëposhtme:

- (i) Në rastin e rrethanave të cilat e bëjnë bursën ALSE të dyshojë me të drejtë që Anëtari ka kryer shkelje të rëndë të rregullave ose akteve të tjera të ALSE;
- (ii) Në rastin e paaftësisë së një Anëtari për të përmbushur, ose vonësës nga ana e tij për të përmbushur ato detyrime të Anëtarit që parashikohen në Rregullore apo Marrëveshjen e Pranimit, ose në ndonjë marrëveshje tjetër ku ALSE dhe Anëtari janë të dy palë;
- (iii) Kur Anëtari nuk informon ALSE për ngjarjet ose rrethanat e përcaktuara me rregullore dhe me udhëzime;
- (iv) Kur Anëtari kërkon në mënyrë të argumentuar pezullimin e përkohshëm.

Ndërkohë që ndaj një Anëtari të ALSE është vendosur masa e pezullimit nga tregtimi, ai mban statusin e tij të Anëtarit dhe mbetet përgjegjës për të përmbushur detyrat e veta sipas këtij statusi, por nuk është në gjendje të zbatojë të drejtat e tij sipas statusit të një Anëtari të ALSE.

Pezullimi nga tregtimi mbetet në fuqi deri në një moment të tillë që arsyeja për pezullimin e një Anëtari nga tregtimi është eliminuar, ose deri në momentin që pezullimi rezulton në vendosjen e masës së pezullimit nga Anëtarësimi në bursën ALSE.

2603/5 Ri-Aplikimi

Një Anëtar privilegjet për tregtim dhe/ose Anëtarësim të të cilit pezullohen ose Anëtarësimi i të cilit përfundohet mund të aplikojë pranë ALSE në çdo kohë për revokimin e pezullimit ose të përfundimit. Me paraqitjen e këtij aplikimi, Anëtari i jep ALSE çdo informacion që ALSE mund të kërkojë.

ALSE mund ta refuzojë këtë ri-aplikim nëse pranimi i një Personi të tillë në Anëtarësim kompromenton kuotimin/tregtimin e drejtë dhe të rregullt në bursë. Anëtari në fjalë mund ta apelojë pranë AMF vendimin e ALSE për refuzimin e kthimit të Anëtarësimit, në përputhje me Ligjet Shqiptare në fuqi.

ALSE mund t'i rikthejë Anëtarit Anëtarësimin ose privilegjet e tij për tregtim ose në mënyrë të pakushtëzuar ose duke vendosur ato kushte që ALSE i konsideron të përshtatshme.

2603/6 Një Anëtar, privilegjet për tregtim të të cilit janë pezulluar plotësisht ose pjesërisht për një periudhë kohore:

- (i) ndalohet të tregtojë si një Anëtar gjatë periudhës së pezullimit (me përjashtim të rasteve kur lejohet nga Rregullorja, me qëllim që të përfundojë të gjitha transaksionet e hapura të tij ose të Klientëve të tij); por
- (ii) vazhdon të mbajë përgjegjësi në lidhje me detyrimet e tij si Anëtar duke përfshirë pagesën e tarifave dhe të detyrimeve që duhen paguar në zbatim të Rregullores.

2603/7 Pa cënuar sa më lart, një bankë dhe/ose shoqëri komisionere e licensuar nga AMF, Anëtarësimi i të cilës në ALSE ka përfunduar, vazhdon t'i nënshtrohet Rregullores dhe juridiksionit të ALSE në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e saj gjatë kohës që ka qenë Anëtar, deri në afatet e parashkrimit të parashikuara në Ligjet Shqiptar. Gjithashtu, një shoqëri komisionere e licensuar nga AMF, Anëtarësimi i të cilës ka përfunduar, humb të gjitha të drejtat për të përdorur privilegjet për tregtim që i janë dhënë, pa pasur të drejtë për ndonjë rimbursim të tarifave të paguara në lidhje me këto privilegje.

2603/8 Pasi Anëtari merr njoftimin e pezullimit ose largimit sipas Nenit 2603/2, të gjitha shumat që ky Anëtar i detyrohet ALSE bëhen menjëherë të pagueshme. Të gjitha detyrimet e këtij Anëtari që rrjedhin nga Anëtarësimi shlyhen sipas kërkesave të ALSE. Në rast largimi (përfundimi) nga Anëtarësimi, Anëtari i kthen menjëherë ALSE, me kërkesë të kësaj të fundit, çdo pajisje dhe dokumentacion që i është vënë në dispozicion nga ALSE.

2603/9 Afatet e Ri-Aplikimit

Personi që ka qenë i pezulluar nga Anëtarësimi në ALSE, për shkelje mund të ri-aplikojë për pranim në Anëtarësim jo më herët se tre (3) muaj në vijim pas ndërprerjes së Anëtarësisë.

Personi që ka qenë i larguar nga Anëtarësimi në ALSE, për shkelje mund të ri-aplikojë për pranim në Anëtarësim jo më herët se një (1) vit në vijim pas largimit nga Anëtarësia.

Neni 2604 DORËHEQJA E NJË BROKERI

2604/1 Një Broker mund t'i japë fund përfaqësimit të një Anëtari të ALSE dhe të qenit një përdorues i Sistemit ETS duke i dërguar ALSE dhe Anëtarit një njoftim me shkrim ku shprehet dëshira e tij për të dhënë dorëheqjen nga kjo detyrë (një "njoftim dorëheqjeje") dhe ku gjithashtu cilësohet edhe data e hyrjes në fuqi të dorëheqjes, e cila në çdo rast hyn në fuqi jo më herët se pas një (1) muaji nga data kur ALSE merr në dorëzim njoftimin e dorëheqjes.

Neni 2605 PEZULLIMI I NJË BROKERI

2605/1 Pavarësisht Neneve të Kapitullit 10, kur janë të zbatueshme, ALSE pezullon (plotësisht ose pjesërisht, për një periudhë të caktuar) privilegjet për tregtim të një Brokeri në Sistemin ETS, kur:

- (a) dyshohet se kryen veprime që janë të ndaluara nga Ligjet Shqiptare dhe/ose nga Rregullorja, Udhëzimet, Njoftime të tjera të ALSE;
- (b) menjëherë pas konstatimit se një përdorues i Sistemit ETS u ka dhënë palëve të treta elementët personalë të identifikimit në mënyrë që ata të mund të hyjnë në Terminalin e tij/saj dhe të përdorin Sistemin ETS.

2605/2 Pavarësisht Neneve të Kapitullit 10, kur janë të zbatueshme, ALSE i jep fund privilegjeve për tregtim të një Brokeri në Sistemin ETS, edhe kur:

- (i) Anëtari ka pranuar me shkrim anulimin e autorizimit të Brokerit që është përdorues i Sistemit ETS;
- (ii) Brokeri ka shkelur rëndë Ligjet Shqiptare dhe/ose Rregulloren, Udhëzimet, Njoftimet e tjera të ALSE;

Në rastet e parashikuara në pikën (ii) të këtij Neni, një përdorues i Sistemit ETS nuk mund të aplikojë sërish për një autorizim tjetër për të punuar në Sistemin ETS për një periudhë prej dy (2) vjetësh pas pezullimit.

Neni 2606 NJOFTIMI I DORËHEQJES, PEZULLIMIT DHE PËRFUNDIMIT TË ANËTARËSIMIT

ALSE njofton menjëherë AMF-në, dhe sipas rastit, Institucionet e Klerimit dhe Shlyerjes dhe/apo palë të tjera që ALSE mund ta gjykojë të nevojshme për dorëheqjen, përfundimin ose pezullimin, si edhe për përfundimin e pezullimit, të:

- (i) Anëtarësimit të çdo Anëtari; ose
- (ii) Brokerit(përdoruesi i Sistemit ETS) të një Anëtari.

KAPITULLI 3: RREGULLAT E AKSESIT NË TREG

SEKSIONI 3.1. AKSESI NË TREG PËR PJESEMARRËSIT

Neni 3101 KRITERET PËR PJESEMARRËSIT NË TREG

Pjesëmarrësit në treg që tregtojnë në ALSE janë të gjithë persona juridikë dhe fizikë vendas dhe të huaj, të cilët duan të blejnë dhe/ose të shesin Tituj të pranuar për kuotim/tregtim në Sistemin ETS.

Neni 3102 LLOJET E PJESEMARRËSVE NË TREG

Janë dy lloje të pjesëmarrësve në treg:

- (a) Anëtarët që janë shoqëri komisionere të licencuara nga AMF për të ushtruar aktivitetet me Tituj, siç përcaktohet në Ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 "*Për Titujt*" dhe të pranuar si të tillë nga ALSE. Anëtarët i tregtojnë Titujt ose
 - (i) në emër dhe për llogari të tyre dhe/ose
 - (ii) në emër dhe për llogari të klientëve të tyre.
- (b) Klientët që janë persona juridikë dhe fizikë, të cilët tregtojnë Tituj në emër dhe për llogari të tyre, me ndërmjetësimin e Anëtarëve.

Neni 3103 MËNYRAT E AKSESIT NË TREG

Aksesi në treg për pjesëmarrësit e tregut bëhet në çdo rast përmes një Anëtari të ALSE. Asnjë person tjetër juridik ose fizik nuk mund të regjistrojë (fusë) urdhra në Sistemin ETS pa ndërmjetësimin e një Anëtari të ALSE.

Anëtarët aksesojnë tregun dhe regjistrojnë (fusin) urdhrat e tyre në Sistemin ETS në emër të tyre dhe/ose të klientëve të tyre përmes Brokerave duke përdorur терминаlet e tyre që ndodhen në zyrat e tyre.

Klientët (Pjesëmarrësit e Sponsorizuar) mund të zgjedhin gjithashtu mundësinë e Aksesit të Sponsorizuar të ofruar nga një Anëtar Sponsorizues, si dhe akses të drejtpërdrejtë në Sistemin ETS për të regjistruar (fatur) urdhrat e tregtimit nëpërmjet një Sistemi të miratuar të Automatizuar të Orientimit të Urdhrave (në vijim referuar si: AutORS). Në çdo rast, Sistemi ETS identifikon edhe Pjesëmarrësin e Sponsorizuar, edhe Anëtarin Sponsorizues.

SEKSIONI 3.2. AKSESI ELEKTRONIK PËR ANËTARËT E ALSE

Neni 3201

Çdo akses që ALSE u jep Anëtarëve të saj për të regjistruar (fatur) urdhrat e tregtimit në Sistemin ETS, sipas përcaktimeve të Nenit 3301, duhet të kontrollohet në mënyrë të duhur, në përputhje me dispozitat e Nenit 9106.

Neni 3202

I gjithë aktiviteti i ndërmarrë nga një Broker duke përdorur terminalin e tij, do të bëhet në emër të Anëtarit dhe Anëtari mban përgjegjësi të plotë për ushtrimin e të gjithë këtij aktiviteti, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë rregullore.

Neni 3203

Bazuar në autorizimin e një Anëtari, ALSE cakton elementin e identifikimit të Brokerit të autorizuar si një përdorues i Sistemit ETS, i cili i mundëson identifikimin unik të përdoruesit, i lejon aksesin, si dhe i mundëson atij kryerjen e veprimeve brenda Sistemit ETS dhe akses në të dhënat që ai është autorizuar të përdorë.

Neni 3204

Dispozitat e pikës (vi) të Nenit 2401 të kësaj Rregulloreje do të zbatohen për ruajtjen e elementeve të

identifikimit dhe mbajtjen e përgjegjesisë për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të regjistruara nga një përdorues i Sistemit ETS.

NENI 3205 AKSESIMI NË SISTEMIN ETS NËPËRMJET TERMINALIT “OBSERVER”

3205/1 Pavarësisht parashikimeve të dispozitave të kësaj Rregulloreje, akses si përdorues në Sistemin ETS do të kenë edhe Persona të ndryshëm nga Anëtarët e ALSE dhe/ose klientët e tyre, për qëllim të marrjes së të dhënave në kohë reale mbi ecurinë e tregut.

3205/2 Bursa ALSE autorizon aksesin në Sistemin ETS të Personave të përmendur në nenin 3205/1 nëpërmjet terminalit “Observer”. Kriteret për autorizimin e aksesit në terminalin “Observer” do të përcaktohen nga Bursa ALSE në një udhëzim të veçantë.

SEKSIONI 3.3. MJETET E AKSESIMIT ELEKTRONIK PËR KLIENTËT

Neni 3301

Anëtari i ALSE mund t'u ofrojë akses Klientëve të tij nëpërmjet një AutORS të miratuar nga një Akses i Sponsorizuar.

Neni 3302

I gjithë aktiviteti i ndërmarrë nga një Klient nëpërmjet AutORS, duke përdorur Aksesin e Sponsorizuar në ALSE, do të bëhet në emër të Anëtarit dhe Anëtari mban përgjegjësi të plotë për kryerjen e të gjithë këtij aktiviteti.

Neni 3303

ALSE mund të shqyrtojë një aplikim nga një Anëtar që dëshiron t'u sigurojë Akses të Sponsorizuar në ALSE, një ose më shumë klientëve të tij, përmes një AutORS. ALSE mund ta refuzojë këtë aplikim ose mund të vendosë kushte për çdo miratim të dhënë në lidhje me këtë aplikim. Pas dhënies së këtyre miratimeve ALSE ka kompetencën të anulojë ose të ndryshojë këto miratime.

Të gjithë Aplikantët e suksesshëm për ofrimin e shërbimit të Aksesit të Sponsorizuar, do të njoftohen me shkrim nga ALSE.

Neni 3304

ALSE i kërkon çdo Anëtar Sponsorizues të garantojë që secili prej Pjesëmarrësve të Sponsorizuar nga ky Anëtar:

- (a) të mos shkelë Rregulloren e zbatueshme për tregtimin në ALSE dhe kushtet procedurale apo teknike që ALSE herë pas here përcakton në lidhje me Aksesin e Sponsorizuar dhe që i shpall me anë të Njoftimeve;
- (b) të lejojë ALSE ose një Person të jashtëm të autorizuar ligjërisht prej saj, për të kryer kontrole në terren dhe të japë sa më parë çdo informacion apo dokument që ALSE ose Personi i jashtëm i autorizuar ligjërisht prej saj, e konsiderojnë të nevojshëm për këto kontrole;
- (c) të lidhë marrëveshje që mund të kërkohen nga ALSE; dhe
- (d) të japë të dhënat e kontaktit të drejtuesve apo stafit operativ që mund të kërkohen nga ALSE.

Neni 3305

Anëtari Sponsorizues së bashku me Pjesëmarrësin e Sponsorizuar ndërmarrin hapat e duhur për të mundësuar, ndër të tjera, monitorimin e sistemeve të kontrollit të rrezikut (të cilat nuk mund të vendosen në zyrat e Pjesëmarrësit të Sponsorizuar) dhe marrjen e masave të përshtatshme në lidhje me aktivitetin e tregtimit të Pjesëmarrësit të Sponsorizuar. Në veçanti, Anëtari Sponsorizues duhet t'i provojë ALSE, në mënyrën e pranueshme prej saj, që:

- (a) masat monitoruese janë në përputhje me Nenin 9106; dhe

- (b) procedurat dhe dokumentacioni i tij i brendshëm i mundësojnë atij pezullimin e menjëhershëm të aksesit në ALSE të Pjesëmarrësve të Sponsorizuar, qoftë me vendim të tij apo edhe me kërkesë të ALSE.

KAPITULLI 4: RREGULLAT E TREGTIMIT TË TITUJVE

SEKSIONI 4.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 4101 OBJEKTI I KAPITULLIT 4

Kapitulli 4 përcakton kushtet dhe procedurat e futjes së urdhreve të Titujve në ALSE.

Neni 4102 DITËT E TREGTIMIT DHE ORARET E TREGTIMIT

Ditët e Tregtimit në çdo vit të caktuar kalendarik shpallen nga ALSE në Njoftimin e publikuar jo më vonë se në Ditën e fundit të Tregtimit të vitit paraardhës.

Ditët e tregtimit në ALSE përcaktohen nga një udhëzim i Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 4103 VALUTA E TREGTIMIT

Urdhrat për blerjen ose shitjen e Titujve duhet të shprehen në Lek shqiptar (ALL), ose në një monedhë tjetër të përcaktuar nga ALSE për klasën përkatëse të Titujve.

Neni 4104 SIMBOLET E TREGTIMIT

ALSE përcakton simbolet e tregtimit me qëllim identifikimin e Titujve në sistemin e tregtimit të ALSE. Nëse e gjykon të nevojshme ALSE mundet që në çdo kohë të ndryshojë ose të ricaktojë këto simbole tregtimi. Emetuesit e Titujve në fjalë nuk kanë asnjë të drejtë pronësie ndaj këtyre simboleve të tregtimit.

Neni 4105 RREGULLAT DHE KËRKESAT E SISTEMIT

Gjatë tregtimit në ALSE, Anëtarët duhet të zbatojnë kërkesat operacionale, procedurale dhe teknike të sistemeve dhe rrjeteve të ALSE, ashtu siç është përcaktuar nga ALSE.

Neni 4106 PËRGJEGJËSIA E ANËTARIT

Anëtari i ALSE është përgjegjës, për sa i përket aktivitetit që kryhet në ALSE ose aktiviteteve të tjera ndihmëse në përputhje me Ligjet Shqiptare në fuqi, për veprimet dhe lëvizjet e të gjithë Brokerave apo Pjesëmarrësve të Sponsorizuar të regjistruar në emër të tij, sikur veprimet dhe lëvizjet e secilit prej tyre të ishin veprimet dhe lëvizjet e Anëtarit të ALSE. Në mënyrë të veçantë, Anëtari i ALSE është përgjegjës për çdo shkelje të një detyrimi të caktuar të kryer nga secili nga Brokerat apo Pjesëmarrësit e Sponsorizuar prej tij dhe në rast shkeljesh të tilla, Anëtari përkatës mund të sanksionohet në bazë të Rregullores.

SEKSIONI 4.2. STATUSI I TREGTIMIT

Neni 4201 STATUSI I TREGTIMIT TË ANËTARIT

Anëtarimund të ketë statusin e mëposhtëm në Sistemin ETS:

1. *Aktiv* – Anëtari nëpërmjet Brokerit të tij mund të realizojë transaksione dhe të menaxhojë urdhrat nëpërmjet Sistemit ETS; ose
2. *Joaktiv* – Anëtari nuk mund të realizojë transaksione nëpërmjet brokerit të tij dhe të menaxhojë urdhrat nëpërmjet Sistemit ETS.

Statusi i Anëtarit mund të ndryshojë në bazë të një Vendimi të organit kompetent të ALSE, kur përmbushen kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore. Nëse statusi ndryshon në "*joaktiv*", atëherë të gjithë urdhrat e Anëtarit zhvendosen në statusin "i stopuar".

Neni 4202 STATUSI I TREGTIMIT TË TITUJVE

Në Sistemin ETS, statusi i njëTitulli mund të jetë:

1. *I tregtuar* – Titulli mund të tregtohet përmes Sistemit ETS sipas Rregullores, menaxhimi (sipas përkufizimit të Nenit 4305 më poshtë) është i mundur;

2. *I stopuar* – Sistemi ETS nuk mundëson përputhjen e urdhrave, menaxhimi është i mundur;
3. *I pezulluar* – Sistemi ETS nuk mundëson përputhjen e urdhrave, menaxhimi nuk është i mundur;
4. *I delistuar* – Titulli është i delistuar/dekuotuar përkohësisht ose përgjithmonë, Sistemi ETS nuk mundëson përputhjen e urdhrave, menaxhimi nuk është i mundur.

Statusi i një Titulli mund të ndryshojë në bazë të një Vendimi të organit kompetent të ALSE, kur plotësohen kërkesat përkatëse të Rregullores.

Neni 4203 STATUSI I URDHRAVE

Në Sistemin ETS, statusi i urdhrit mund të jetë:

1. *Aktiv* – çdo urdhër, ekzekutimi i të cilit është subjekt i kufizimeve të çmimeve sipas Nenit 4503 të kësaj Rregulloreje;
2. *Joaktiv* – çdo urdhër, ekzekutimi i të cilit do të shkelte dispozitat e Nenit 4503 të kësaj Rregulloreje. Sistemi ETS nuk lejon përputhjen e urdhrave joaktivë;
3. *I stopuar* – çdo urdhër, ekzekutimi i të cilit nuk lejohet. Në bazë të kësaj Rregulloreje, urdhri mund të ndalohet nga ALSE ose nga një Anëtar. Ai mund të riaktivizohet vetëm nga një Anëtar. Pas riaktivizimit urdhrat marrin një shënjim kohor të ri dhe bëhen aktivë ose joaktivë, në lidhje me kufizimet e Nenit 4503 të kësaj Rregulloreje;
4. *I fshirë* – çdo urdhër, i cili është çregjistruar nga Sistemi ETS për shkak të realizimit, skadimit të vlefshmërisë, ose anulimit nga ALSE ose nga një Anëtar.

Pas ndryshimeve në vlerat limit të kufizimeve të çmimeve sipas Nenit 4503 të kësaj Rregulloreje, Sistemi ETS i cakton urdhrin statusin e duhur aktiv apo joaktiv, ku shënjimi kohor i urdhrin nuk ndryshon.

Pas mbylljes së tregtimit të çdo dite tregtimi, Sistemi ETS i zhvendos të gjithë urdhrat ditorë të paekzekutuar, vlefshmëria e të cilëve ka skaduar, në statusin "*i fshirë*".

Në rast të mbarimit të llojeve të urdhrave ose në rast të procedurave të ndryshuara të urdhrave, çka sjell aplikimin e një sistemi të ri të procedurës së urdhrave, ALSE mund - me kalimin në sistemin e ri – të fshijë nga Sistemi ETS urdhrat që ndodhen në Librin Qendror të Urdhrave (në vijim referuar si: COB), të cilët preken detyrimisht nga sistemi i ri i urdhrave. ALSE duhet të japë Njoftim e saj me shkrim për të gjitha Anëtarët paraprakisht.

Urdhri quhet i vendosur në COB, nëse është aktiv apo joaktiv.

SEKSIONI 4.3. URDRAT

Neni 4301 OBJEKTI I SEKSIONIT 4.3

Sekcioni 4.3 trajton vetëm urdhrat për transaksionet në ALSE, të cilat sipas kësaj Rregulloreje nënkuptojnë urdhrat për blerjen ose shitjen e Titujve të regjistruara nga Brokëri/at e Anëtarëve në Librin Qendror të Urdhrave (në vijim referuar si: COB) të ALSE dhe nuk pengon përcaktimin e specifikimeve të veçanta në lidhje me urdhrat ndërmjet Anëtarëve dhe Klientëve të tyre.

Hedhja e urdhrave në COB dhe ekzekutimi i transaksioneve në sistemin ETS të bursës ALSE mund të ekzekutohen vetëm nga Anëtarët e ALSE nëpërmjet Brokërave të tyre. Anëtari i ALSE mund të refuzojë ekzekutimin e urdhrave që janë objekt i kushteve paraprake ose të mëvonshme, ose i kufizimeve të tjera të vlefshmërisë, të cilat nuk janë të parashikuara në këtë Kapitull 4.

Objekti i transaksioneve në bursën ALSE janë Titujt të pranuar për listim/tregtim, respektivisht në listën zyrtare dhe në tregjet e tjera të ALSE, së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tyre deri në momentin e tregtimit.

Neni 4302 KËRKESAT DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME

4302/1 Statusi i Urdhrit në COB nga pikëpamja funksionale

Statusi i një urdhri në COB nga pikëpamja funksionale mund të jetë si më poshtë:

- (i) *aktiv* – ekzekutimi i tij i nënshtrohet kufizimeve të çmimeve sipas Nenit 4503 të kësaj Rregulloreje;
- (ii) *refuzuar* – një urdhër, ekzekutimi i të cilit shkel dispozitat e Neneve 4302/2 dhe 4503 të Rregullores.
- (iii) *fshirë* – një urdhër që është fshirë nga COB si rezultat i ekzekutimit në Sistemin ETS, i skadimit të vlefshmërisë ose anulimit nga ana e Bursës ALSE apo e Brokerit të Anëtarit.

4302/2 Elementet e detyrueshme të një urdhri të regjistruar në COB

Çdo urdhër i dorëzuar në COB duhet të paktën të përmbajë elementet e mëposhtme të detyrueshme:

- (i) Titullin me të cilin ka lidhje urdhri ose simbolin e tregtimit të caktuar nga ALSE për këtë Titull;
- (ii) llojin e urdhrit (blej ose shes);
- (iii) kodin e Anëtarit të ALSE duke përfshirë kodin e tij të përdoruesit të Sistemit ETS;
- (iv) sasinë e Titullit përkatës;
- (v) nëse urdhri është regjistruar:
 - (a) për llogari të vetë Anëtarit të ALSE;
 - (b) për llogari të Klientit të Anëtarit;
- (vi) kodi i referencës.

COB refuzon urdhrat që nuk përmbajnë të gjithë elementet e detyrueshme, duke mos kontrolluar kështu saktësinë e regjistrimit të të dhënave në llogari apo ekzistencën e llogarisë. Saktësia e regjistrimit në llogari kontrollohet vetëm nëse kjo është e rëndësishme për të garantuar një funksionim të përshtatshëm të sistemit të shlyerjes, i cili do të detajohet në Udhëzime.

4302/3 Elementët fakultativë të një urdhri të regjistruar në COB

Gjatë regjistrimit në COB komponentët e mëposhtëm janë fakultativë:

- (i) çmimi i Titullit;
- (ii) karakteristikat shtesë të llojit të urdhrit siç përcaktohen në Nenin 4303;
- (iii) parametrat shtesë të ekzekutimit të urdhrit siç përcaktohen në Nenin 4304.

Nëse komponentët fakultativë, sipas paragrafit më lart të këtij Neni, nuk përfshihen në regjistrimin e urdhrit në COB, COB dhe Sistemi ETS do ta njohin këtë urdhër si urdhër tregu të ditës kur regjistrohet urdhri pa nënkuptuar ndonjë sasi ose karakteristikë shtesë të llojit të urdhrit apo parametra shtesë të ekzekutimit të urdhrit. Për rastet kur një komponent i caktuar fakultativ nuk jepet gjatë regjistrimit të urdhrit në COB, kjo dispozitë do të zbatohet rast pas rasti.

COB refuzon urdhrat që përmbajnë komponentë fakultativë të palejueshëm.

4302/4 Sasia e urdhrit

Titujt në ALSE kuotohen/tregtohen në njësi Titujsh (lot-e). Sasia minimale e kuotimit/tregtimit është një (1) njësi Titujsh.

Të gjitha sasi të urdhrave mund të kuotohen/tregtohen në varësi të specifikave të caktuara për lloje të ndryshme Titujsh, siç përcaktohet në një ose më shumë Njoftime.

4302/5 Madhësia e ndryshimit të çmimit

Madhësia e ndryshimit të çmimit tregon lëvizjen më të vogël të lejuar të çmimeve në ngritje dhe në rënie të çmimit të blerjes ose shitjes për një Titull, pas regjistrimit në Librin Qendror të Urdhrave (COB) në ALSE.

Madhësia e ndryshimit të çmimit të Titujve, vlera e të cilëve është e shprehur në lekë, është 1 lekë ose shumëfishat e saj.

Madhësia e ndryshimit të çmimit të Titujve, vlera e të cilëve është e shprehur në përqindje (%), është 0,01% ose shumëfishat e saj.

4302/6 Disa ngjarje të caktuara

Urdhrat e paekzekutuar për sa i përket një Titulli të caktuar do të anulohen në COB në rast të ndodhjes ose shpalljes së disa ngjarjeve të caktuara që kanë lidhje me Emetuesin përkatës, të cilat

kanë të ngjarë të ndikojnë ndjeshëm në çmimin e këtij Titulli, siç është përcaktuar në një ose më shumë Njoftime.

4302/7 Ndryshimi dhe anulimi

Çdo urdhër i regjistruar në COB mund të ndryshohet ose të anulohet para ekzekutimit të tij. Çdo rritje e sasisë së urdhrit ose ndryshimit të kufirit të çmimit do të rezultojë në heqjen dorë nga përparësia në kohë.

Neni 4303 LLOJET E URDHRAVE

4303/1 Urdhrat e tregut

Urdhri për të blerë ose për të shitur një sasi të deklaruar Titujsh, që do të ekzekutohet me çmimin më të mirë të mundshëm në momentin kur urdhri mbërrin në COB.

4303/2 Urdhrat limit

Urdhralimit janë urdhra blerje apo shitje që mund të ekzekutohen vetëm në kufirin e tyre të caktuar të çmimeve ose me një çmim më të mirë.

Neni 4304 PARAMETRAT E URDHRAVE

4304/1 Koha e regjistrimit të urdhrit në COB

Koha e regjistrimit të urdhrit është koha që caktohet për urdhrin nga Sistemi ETS pas regjistrimit të tij në COB. Pas marrjes së shënimit kohor të urdhrit, do të përdoret koha e regjistruar nga Sistemi ETS.

4304/2 Vlefshmëria

Urdhrat e regjistruar në COB janë të vlefshëm gjatë Ditës së Tregtimit në të cilën janë regjistruar deri në një datë të caktuar ose derisa të anulohen, duke iu nënshtruar një kohëzgjatjeje maksimale prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditësh. Në rastin e mungesës së specifikimit të kohëzgjatjes të urdhrit, ky urdhër do të konsiderohet i vlefshëm për Ditën e Tregtimit.

Për sa i përket një seance të caktuar tregtimi, urdhri, që nga regjistrimi i tij, mund të jetë i vlefshëm deri në një kohë të caktuar, ose për një periudhë të caktuar kohore ose për ankandin e radhës të hapur ose të mbyllur.

4304/3 Parametrat e ekzekutimit

(A) Parametrat Specifikë

Disa lloje urdhrash mund t'i nënshtrohen kushteve të mëposhtme të ekzekutimit në përputhje me matricën e llojeve të urdhrave dhe kushteve të ekzekutimit të përcaktuara në një ose më shumë Njoftime:

- (i) "Të Menjëhershëm ose Anulohen" (Immediate or Cancelled - IOC), janë urdhra që ekzekutohen sa më plotësisht të jetë e mundur duke anuluar menjëherë pjesën tjetër të mbetur të paekzekutuar.;
- (ii) "Ekzekuto ose Anulo të Gjithë Urdhrin" (Fill or Kill - FOK), janë urdhra që mundësojnë blerjen dhe shitjen e një Titulli dhe duhet të ekzekutohen menjëherë dhe në mënyrë të plotë e të pandashme, në të kundërt i gjithë urdhri anulohet. Nuk është i lejueshëm ekzekutimi i pjesshëm i urdhrit,
- (iii) "I Vlefshëm deri në një datë caktuar" (Good till Date - GTD), janë urdhra të vlefshëm nga momenti i regjistrimit deri në ekzekutimin në COB, ose deri në një datë të caktuar.
- (iv) "Të Gjithë ose Asnjë" (All or None - AON), janë urdhra që mundësojnë blerjen apo shitjen e një Titulli pas një regjistrimi të vetëm me çmime të ndryshme deri në një kufi të caktuar të çmimit. Ekzekutimi i pjesshëm nuk lejohet, përveç rastit kur plotësohet e gjithë sasia e titujve të kërkuar apo orfuar nga pala përballë në transaksion.
- (v) "Urdhra me Sasi Minimale" (Minimum-Quantity Orders - MQO) janë urdhra në të cilat përcaktohet sasia minimale e titujve për të hyrë në transaksion, në rast se kjo sasi nuk plotësohet, ky urdhër qëndron në COB deri në fund të ditës së tregtimit. Pas plotësimit të kushtit të sasisë minimale ky urdhër kthehet në urdhër limit.;

Gjatë metodës së tregimit të vazhdueshëm mund të aplikohen të gjithë parametrat specifikë të parashikuar në pikën "A" të Nenit 4304/3.

Gjatë metodës së tregimit me ankand mund të aplikohen vetëm parametrat specifikë të parashikuar në pikën "A", i dhe ii të Nenit 4304/3.

(B) Urdhrat e Tregut

- (i) Urdhrat e Pastër të Tregut: çdo pjesë e mbetur e paekzekutuar që shtohet në COB për ekzekutim sa më shpejt të jetë e mundur me çmimet e ardhshme.
- (ii) Urdhrat me limitim të tregut: janë urdhra blerje apo shitjeje, të cilat në tregtimin e vazhdueshëm ekzekutohen menjëherë kundrejt çmimit më të mirë, dhe në ankande ekzekutohen me çmimin e ankandit, me një pjesë të mbetur të paekzekutuar që shndërrohet automatikisht në një urdhër limit me çmimin më të fundit të ekzekutuar dhe shtohet në COB.

Neni 4305 MËNYRA E EKZEKUTIMIT DHE MENAXHIMIT TË URDRHAVE

Anëtari i ALSE ekzekuton urdhrat e blerjes dhe shitjes nëpërmjet Sistemit ETS, duke hedhur në COB kërkesën apo ofertën e përshtatshme, dhe duke i menaxhuar më tej këto urdhra në COB.

Menaxhimi i urdhreve përfshin: hedhjen në sistem, ndryshimin, konfirmimin, ndalimin dhe lirimimin ose fshirjen e urdhrit.

Neni 4306 PËRPARËSIA E EKZEKUTIMIT TË URDRHAVE

4306/1 Kur një urdhër regjistrohet (hidhet) në COB, atij i vendoset një shënjim kohor i njëjtë me kohën e regjistrimit të urdhrit.

4306/2 Urdhrat regjistrohen (hidhen) të renditur në librin e urdhreve COB duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme të përparësisë që zbatohen radhazi:

- (i) urdhrat e tregut kanë përparësi mbi urdhrat limit;
- (ii) urdhrat limit regjistrohen në COB të renditur në mënyrë të tillë që në ekzekutimin e urdhrit të blerjes të kenë përparësi ato me një çmim më të lartë, dhe në ekzekutimin e urdhreve të shitjes të kenë përparësi ato me një çmim më të ulët (*prioriteti i çmimit*);
- (iii) nëse disa urdhra kanë të njëjtin çmim, ata do të renditen duke i dhënë përparësi urdhreve me një shënjim kohor më të vjetër (*prioriteti i kohës*).

4306/3 Në rastet e ndryshimeve të urdhreve - nëse ndryshon çmimi i një urdhri ose shtohet një kusht i veçantë; nëse rritet sasia totale; nëse një urdhër tregu ndryshohet në një urdhër limit apo anasjelltas - COB i vendos urdhrit shënjinin e ri kohor të njëjtë me kohën e ndryshimit të urdhrit.

Neni 4307 LLOGARITË E TREGIMIT

4307/1 Llojet e Llogarive

Sistemi ETS lejon përdorimin e llojeve të mëposhtme të llogarive për Anëtarët e ALSE:

1. Llogari vetjake e Anëtarit (*house account*),
2. Llogari e klientit të Anëtarit (*client account*).

Llogaria vetjake është llogaria që përdoret nga Anëtari i ALSE për të mbajtur të dhënat e Titujve që zotëron në llogarinë e vet. Anëtari mund të ekzekutojë urdhra për llogari të vet vetëm nëpërmjet llogarisë së tij vetjake.

Llogaria e klientit është llogaria që përdoret nga Anëtari i ALSE për të mbajtur të dhënat e Titujve në pronësi të një klienti të Anëtarit përkatës. Anëtari i ALSE mund të ekzekutojë urdhrat për llogari të klientit vetëm përmes llogarisë së tij të klientit.

Anëtarët që transferojnë detyrimet e tyre të ndryshme dhe detyrimet që rrjedhin nga transferimi i Titujve nga transaksionet në Bursën ALSE të një anëtari shlyerës, lejohen nga Sistemi ETS, të përdorin kode të veçanta regjistrari dhe/apo llogari kujdestarie në përputhje me Rregulloret përkatëse të ALREG dhe AFISaR.

Udhëzimet mund të përcaktojnë më hollësisht përdorimin e nën-tipeve të llogarive në përputhje me rregullat e sistemit të shlyerjes.

4307/2 Përdorimi i Llogarive në rastin e shlyerjes nëpërmjet një tjetër Agjenti të Klerimit dhe Shlyerjes (CSM)

Pavarësisht Nenit 4307/1, Anëtari i ALSE jo-klerues dhe shlyerës, i cili shlyen transaksionet përmes një tjetër Agjenti të Klerimit dhe Shlyerjes (CSM) të AFISaR dhe/apo të ALREG, në bazë të marrëveshjes së parashikuar nga pika 2 e paragrafit të parë të Nenit 4702/1, duhet të përdorë vetëm ato llogari që janë zgjedhur nga Agjenti i Klerimit dhe Shlyerjes (CSM) përkatës për qëllime të shlyerjes së transaksioneve të realizuara në ALSE.

Gjatë përdorimit të llogarive sipas paragrafit të parë të këtij Neni, Anëtari i ALSE duhet të mbajë dy grupe të ndara të llogarive të Titujve në AFISaR dhe/apo në ALREG:

- (i) për titujt që zotëron për llogari të vet, dhe
- (ii) për Titujt që zotëron për llogari të klientëve të tij.

Anëtari i ALSE duhet ta arrijë këtë duke përdorur një llogari për urdhrat e realizuar në emër të vet dhe për llogari të vet dhe një tjetër llogari për urdhrat e realizuar në emër të vet dhe për llogari të klientëve të vet.

Përdorimi i detajuar i llogarive sipas paragrafit të parë dhe të dytë të këtij Neni përcaktohet nga udhëzimet e nxjerra nga Bursa ALSE në vazhdimësi.

SEKSIONI 4.4. CIKLET E TREGTIMIT NË LIBRIN QËNDROR TË URDHRAVE (COB)

Neni 4401 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

Titujt tregtohen ose nëpërmjet përputhjes së vazhdueshme të urdhrave në anët e kundërta të COB ose nëpërmjet procedurave të thirrjes së ankandit pas një periudhe gjatë së cilës urdhrat janë akumuluar pa u ekzekutuar.

Tregtimi i vazhdueshëm fillon me seancën e hapjes dhe lejon ekzekutimin e menjëhershëm të tregtimit nga urdhrat e regjistruar në COB, në bazë të përputhjes të kushteve të tyre, sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje. Në tregtimin e vazhdueshëm, çmimi i një transaksioni të ekzekutuar të Sistemin ETS rezulton nga kërkesa dhe oferta aktuale më e mirë dhe zakonisht përcaktohet nga urdhri në fjalë i regjistruar fillimisht në COB, dhe pastaj urdhrat përputhen me Sistemin ETS.

Në tregtimin me ankand, Titulli tregtohet në ankand, ku të gjitha transaksionet përfundojnë në të njëjtë kohë dhe me të njëjtin çmim. Çmimet përcaktohen në bazë të urdhrave që janë regjistruar në COB deri në fillim të ekzekutimit të tregtimit nga Sistemi ETS, në përputhje me kushtet e tyre, sipas kësaj Rregulloreje dhe me qëllimin për të arritur volumin maksimal të ekzekutueshëm.

Vendosja e Titujve në metodën e tregtimit të vazhdueshëm apo ankand përcaktohet nga ALSE në bazë të kritereve objektive, duke përfshirë (pa kufizime) volumin mesatar historik dhe të pritshëm të tregtimit, numrin mesatar të transaksioneve të ekzekutuara, penetrimin e tregut, përfshirjen në ALSE apo indekse të tjera të njohura ndërkombëtare.

Neni 4402 TREGTIMI I VAZHDUESHËM

4402/1 COB është i mbyllur

Në fazën kur Libri Qendror i Urdhrave (COB) është i mbyllur, menaxhimi i urdhrave dhe ekzekutimi i transaksioneve nuk është i mundur.

4402/2 Faza e para-hapjes

Një seancë hapjeje (faza e para-hapjes) mbahet në fillim të çdo Dite Tregtimi përpara fillimit të tregtimit të vazhdueshëm, sipas mënyrës dhe kohës së përcaktuar në një ose më shumë Njoftime. Në fazën e para-hapjes, menaxhimi i urdhrave në COB është i mundur, por ekzekutimi i tregtimit nuk është i mundur.

4402/3 Faza kryesore e tregtimit

Pas përfundimit të seancës së hapjes, tregtimi do të bëhet mbi baza të vazhdueshme në fazën kryesore të tregtimit, ku janë të mundshme menaxhimi i urdhrave dhe ekzekutimi i tregtimit. Në fazën kryesore të tregtimit, çdo urdhër hyrës kontrollohet menjëherë për ekzekutim të mundshëm përkundrejt urdhrave në anën tjetër të COB dhe ndonjë pjesë të mbetur të paekzekutuar të urdhrave që shtohet në COB (duke iu nënshtruar kushteve të ndryshme të ekzekutimit të lejuara nga Nenet 4302 dhe 4204).

Neni 4403 ANKANDET

4403/1 COB është i mbyllur

Në fazën kur Libri Qendror i Urdhrave (COB) është i mbyllur, menaxhimi i urdhrave dhe ekzekutimi i transaksioneve nuk është i mundur.

4403/2 Faza e thirrjes (para-hapjes)

Çdo ankand fillon me një fazë thirrjeje gjatë së cilës urdhrat regjistrohen automatikisht, por pa sjellë lindjen e detyrimit për të kryer transaksione. Gjatë kësaj faze thirrjeje, Anëtarët e ALSE mund të regjistrojnë urdhra të rinj, si dhe të ndryshojnë ose të anulojnë urdhrat ekzistues. Çmimi indikativ, i cili përfaqëson çmimin që sistemi i përputhjes përcakton në bazë të situatës së caktuar të COB, do të shfaqet dhe përditësohet vazhdimisht sipas evoluimit të situatës së COB.

4403/3 Faza e përcaktimit të çmimit

Pas përfundimit të fazës së thirrjes, sistemi përcakton një çmim në mënyrë që të prodhojë volumin maksimal të ekzekutueshëm sipas Nenet 4401/3. Gjatë kësaj faze të përcaktimit të çmimit nuk mund të regjistrohet asnjë urdhër i ri dhe urdhrat ekzistues nuk mund të ndryshohen apo anulohen.

4403/4 Faza e pas-tregtimit

Pas përcaktimit të çmimit të titujve, vjen faza e pas-tregtimit gjatë së cilës menaxhimi i urdhrave në COB është i lejuar në një nivel të kufizuar ndërsa ekzekutimi i tyre është i mundshëm në sistemin ETS duke lejuar tërheqjen nga pozicionet e më parshme dhe futjen e urdhrave IOC me çmimin e ankandit.

Neni 4404 MENAXHIMI I LIBRIT TË URDHRAVE PAS TREGTIMIT

Gjatë një periudhe pas mbylljes së tregtimit, e përcaktuar nga Nenet 4402 dhe 4403, Anëtarët e ALSE mund të aksesojnë COB për të regjistruar urdhra të rinj, si dhe për të ndryshuar ose anuluar urdhrat ekzistues për ditën pasardhëse të tregtimit.

Neni 4405 TREGTIMI NË BLOK

4405/1 Transaksionet në Bllok

Titujt e pranuar për tregtim në çdo segment të ALSE mund të jenë gjithashtu objekt i një tregtimi në bllok të rregulluar.

Një bllok është një transaksion burse që ekzekutohet në përputhje me dispozitat dhe kufizimet për

vlërën, në përputhje me këtë Nen.

Vlera minimale e transaksionit në bllok përcaktohet nga një udhëzim i Këshillit Mbikëqyrës.

4405/2 Tregtimi i Transaksioneve në Bllok

Transaksionet në Bllok mund të ekzekutohen vetëm gjatë fazës kryesore të tregtimit në metodën e tregtimit të vazhdueshëm dhe seancës së pas-tregtimit në metodën e ankandit.

4405/3 Çmimi i Transaksioneve në Bllok

Çmimi i një transaksioni në bllok nuk do të jetë objekt i kufizimeve të çmimeve sipas Nenit 4503 të kësaj Rregulloreje.

Çmimet e transaksioneve në bllok nuk do të merren parasysh në llogaritjet e mesatares zyrtare dhe të çmimeve mesatare të llogaritura nga ALSE. Për tregtimet në bllok nuk ka mesatare zyrtare dhe çmime mesatare të llogaritura.

4405/4 Mënyra e Ekzekutimit të Transaksioneve në Bllok

Ka dy mënyra se si transaksionet në bllok mund të ekzekutohen në Sistemin ETS:

1. Ekzekutimi i transaksioneve në bllok me një regjistrim të veçantë apo me pranimin e urdhrave në thellësi të tregut;
2. Ekzekutimi i transaksioneve të kryqëzuara dhe i transaksioneve të negociuara në bllloqet e Titujve, ku çmimi i transaksioneve të tilla në bllok duhet të jetë brenda intervalit të tregtimit ose në kufirin e tij.

Procedurat e realizimit të transaksioneve në bllok sipas pikës 1 të paragrafit të parë të këtij Neni, përcaktohen nga ALSE në një Udhëzim të Këshillit Mbikëqyrës.

Intervali i tregtimit sipas pikës 2 të paragrafit të parë të këtij Neni përfshin çmimet që devijojnë nga çmimi aktual i referencës me më pak se një përqindje e përcaktuar nga ALSE në një Udhëzim të Këshillit Mbikëqyrës. Çmimi i referencës për çdo Titull përcaktohet në mënyrë automatike nga vetë Sistemi ETS, bazuar në historikun e çmimeve dhe transaksioneve të ekzekutuara në Titullin përkatës.

Mënyra e realizimit të transaksioneve në bllok është e njëjtë për të gjitha Titujt, pavarësisht nga metoda e tregtimit të vazhdueshëm ose në ankand.

Neni 4406 TREGTIMI JASHTË ORARIT ZYRTAR

4406/1 Transaksionet e negociuara ose transaksionet jashtë burse (off-exchange)

Në bazë të Neneve 82 dhe 92 të Ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 "*Për Titujt*", transaksionet e kryera jashtë seancës së tregtimit (jashtë burse) nga investitorët institucionalë quhen transaksione të negociuara. Të gjitha transaksionet e negociuara të ekzekutuara nga Anëtarët ALSE dhe nga klientët e tyre në lidhje me të gjithë Titujt e pranuar për tregtim në ALSE, duhet të raportohen në ALSE dhe këta Anëtarë duhet të përmbushin të gjitha detyrimet njësoj si për transaksionet e ekzekutuara në seancën e tregtimit në bursë.

Transaksionet e ekzekutuara jashtë orarit zyrtar të fazave të tregtimit të Titujve të parashikuara në nenet 4402/2 e 4402/3 si dhe 4403/2, 4403/3 e 4403/4, konsiderohen si transaksione të negociuara. Oraret e hedhjes së transaksioneve të negociuara në sistemin ETS, përcaktohen në një Udhëzim nga ALSE.

Përveç nga sa parashikohet në paragrafin e mësipërm, transaksionet e negociuara mund të ekzekutohen nga Anëtarët në çdo ditë pune të ndryshme nga ditët e tregtimit që parashikon paragrafi i dytë i nenit 4102 të kësaj Rregulloreje, në intervalin kohor të përcaktuar në Udhëzimet e ALSE.

4406/2 Hedhja e Transaksionit të Negociuar në Sistemin ETS (raportimi)

Anëtarët e ALSE i hedhin transaksionet e negociuara për llogari të tyre dhe/ose klientëve të tyre në Sistemin ETS përpara fillimit të seancës më të afërt të para-tregtimit, ose pas seancës kryesore në tregtimin e vazhdueshëm apo seancës së pas-tregtimit të ankandeve.

Transaksioni i negociuar konsiderohet i pranuar sipas kësaj Rregulloreje vetëm pasi Sistemi ETS konfirmon përputhjen e një transaksioni të tillë nga të dy palët në transaksion.

4406/3 Çmimi i transaksionit të negociuar dhe shtrirja e çmimit

Anëtarët e ALSE që kanë rënë dakord jashtë bursës në lidhje me një transaksion të negociuar për llogari të tyre dhe/ose klientëve të tyre për një Titull të caktuar marrin si referencë të detyrueshme të çmimit të ekzekutimit, çmimin e fundit zyrtar për atë Titull në Ditën e fundit të Tregtimit.

Pa cënuar rregullat e zbatueshme për tregtimin në bllok, transaksionet e kryera jashtë seancës së tregtimit do të kryhen me një çmim brenda një shtrirjeje të çmimit prej një përqindjeje të caktuar të çmimit të fundit të tregtuar, ose të vlerës së fundit neto indikative të shpallur të aseteve në rastin e fondeve të investimeve sipas përcaktimeve të bëra nga ALSE në një Udhëzim të veçantë.

SEKSIONI 4.5. MEKANIZMAT ETREGUT

Neni 4501 PËRPUTHJA DHE EKZEKUTIMI I URDRHAVE NË LIBRIN QENDROR TË URDRHAVE

4501/1 Parimi i përparësisë së ekzekutimit

- (i) Urdhrat në COB ekzekutohen sipas "*përparësisë së çmimit*".
- (ii) Urdhrat me çmim të njëjtë renditen dhe regjistrohen sipas "*përparësisë në kohë*",

4501/2 Tregtimi i vazhdueshëm

Gjatë tregtimit të vazhdueshëm, çdo urdhër i regjistruar (hyrës) kontrollohet menjëherë për ekzekutim të mundshëm përkundrejt urdhrave në anën tjetër të COB. Urdhrat në COB ekzekutohen sipas parimit të përparësisë së ekzekutimit.

4501/3 Ankandet

Çmimi i ankandit përcaktohet duke u bazuar në gjendjen e COB në mbyllje të fazës së thirrjes dhe do të jetë çmimi që rezulton në volumin më të lartë të urdhrave të ekzekutueshëm.

Urdhrat e tregut kanë përparësi mbi urdhrat limit. Nëse ekzistojnë limite të ndryshme me volum maksimal të ekzekutueshëm të njëjtë, çmimi përcaktohet duke iu referuar çmimit të tregtimit të fundit të automatizuar (e rregulluar në mënyrë të tillë që të përfshijë çdo veprimi korporativ që mund të ketë ndodhur gjatë këtij harku kohor) ose, nëse nuk disponohet një çmim i tillë, një çmim tjetër referencë të përcaktuar në përputhje me një ose më shumë Udhëzime me këtë objekt, derisa të merret vetëm një çmim ankandi.

Neni 4502 TRANSAKSIONET E KRYQËZUARA

4502/1 Transaksionet e Kryqëzuara përfshijnë regjistrimin (hyrjen) dhe ekzekutimin e njëkohshëm, nga i njëjti Anëtar i ALSE, të urdhrave të kundërt të blerjes dhe shitjes të Klientëve për të njëjtën sasi të një Titulli të caktuar dhe me të njëjtin çmim në COB.

4502/2 Transaksionet e Kryqëzuara mund të ekzekutohen vetëm gjatë fazës kryesore të tregtimit në metodën e tregtimit të vazhdueshëm, nëse çmimi i këtij tregtimi është brenda intervalit midis çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes më të mirëaktual, duke përfshirë kufijtë. Këto transaksione të kryqëzuara nuk mund të ekzekutohen me një çmim jashtë intervalit të tregtimit.

4502/3 Një Transaksion i Kryqëzuar do të konsiderohet se është ekzekutuar pasi një Anëtar t'i ketë regjistruar urdhrat për një transaksion të tillë në COB, me të dhënat e parashikuara në Nenin 4502/1. Data dhe ora e ekzekutimit të një transaksioni të tillë janë data dhe ora e regjistrimit të urdhrat në COB dhe në Sistemin ETS.

Neni 4503 KUFIZIMET E ÇMIMIT, URDRHAVE DHE NDËPRERJET E TREGTIMIT

4503/1 Kufizimet Ditore të luhatjes së Çmimeve (Kufinjë Statikë)

Transaksionet e Titujve që janë pranuar për tregtim ekzekutohen me çmimet që nuk ndryshojnë nga çmimi i fundit mesatar zyrtar i një dite më parë të tregtimit më shumë se një nivel minimal dhe maksimal i shprehur në formën e një përqindje që përcaktohet herë pas here me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës të ALSE. Kufizimi i parashkuar në këtë Nen, për ndryshimet minimale dhe maksimale të çmimeve ka vlefshmëri ditore. Bazuar në përqindjen e përcaktuar nga Këshilli Mbikëqyrës i ALSE, Sistemi ETS llogarit në mënyrë automatike nivelin minimal dhe maksimal të luhatjes së çmimeve për Ditën e Tregtimit pasardhëse.

Në momentin kur çmimi i një Titulli të pranuar për tregtim arrin limitin statik maksimal ose minimal të parashkuar në paragrafin e parë të këtij Neni, ALSE pezullon tregtimin në këtë Titull për atë ditë, deri ditën e tregtimit pasardhëse.

Në ditën e parë të tregtimit të një Titulli në Bursën ALSE, çmimi i tij formohet lirshëm. ALSE mund të nxjerrë një Vendim të veçantë që rendit disa ditë radhazi që nga fillimi i tregtimit të një Titulli kur çmimi i tij duhet të formohet lirshëm.

Pavarësisht nga ndalimi i parashkuar në paragrafin e dytë të këtij Neni, ALSE mund të heqë ose të ndryshojë përkohësisht kufizimin ditor të luhatjes së çmimeve, në rast të luhatjeve të mëdha të tregut apo rrethanave të tjera të jashtëzakonshme që lidhen me një Titull të caktuar. Një Vendim i tillë miratohet nga Administratori i ALSE për një periudhë kohore deri në tre (3) ditë pune. Për periudha më të gjata, ky vendim miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i ALSE.

ALSE njofton menjëherë AMF-në, Anëtarët dhe publikun për situatat e parashkuara në paragrafin katërt të këtij Neni.

4503/2 Ndërprerjet e Menjëhershme të Tregtimit pas luhatjeve të Çmimeve (Kufinjë Dinamikë)

Për të krijuar mbrojtje ndaj luhatjeve të tepruara të çmimeve, Sistemi ETS fillon ndërprerjen e luhatshmërisë në një nga mënyrat e mëposhtme:

- (i) Pezullon tregtimin e një Titulli të tregtuar në mënyrë të vazhdueshme duke iniciuar një ankand, ose
- (ii) Zgjat fazën para-tregtimit gjatë hapjes së librit qendror të urdhrave (COB) në tregtimin e vazhdueshëm dhe në ankand, në bazë të udhëzimeve përkatëse.

Ndërprerja e tregtimit si rezultat i luhatshmërisë së çmimit të një Titulli kryhet në rastin e një transaksioni potencial që përfundon me një çmim jashtë intervalit të tregtimit. Ky interval përfshin çmimet që devijojnë nga çmimi i fundit i referencës me më pak se përqindja e përcaktuar nga Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të ALSE.

Gjatë ndërprerjes së tregtimit si rezultat i luhatshmërisë së çmimit;

1. Hiqen kufizimet e intervalit të tregtimit;
2. Shtyhet ose zgjatet faza e para-tregtimit;
3. Hapja e COB kryhet në përputhje me udhëzimet përkatëse;
4. Formohet një çmim i ri i referencës në bazë të udhëzimeve përkatëse;
5. COB hyn në fazën kryesore të tregtimit ose në fazën e pas-tregtimit.

Koha dhe procedura më e detajuar për kryerjen e ndërprerjes së tregtimit si rezultat i luhatshmërisë së çmimit përcaktohet nga udhëzimet.

4503/3 Ndërprerjet e Përkohshme të Tregtimit pas luhatjeve të Çmimeve

Në rast të luhatjeve të mëdha të çmimeve ose rrethanave të tjera të pazakonta (p.sh: ndryshime të mëdha të volumit, një çekuilibrim i tregut, etj.) në fillim të ose gjatë tregtimit, ALSE mund të ndryshojë orarin e tregtimit ose të pezullojë tregtimin e një Titulli për një periudhë të shkurtër kohe

(brenda ditës), derisa rrethanat e tilla të kthehen në normale. Një Vendim i tillë miratohet nga Administratori i ALSE.

Nëse vlera e një indeksi të Bursës ALSE devijon nga vlera e mbylljes së indeksit përkatës të një dite më parë të tregtimit me më shumë se kufinj të kufizues që përcaktohet nga Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të ALSE të parashkuar në paragrafin e parë të Nenit 4503/1, atëherë ALSE mund të pezullojë përkohësisht tregtimin. Procedurat e detajuara përcaktohen në Udhëzime nga Bursa ALSE.

Me rifillimin e tregtimit të një Titulli, ALSE i mundëson Anëtarëve të menaxhojnë urdhrat paraprakisht - domethënë urdhrat që u referohen Titujve sipas paragrafit të parë dhe të dytë të këtij Neni - për të paktën 15 minuta. Pas kësaj, hapet Libri Qendrori Urdhrave (COB).

Veçanërisht në raste të tilla si heqja nga tregtimi i Titujve në ALSE, veprimet korporative që rezultojnë në karakteristika të ndryshuara të Titullit (të tilla si ndarja e aksioneve, bashkimet e aksioneve, etj.), përjashtimi i një Anëtari nga Anëtarësimi në ALSE, ndryshimi i simbolit të Titullit, ndryshimi i valutës tregtare dhe ngjarje të tjera të ngjashme, ALSE mund të vendosë që të gjithë urdhrat e një Titulli të tillë, të cilat kanë qenë vendosur në Sistemin ETS para pezullimit të tregtimit, t'i çregjistrojë në mënyrë automatike nga Sistemi ETS pas rifillimit të tregtimit ose heqjes nga tregtimi.

Koha e parashkuar në paragrafin e parë ose të dytë të këtij Neni dhe zgjidhja e parashkuar në paragrafin e tretë ose të katërt të këtij Neni, specifikohen në Vendimin e ALSE për rifillimin e tregtimit të një Titulli të caktuar apo në një Vendim të veçantë, e cila duhet t'u njoftohet të gjithë Anëtarëve të ALSE, AMF-së dhe publikut.

4503/4 Kufizimi i Përkohshëm i përdorimit të Llojeve të Urdhrave të caktuar

Me qëllim që të sigurohen transaksione të rregullta në tregun e ALSE, në rastet e luhatjeve të mëdha të çmimeve, Këshilli Mbikëqyrës i ALSE mund të miratojë një Vendim që kufizon përkohësisht përdorimin e llojeve të caktuara të urdhrave.

Në bazë të mënyrës së parashkuar nga paragrafi i pestë i Nenit 4503/3 të kësaj Rregulloreje, ALSE njofton menjëherë Anëtarëte saj, AMF-në dhe publikun për përmbajtjen e një Vendimi të tillë dhe kohëzgjatjen e masës së miratuar.

Neni 4504 PEZULLIMET E TREGTIMIT

4504/1 Arsyet për pezullimet e tregtimit

ALSE e pezullon përkohësisht tregtimin e Titujve në Sistemin ETS në rast se:

- (a) vendimi i pezullimit ose ndalimit të tregtimit është marrë nga Autoriteti Kompetent;
- (b) sipas gjykimit të vetëm të ALSE, Titujt nuk i përmbushin më kushtet për t'u tregtuar, përveç rasteve kur një pezullim i tillë mund të dëmtojë ndjeshëm interesat e investitorëve dhe veprimet normale të ALSE;
- (c) sipas gjykimit të vetëm të ALSE, pezullimi është i nevojshëm për shkak të procedurave të konvertimit ose për shkak të ndryshimeve të tjera të Titujve në Institucionet e Klerimit dhe Shlyerjes, në mënyrë të veçantë në lidhje me ndryshimet e kapitalit, bashkimet dhe ristrukturimin e shoqërisë (Emetuesi);
- (d) merr një kërkesë të mirë arsyetuar me shkrim nga Emetuesi për një pezullim të përkohshëm të tregtimit të Titujve të tij.
- (e) sipas gjykimit të vetëm të ALSE vihet re se mes Anëtarëve dhe/ose investitorëve ka rrjedhje të informacionit të privilegjuar për një titull të caktuar, sipas përcaktimeve të "Ligjit për Titujt" në lidhje me këtë çështje.

ALSE lajmëron publikisht nëpërmjet një Njoftimi të vecantë dhe/apo nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik (faqe zyrtare e internetit të ALSE), publikun dhe të gjitha palët e interesuara lidhur me pezullimin e tregtimit në Bursën ALSE përkohësisht apo përfundimisht.

4504/2 Rifillimi i tregtimit

Në rastet e përshkruara në gerrat (a) dhe (b) të paragrafit të parë të Nenit 4504/1 të Rregullores, ALSE vepron si më poshtë:

- (i) *rifillon tregtimin* pasi ka marrë një Njoftim ose i është bërë e ditur ose gjykon se arsyet e pezullimit kanë përfunduar, ose
- (ii) *nis procedurën e heqjes nga listimi/tregtimi* në përputhje me Nenin 6803 të kësaj Rregulloreje.

Në rastin e përshkruar në gerrën (c) të paragrafit të parë të Nenit 4504/1, pezullimi i përkohshëm i tregtimit do të vazhdojë – derisa ALSE të marrë një vendim dhe një garanci nga Institucioni/et e Klerimit dhe Shlyerjes se janë përmbushur kushtet për tregtimin e aksioneve që janë objekt i vendimit.

Në rastet e përshkruara në gerrën (d) të paragrafit të parë dhe në paragrafin e dytë të Nenit 4504/1, pezullimi i përkohshëm i tregtimit të Titujve të veçantë vazhdon deri në shpalljen publike përkatëse, ose deri në tre (3) Ditë Tregtimi, përveç rasteve kur rrethanat e një rasti të veçantë ose Emetuesi kërkojnë pezullimin për një kohë më të gjatë.

Për të rifilluar tregtimin e një Titulli, ALSE u mundëson Anëtarëve që të menaxhojnë urdhrat paraprakisht për të paktën 15 minuta. Pas kësaj, COB hapet dhe Sistemi ETS rifillon ekzekutimin e urdhrave të regjistruar.

4504/3 ALSE nxjerr një vendim në lidhje me rifillimin e tregtimit të një Titulli të caktuar ose një rezolutë të posaçme, të cilat u njoftohen Anëtarëve të Bursës, AMF-së dhe publikut.

Neni 4505 ANULIMI OSENDRYSHIMI ITREGTIMIT

4505/1 Anulimi ose ndryshimi i transaksioneve

ALSE mund të anulojë ose ndryshojë transaksionet nën autoritetin e saj, në rastet kur ato janë kryer:

- (i) në shkelje të Rregullores, në veçanti të asaj pjese të saj që lidhet me parimet e funksionimit të drejtë, të rregullt dhe efikas të tregut; ose
- (ii) në kushte jo të rregullta tregtimi; ose
- (iii) në kushtet e gabimeve të qarta materiale.

Kompetencat për anulimin ose ndryshimin e transaksioneve nën autoritetin e ALSE përfshijnë transaksionet e ekzekutuara nga Anëtarët e saj në Sistemin ETS (*në Bursë*) dhe transaksionet e kryera jashtë orarit të tregtimit (*jashtë Burse*).

Gjithashtu, me kërkesë të një prej palëve në transaksion:

- (a) ALSE, për disa lloje Titujsh të përcaktuar në një Njoftim të veçantë, mund të anulojë transaksionet e ekzekutuara me karakteristika (çmim, sasi etj.) jonormale; ose
- (b) ALSE mund të anulojë transaksione në marrëveshje me palën/palët në transaksion, duke u bazuar në shpjegimet e dhëna nga Anëtari/ët në fjalë.

ALSE mund të anulojë të gjitha transaksionet e një Titulli të tregtuar në metodën e tregtimit me ankand, pavarësisht këtij Neni, dhe të nisë një ankand të përsëritur për Titullin përkatës në po atë ditë tregtimi.

4505/2 Procedura e fillimit të anulimit

Kur ka arsye bindëse, ALSE anulon një transaksion të ekzekutuar *në Bursë* e *jashtë Burse* dhe vërteton nisjen e kësaj procedure.

Po ashtu, ALSE e anulon një transaksion të ekzekutuar *në Bursë* dhe *jashtë Burse* në rast se Anëtari/ët përkatës dorëzojnë një aplikim për anulim të transaksionit, si dhe të dhënat përkatëse të urdhrat që lidhen me transaksionin e anuluar dhe dokumentet e tjera në lidhje me transaksionin

e anuluar dhe evidentimin e gabimit.

4505/3 ALSE informon Anëtarin/ët ALSE sipas kushteve të përcaktuara në Nenin 4603/1, sa më shpejt të jetë e mundur pas një anulimi të tillë, nëse bëhet gjatë ciklit të tregtimit dhe, për anulimet e bëra pas mbylljes së tij, maksimumi përpara hapjes së Ditës së Tregtimit vijuese.

4505/4 Anulimi i transaksionit bëhet sipas tarifave të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i ALSE (Shtojca 2).

SEKSIONI 4.6. KONFIRMIMI, RAPORTIMI DHE PUBLIKIMI

Neni 4601 KONFIRMIMI

4601/1 Sistemi ETS dërgon një mesazh pranimi për urdhrat e regjistruar në COB dhe u cakton këtyre të fundit nga një numër rendor sipas Titullit, të cilët i jepen Anëtarit përkatës të ALSE. Pas çdo ekzekutimi të plotë ose të pjesshëm të çfarëdo urdhri, Sistemi ETS u dërgon palëve përkatëse në transaksion një konfirmim të ekzekutimit.

Neni 4602 RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE

4602/1 Objekti

Ky Nen rregullon vetëm transaksionet e kryera sipas Rregullores së ALSE.

4602/2 Transaksionet në Librin Qendror të Urdhrave (COB)

Transaksionet e realizuara në COB konsiderohen automatikisht dhe menjëherë si të kryera në ALSE dhe si të raportuara te kjo e fundit.

4602/3 Transaksionet jashtë orarit zyrtar të punës së ALSE

Të gjitha transaksionet e negociuara, të cilat Anëtarët i ekzekutojnë jashtë orarit zyrtar të punës së ALSE duhet t'i raportohen ALSE. Anëtarët i raportojnë ALSE në lidhje me një transaksion të negociuar brenda një (1) ore pasi kanë rënë dakord ndërmjet tyre. Në rast se ata bien dakord pas orarit zyrtar të punës së ALSE (pas orës 17.00), ky transaksion i negociuar duhet t'i raportohet ALSE në ditën vijuese, brenda orarit të përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 4406/1.

Neni 4603 PUBLIKIMI

4603/1 Përkufizimet

Për qëllimet e Nenit 4503, "publikimi" interpretohet si shpërndarja e informacionit rreth shitësve të kualifikuar të informacionit (data vendors) dhe personave të tjerë juridikë dhe fizikë që kanë nënshkruar marrëveshjen për shpërndarjen e të dhënave të Tregut të ALSE.

Sipas kriteve të marrëveshjes së shpërndarjes së përmendur në këtë Nen, ALSE mund t'i bëjë këto shpallje:

- (i) në kohë reale, ose
- (ii) me një diferencë kohore minimale prej tridhjetë (30) minutash nga transaksionet në kohë reale,
- (iii) në fund të seancës së tregtimit në ditën aktuale të tregtimit.

4603/2 Transparenca përpara tregtimit

ALSE do të shpallë vazhdimisht para fillimit të tregtimit këtë informacion në lidhje me Ditën e Tregtimit paraardhëse:

- (i) *tregu sipas urdhrave*; pra të gjithë urdhrat e paekzekutuar në një kohë të caktuar, përveç rasteve kur zbatohet ndonjë procedurë tjetër për shkak të ndonjë veprimtarie ekstreme të përcaktuar me anë të një Njoftimi të veçantë;
- (ii) *tregu sipas kufijve*; pra kufijtë e dhjetë (10) çmimeve më të mira blerje/shitje në COB, duke përfshirë numrin e urdhrave dhe sasinë e plotë të urdhrave të shpallur në secilin kufi.

Gjatë fazës së thirrjes së ankandeve, ALSE shpall vazhdimisht çmimin e supozuar të hapjes dhe komponentët e volumit që mund të ekzekutohen me këtë çmim.

4603/3 Transparenca pas tregtimit

Për çdo transaksion të kryer në Sistemin ETS, ALSE në përputhje me Nenin 4603/1 shpall sasinë, çmimin dhe orën e ekzekutimit të transaksionit.

Për çdo transaksion të kryer jashtë orarit zyrtar, ALSE e publikon në faqen zyrtare të internetit sasinë, çmimin dhe orën e ekzekutimit tij në ditën vijuese.

4603/4 Përdorimi i të dhënave të tregut nga Anëtarët e ALSE

Përdorimi i të dhënave të tregut nga Anëtarët e ALSE rregullohet nga marrëveshja e shpërndarjes së të dhënave të tregut të lidhur mes tyre dhe ALSE.

SEKSIONI 4.7. KLERIMI DHE SHLYERJA

Neni 4701 INSTITUCIONET E KLERIMIT DHE SHLYERJES

4701/1 ALSE do të caktojë institucionet e Klerimit dhe Shlyerjes të licensuar siç duhet dhe/ose të njohura nga Autoriteti Kompetent përkatës për klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve.

4701/2 Marrëdhëniet kontraktuale që lindin si pasojë e ekzekutimit dhe klerimit e shlyerjes së transaksioneve specifikohen, ndër të tjera, në marrëveshjen që lidhet ndërmjet ALSE dhe Institucioneve të Klerimit dhe Shlyerjes (Shtojca 3).

4701/3 Sipas Nenit 4701/1, për transaksionet me Titujt e Qeverisë (bonot e thesarit, obligacionet e thesarit, bonot e Bankës së Shqipërisë) klerimi dhe shlyerja bëhet nga Sistemi Qendror i Regjistrimit dhe Shlyerjes së Titujve (AFISaR), që është shtëpia e klerimit e caktuar për këtë qëllim nga Qeveria Shqiptare dhe Banka e Shqipërisë.

4701/4 Sipas Nenit 4701/1, për transaksionet me Tituj që nuk janë emetuar nga Qeveria, klerimi dhe shlyerja kryhet nga ALREG, që është shtëpia e klerimit e caktuar për këtë qëllim nga ALSE.

4701/5 Sipas Nenit 4701/1, shlyerja me mjete monetare (cash) e transaksioneve kryhet nga Institucionet e Klerimit dhe Shlyerjes të licensuara nga Autoritetet Kompetente dhe të cilat ALSE ka nënshkruar marrëveshje caktuara për këtë qëllim nga ALSE.

Neni 4702 KUSHTET E SHLYERJES SË TRANSAKSIONEVE NË ALSE

4702/1 Anëtarët e ALSE duhet të sigurojnë shlyerjen e transaksioneve në bursë në një nga mënyrat e mëposhtme:

1. Duke u pranuar, përveç Anëtarësimit në ALSE, si *Agjentë të Klerimit dhe Shlyerjes (CSM)* në një Institucion Klerimi dhe Shlyerjeje sipas Nenit 4701. Anëtari i ALSE që është njëkohësisht edhe CSM mund të shlyejë në mënyrë të drejtpërdrejtë transaksionet e ekzekutuara në ALSE, për llogari të vet apo klientëve të vet.
2. Duke ruajtur vetëm statusin e një Anëtari të ALSE *jo-klerimi dhe shlyerjeje*, por duke nënshkruar një marrëveshjeje me një *Agjent Klerimi dhe Shlyerje (CSM)* i cili duhet të jetë anëtar i ALSE, që siguron shlyerjen në mënyrë indirekte për transaksionet e ekzekutuara në ALSE për llogari të Anëtarit përkatës në ALSE.

Çdo Anëtar jo-klerimi dhe shlyerje sipas nenit 4702/1 pika 21, gjatë tregtimit në ALSE duhet t'i përmbahet vazhdimisht rregullit për përdorimin e llogarive sipas Nenit 4307/2 të kësaj Rregulloreje.

4702/2 Çdo Anëtar jo-klerimi dhe shlyerje duhet të sigurohet që kolaterali i lënë pranë Agjentit të tij të Klerimit dhe Shlyerjes (CSM) të jetë gjatë gjithë kohës i përshtatshëm për kufirin e detyrimeve të

tij, në pajtim me kontratën që ka me këtë CSM si dhe me Ligjet Shqiptare që rregullojnë veprimtarinë e Institucioneve të Klerimit dhe Shlyerjes (kur është e aplikueshme).

4702/3 Një Agjent Klerimi dhe Shlyerjeje (CSM) duhet të njoftojë menjëherë ALSE nëse ndonjë Anëtar jo-klerimi dhe shlyerje për të cilin ai bën klerim dhe shlyerje, nuk vepron në pajtim me Nenin 4702/2.

4702/4 Për të tregtuar në ALSE, çdo Anëtar jo-klerimi dhe shlyerje që nuk është CSM në lidhje me Titullin të cilin ai është i autorizuar të tregtojë, duhet të ketë dorëzuar tek ALSE një autorizim klerimi dhe shlyerjeje të parevokueshëm dhe të vlefshëm, i cili mund të jetë ose kopje e Marrëveshjes së Klerimit dhe Shlyerjes e lidhur nga ky Anëtar me një CSM, ose konfirmim me shkrim për ekzistencën e një Marrëveshjeje të tillë Klerimi dhe Shlyerje nga një Anëtarë CSM.

Neni 4703 KLERIMI DHE SHLYERJA PËR TRANSAKSIONET NË BURSË DHE JASHTË BURSE

Transaksionet e ekzekutuara në ALSE përmes Sistemit ETS(*në Bursë*) do të klerohen dhe shlyhen në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Rregullat përkatësetë Klerimit dhe Shlyerjes, si dhe shlyerja do të kryhet përmes institucioneve të shlyerjes të caktuara nga ALSE, në përputhje të plotë me Nenin 4701 të kësaj Rregulloreje.

Ndonëse i raportohen ALSE, Anëtarët e ALSE i klerojnë dhe shlyejnë vetë transaksionet e negociuara (*jashtë Burse*) të ekzekutuara, drejtpërdrejt tek institucionet e klerimit dhe shlyerjes, përmes Anëtarëve të tyre të CSM.

ALSE nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për problemet apo dështimin e transaksioneve të negociuara (*jashtë Burse*).

Neni 4704 PËRCJELLJA E INFORMACIONIT INSTITUCIONEVE TË CAKTUARA TË KLERIMIT DHE SHLYERJES

Në fund të ditës së tregtimit, por jo më vonë se ora 16.00, ALSE u dërgon institucioneve të caktuara të shlyerjes informacionin e nevojshëm lidhur me transaksionet ditore të ekzekutuara nga Anëtarët nëtreg, siç parashikohet në Nenet 4701/3, 4701/4 dhe 4701/5, me qëllimin për të vijuar me procesin e klerimit dhe shlyerjes në institucionet përkatëse.

Neni 4705 FORMATI I INFORMACIONIT

Formati i informacionit dhe të dhënave që duhet të dërgohen për kryerjen e procesit të klerimit dhe shlyerjes përcaktohet bashkërisht ndërmjet ALSE dhe institucioneve të caktuara të shlyerjes.

Neni 4706 PARIMI DVP PËR KLERIMIN DHE SHLYERJEN

Parimi që zbatohet për klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve të ekzekutuara në ALSE është parimi "*dorëzim kundrejt pagesës*" / Delivery versus Payment (DVP).

Neni 4707 PERIUDHA E KLERIMIT DHE SHLYERJES

Periudha e nevojshme për kryerjen e procesit të klerimit dhe shlyerjes për transaksionet e ekzekutuara në ALSE është dy ditë pune pas ekzekutimit të transaksionit (T+2).

Neni 4708 PROCEDURA NË RAST DËSHTIMI (DEFAULT)

Dështimi normal dhe dështimi final për procedurat e klerimit dhe të shlyerjes së transaksioneve të ekzekutuara në ALSE (*për transaksionet me Titujt qeveritarë*) përcaktohen në rregullat dhe procedurat e miratuara nga ALSE.

Dështimi normal dhe dështimi final për procedurat e klerimit dhe të shlyerjes së transaksioneve të ekzekutuara në ALSE (*në Bursë dhe të cilat nuk përfshijnë transaksionet me Titujt qeveritarë*), do të kryhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e institucioneve të caktuara të klerimit dhe shlyerjes.

KAPITULLI 5: SEGMENTET E TREGUT DHE KLASIFIKIMI I TITUJVE

SEKSIONI 5.1. SEGMENTET DHE NËNSEGMENTET

Neni 5101 SEGMENTET E TREGUT

5101/1 Tregu i ALSE është i ndarë në tre segmente si më poshtë:

- (i) Tregu Hyrës;
- (ii) Tregu Zyrtar Standard;
- (iii) Tregu Zyrtar Kryesor.

5101/2 Tregu Hyrës është një segment i Tregut ALSE, ku tregtohen ata Tituj që përmbushin kushtet për tregtim, siç përcaktohet në Seksionin 6.6 të kësaj Rregulloreje, ndërkohë që dhe Aplikanti për listim përmbush detyrimet sipas Ligjeve Shqiptare.

5101/3 Tregu Zyrtar Standard dhe Tregu Zyrtar Kryesor janë ato segmente të Tregut ALSE, ku tregtohen ata Tituj që plotësojnë - së bashku me plotësimin e kushteve për listimin/tregtim sipas 5101/2 – kriteret shtesë për klasifikimin e tyre në Tregun Zyrtar Standard dhe Tregun Zyrtar Kryesor, siç përcaktohet nga Rregullorja, ndërkohë që Emetuesit e tyre respektojnë detyrimin për publikimin e informacionit në përputhje me Ligjet Shqiptare, si dhe angazhohen për të përmbushur detyrimet shtesë të publikimit të informacionit sipas Rregullores.

Neni 5102 NËNSEGMENTET E TREGUT SIPAS TITUJVE

5102/1 Në bazë të llojit të Titujve të tregtuar në secilin prej Tregjeve, në atë Hyrës, Standard dhe Kryesor, Tregu ALSE përbëhet nga nënsegmentet e mëposhtme:

- (i) Tregu i kapitalit;
- (ii) Tregu i obligacioneve dhe i Titujve të tjerë të borxhit publik/privat;
- (iii) Tregu i shoqërive të investimeve (*closed-ended funds*);
- (iv) Tregu i fondeve të investimeve (*open-ended funds*);
- (v) Tregu i Titujve të tjerë të transferueshëm.

5102/2 Sipas Nenit 6702, tregu i kapitalit liston/tregon aksione dhe Dëftesa depozitari që përfaqësojnë aksionet dhe titujt e tjerë të kapitalit.

5102/3 Sipas Nenit 6703, tregu i obligacioneve dhe i Titujve të tjerë të borxhit publik/privat dhe Dëftesa depozitari që përfaqësojnë obligacionet.

5102/4 Sipas Nenit 6704, tregu i shoqërive të investimit liston aksione të shoqërive të investimit dhe Dëftesa depozitari që përfaqësojnë kuotat e shoqërive të investimit.

5102/5 Sipas Nenit 6705, tregu i fondeve të investimeve liston/tregon kuotat e fondeve të investimeve dhe kuotat e fondeve të investimit të tregtuara elektronikisht në Bursë (ETFs).

5102/6 Sipas Nenit 6706, tregu i Titujve të tjerë të transferueshëm liston/tregon garancitë, të drejtat lirisht të transferueshme me rritjen e kapitalit aksionar, produkte të tjera të strukturuar dhe Dëftesa depozitari që përfaqësojnë këta Tituj.

Neni 5103

Pa çenuar Seksionin 5.1 të kësaj Rregulloreje, ALSE mund të krijojë segmente dhe nënsegmente specifike në Tregun e Titujve në të cilin operon, mbështetur në kritere të tjera sasiore dhe cilësore, si dhe t'u alokojë Tituj këtyre segmenteve të ndryshme. Alokimi do të rishikohet në mënyrë periodike. Titujt e përfshirë në Segmentin e Rikuperimit ose në Segmentin nën Mbikëqyrje nuk përfshihen në këto segmente.

SEKSIONI 5.2. KLASIFIKIMI DHE TRANSFERIMI I TITUVJENË SEGMENTET E TREGUT

Neni 5201 VENDIM MARRJA PËR KLASIFIKIMIN E TITUVJE

5201/1 ALSE vendos për listimin dhe/ose tregtimin e Titujve në Tregun ALSE mbi bazën e një aplikimi të depozituar për listim dhe/ose tregtim siç parashikohet në Seksionin 6.3.

5201/2 Në aplikimin për listim dhe/ose tregtim, Aplikanti duhet të tregojë se cilit segment tregu të Tregut ALSE i referohet aplikimi.

5201/3 Së bashku me vendimin për listimin/tregtimin e Titujve sipas Seksionit 6.3, ALSE nxjerr një rezolutë për klasifikimin e Titujve në nënsegmentin më të lartë të mundshëm për të cilin ata përmbushin kushtet dhe kriteret e kërkuara nga kjo Rregullore.

5201/4 Vendimi i ALSE për klasifikimin e Titujve sipas 5201/1 dhe 5201/2 është përfundimtar dhe nuk mund të apelohehet.

Neni 5202 FILLIMI I TREGTIMIT TË TITUVJE

5202/1 Pas miratimit nga ALSE për listimin dhe/ose tregtimin e Titujve, Aplikanti është përgjegjës për të paguar tarifën përkatëse, sipas Planit Tarifor të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, brenda afatit të përcaktuar në pjesën operacionale të vendimit për listimin dhe/ose tregtimin e aksioneve në Tregun ALSE (Shtojca 2).

5202/2 Pasi të jenë përmbushur detyrimet sipas Nenit 5202/1, ALSE duhet të specifikojë datën e parë të tregtimit sipas Nenit 6303. Ajo informon për këtë Anëtarët, publikun dhe Emetuesin të paktën tre (3) ditë pune përpara fillimit të tregtimit.

Neni 5203 TRANSFERIMI I TITUVJE NË SEGMENTET E TREGUT

5203/1 *Transferimi me kërkesë të Emetuesit*

Procedura e transferimit mund të iniciohet me kërkesë të Emetuesit, ku ai paraqet një kërkesë për transferimin e Titujve të tij në një segment tjetër nga ai ku është aktualisht i listuar/tregtuar. Formulari i kërkesës për transferim përcaktohet në udhëzime.

Gjatë miratimit të vendimeve në lidhje me transferimet e Titujve, ALSE merr parasysh dispozitat që rregullojnë vendimmarrjen e saj për klasifikimin e aksioneve, sipas Nenit 5201/3 të Rregullores.

Nëse, në bazë të kërkesës sipas paragrafit të parë të këtij Neni, ALSE arrin në përfundimin se Titujt përkatës nuk i plotësojnë kushtet për transferimin në segmentin e kërkuar, ajo informon Emetuesin dhe e fton atë për të komentuar. Nëse kërkesa është e keqbazuar, atëherë ALSE miraton një Vendim që rrëzon kërkesën për transferimin e Titujve.

ALSE vendos për çështjet që lidhen me transferimet e Titujve brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës së plotë. Data, në të cilën transferimi hyn në fuqi, përcaktohet në Vendimin e ALSE mbi transferimin e Titujve përkatës.

Nëse Titujt e Emetuesit, për të cilat ai ka paraqitur kërkesë për transferim në Tregun Zyrtar Standard apo në Tregun Zyrtar Kryesor, kanë qenë transferuar më parë jashtë Tregut Zyrtar Standard ose Tregut Zyrtar Kryesor, atëherë Emetuesi mund të paraqesë kërkesë për transferim në Tregun Zyrtar Standard ose Tregun Zyrtar Kryesor vetëm pasi të kenë kaluar gjashtë (6) muaj nga transferimi fillestar. ALSE mund të transferojë Titujt përkatës në Tregun Zyrtar Standard ose Tregun Zyrtar Kryesor me kusht që të jenë plotësuar kushtet dhe kriteret përkatëse, dhe nëse ajo vlerëson se listimi/tregtimi i këtyre Titujve në Tregun Zyrtar Standard ose Tregun Zyrtar Kryesor nuk kompromenton standardet e këtyre segmenteve të tregut.

5203/2 Transferimi në bazë të Kriteve të Rishikuara nga ALSE

Çdo gjashtë (6) muaj, ALSE kryen një rishikim periodik për të kontrolluar nëse Titujt plotësojnë apo jo kriteret për tregtimin të tyre në Tregun Zyrtar Standard ose Tregun Zyrtar Kryesor. Kriteret dhe procedurat e përdorura nga ALSE për rishikimin periodik përcaktohen në një Udhëzim të Këshillit Mbikëqyrës.

KAPITULLI 6: PRANIMI NË LISTIM/TREGTIM DHE DETYRIMET E VAZHDESHME TË EMETUESVE

SEKSIONI 6.1. OBJEKTI I KAPITULLIT

Neni 6101 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kapitulli 6 përcakton:

- (i) kërkesat dhe procedurat për pranim në listim/tregtim dhe heqjen nga listimi/tregtimi të Titujve në ALSE,
- (ii) masat për listim/tregtim që mund të merren për të lehtësuar funksionimin e drejtë, të rregullt dhe efikas të tregjeve në ALSE; dhe
- (iii) detyrimet në vazhdimësi të Emetuesve, Titujt e të cilëve pranohen në listim/tregtim me pëlqimin e tyre (duke përfshirë, pa kufizim, informimin e ALSE për veprime korporative ose veprime të tjera me Tituj), përcaktohen në këtë Rregullore, në Marrëveshjen e Pranimit për listim/tregtim (Shtojca 4) dhe në marrëveshje të tjera të specifike të parashikuara në këtë Rregullore.

Neni 6102 PËRKUFIZIMI I PRANIMIT PËR LISTIM DHE TREGTIM

Në këtë Kapitull, pranimi në listim nënkupton regjistrimin e Titujve në listën zyrtare të ALSE me kërkesë të Emetuesit ose pasi të jetë informuar Emetuesi në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 "*Për Titujt*". Në kuptim të kësaj Rregulloreje, regjistrimi në listën zyrtare të ALSE nënkupton regjistrimin e Titujve në Tregun Zyrtar Standard dhe Tregun Zyrtar Kryesor të ALSE. Heqja nga listimi do të interpretohet në të njëjtën mënyrë.

Në këtë Kapitull, pranimi në tregtim nënkupton pranimin nga ALSE për tregtimin e Titujve në Sistemin ETS në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 "*Për Titujt*" dhe me kërkesë të Emetuesit ose pasi të jetë informuar Emetuesi. Heqja nga tregtimi do të interpretohet në të njëjtën mënyrë.

Në përputhje me paragrafin e parë të këtij Neni, një Titull mund të listohet në ALSE, por të mos tregtohet me kërkesë të vetë Emetuesit ose sipas një Vendimi nga ALSE sipas rasteve të përcaktuara në këtë Rregullore.

Një Titull mund të tregtohet në tregjet e ALSE, vetëm nëse më parë është listuar në listën zyrtare të kësaj Burse. Tregtimi në Tregun Hyrës të ALSE nuk kërkon si kusht pranimin e Titujve në listën zyrtare të kësaj Burse.

Neni 6103 VAZHDIMËSIA E LISTIMIT/TREGTIMIT

6103/1 ALSE është kompetente për të gjitha çështjet lidhur me pranimin në listim/tregtim dhe heqjen nga listimi/tregtimi të Titujve, rradhitjen e masave dhe detyrimeve të vazhdueshme të Emetuesve siç parashikohet në Kapitullin 6, përveçse nëse parashikohet ndryshe nga Ligjet Shqiptare.

6103/2 Emetuesit duhet të përmbushin detyrimet për raportimin dhe publikimin e informacionit sipas Ligjeve Shqiptare për të garantuar transparencë për investitorët dhe integritet të tregut.

Neni 6104 DETYRIMET E EMETUESVE

Emetuesit duhet të përmbushin detyrimet e përcaktuara në Kapitullin 6 për t'i mundësuar ALSE të kryejë funksionet e saj dhe të përmbushë detyrimet si një Treg i Rregulluar.

Neni 6105 RAPORTIM MBI EMETUESIN TEK AMF

Në rast se ka pasur një shkelje reale ose ka shenja të konsiderueshme për një shkeljeje të mundshme të Ligjeve Shqiptare nga Emetuesi lidhur me detyrimet fillestare ose ato në vazhdimësi të listimit/tregtimit, që parashikohen nga Ligjet Shqiptare, ALSE ia raporton çështjen AMF-së sa më shpejt të jetë e mundur pasi vihet në dijeni të një shkeljeje të tillë (të mundshme).

SEKSIONI 6.2. PROCEDURA E APLIKIMIT NGA EMETUESI

Neni 6201 FORMULARI I APLIKIMIT TË EMETUESIT

Aplikimi për pranim në listim dhe/ose tregtim duhet të bëhet pranë ALSE duke depozituar Formularin e Aplikimit të Emetuesit të nënshkruar siç duhet.

Neni 6202 GRAFIKU KOHOR

ALSE dhe Aplikanti mund të bien dakord për një grafik kohor lidhur me pranimin në listim dhe/ose tregtimin.

Neni 6203 AGJENTI I LISTIMIT/TREGTIMIT

Përveçse nëse parashikohet ndryshe, Emetuesit mund të caktojnë në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 "*Për Titujt*" një Agjent Listimi/Tregtimi/Treg për pranimin e parë në listim/tregtim të Titujve dhe për çdo pranim vijues të Titujve që kërkon miratimin e një prospekti.

Neni 6204 APLIKIMI PËR LISTIMIN/TREGTIMIN E DËFTESAVE TË DEPOZITARIT TË TITUJVE

Formulari i Aplikimit i depozituar për pranim në listim të Dëftesave Të Depozitarit të Titujve gjithashtu duhet të nënshkruhet nga Emetuesi i Titujve Bazë.

Neni 6205 KËRKESAT SHITESË PËR LISTIM/TREGTIM

ALSE mund:

- (i) të vendosë, rast pas rasti, kërkesa shtesë për listim/tregtim, për një Aplikant specifik, në shtesë të atyre të specifikuara në Seksionet 6.6 dhe 6.7, siç ajo mund ta gjykojë të përshtatshme. ALSE ia komunikon këto kërkesa në kohë Aplikantit, përpara se të marrë vendimin për aplikimin;
- (ii) të kërkojë dokumentacione dhe informacione shtesë nga Aplikanti; ose
- (iii) të kryejë kontrolle dhe verifikime që mund të jenë të nevojshme, brenda arsyes, për shqyrtimin prej saj të një aplikimi për pranim në listim dhe/ose tregtim.

SEKSIONI 6.3. MARRJA E VENDIMIT NGA ALSE

Neni 6301 PERIUDHA PËR MARRJEN E VENDIMIT

Me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe, ALSE e merr vendimin lidhur me aplikimin për pranim në listim dhe/ose tregtim maksimumi brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditë pune.

Periudha e mësipërme fillon në datën kur ALSE ka marrë dosjen e plotë të dokumentacionit dhe informacionin e nevojshëm sipas Seksionit 6.5 dhe/ose Neni 6205.

Neni 6302 VLEFSHMËRIA E VENDIMIT

Vendimi i ALSE për të pranuar Tituj në listim/tregtim do të mbetet i vlefshëm për një periudhë maksimale prej nëntëdhjetë (90) ditësh, përveçse nëse ALSE vihet në dijeni se çdo informacion i dhënë lidhur me aplikimin për pranim në listim/tregtim ka ndryshuar gjatë kësaj periudhe. Me kërkesë me shkrim të Aplikantit, ALSE mund ta shtyjë këtë periudhë maksimumi edhe për një periudhë tjetër nëntëdhjetë (90) ditore.

Neni 6303 NJOFTIMI PËR PRANIMIN NË LISTIM/TREGTIM

ALSE nxjerr një Njoftim të parë lidhur me datën në të cilën pranimi në listim/tregtim i Titujve hyn në fuqi, si dhe për çdo kusht dhe/ose veçori të tjera lidhur me pranimin në listim dhe/ose tregtim të Titujve përkatës. ALSE mund të nxjerrë një tjetër Njoftim lidhur me pranimin në listim/tregtim duke konfirmuar, ndër të tjera, se kushtet janë përmbushur dhe duke cilësuar datën në të cilën pranimi në listim dhe/ose tregtim do të hyjë në fuqi.

SEKSIONI 6.4. ARSYET PËR REFUZIM

Neni 6401 REFUZIMI I APLIKANTIT PËR LISTIM/TREGTIM

ALSE mund të refuzojë një aplikim për pranim në listim/tregtim të një Titulli mbështetur në arsye të përshtatshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, nëse:

- (i) Aplikanti nuk përmbush një ose më shumë nga kërkesat e vendosura nga ose në vijim të Kapitullit 5 dhe Kapitullit 6 ose të çdo Ligji Shqiptar në fuqi; ose
- (ii) Ajo gjykon se pranimi në listim/tregtimin Titujve mund të përkeqësojë funksionimin e drejtë, të rregullt dhe efikas të Tregut të Titujve të ALSE ose të ketë ndikim negativ në reputacionin e ALSE si e tërë; ose
- (iii) Një Titull është tashmë i pranuar në listim/tregtim në një tjetër treg dhe Emetuesi nuk ka përmbushur ose nuk i përmbush detyrimet që rrjedhin nga ky pranim në listim/tregtim; ose
- (iv) Emetuesi, ndonjë prej anëtarëve të organeve të tij drejtuese (duke përfshirë anëtarët e këshillit mbikëqyrës) ose aksionarët e tij me pjesëmarrje ndikuese janë në Listën e Sanksioneve.

Neni 6402 INFORMIMI I APLIKANTIT PËR REFUZIMIN

Aplikanti do të informohet me shkrim mbi vendimin për refuzimin e aplikimit për pranim në listim/tregtim dhe mbi arsyet e këtij refuzimi.

Neni 6403 APELIMI I VENDIMIT TË REFUZIMIT

Sipas Seksionit 1.7, Aplikanti mund të apelojë kundër vendimit të ALSE për refuzimin e aplikimit për pranim në listim/tregtim në përputhje me Ligjet Shqiptare.

SEKSIONI 6.5. DOKUMENTACIONI I PËRGJITHSHËM QË DUHET TË JEPET NË KOHËN E APLIKIMIT

Neni 6501

Në momentin e aplikimit, pranë ALSE duhet të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm:

- (i) Formulari i Aplikimit të Emetuesit i nënshkruar siç duhet nga Emetuesi (Shtojca 4.1);
- (ii) dokumentet e specifikuar në Formularin e Aplikimit të Emetuesit, duke përfshirë por pa u kufizuar me dokumentacionin që sipas kërkesave të ALSE vërteton se:
 - (a) themelimi dhe organizimi i Emetuesit janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
 - (b) procesi i administrimit të veprimeve korporative dhe pagesës së dividendëve (nëse ka) janë të siguruara (ka një kontratë të nënshkruar me një kujdestar dhe/ose një Institucion Klerimi dhe Shlyerjeje); dhe
 - (c) disponohen procedura të përshtatshme për klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve lidhur me Titujt përkatës (ka një kontratë të nënshkruar me një Institucion Klerimi dhe Shlyerjeje).
- (iii) një kopje të prospektit (kur kërkohet nga Ligjet Shqiptare) ose një dokument ekuivalent për publikimin e informacionit të plotë të lëshuar nga Emetuesi lidhur me aplikimin për listim/tregtim dhe çdo version draft të këtij prospekti (ose dokument ekuivalent për publikimin e informacionit);
- (iv) një kopje të vendimit nga organi ose organet përkatëse të Emetuesit që përmbajnë rezoluta të cilat autorizojnë aplikimin për pranim në listim dhe/ose tregtim, sidhe emetimin e Titujve (për aq sa është e mundur);
- (v) vërtetim nga Regjistri i Kredive për statusin e kredive të marra nga kompania dhe aksionarët e saj, të cilët kanë më shumë se 10% të aksioneve.

Dokumentacioni i përmendur në Nenin 6501 i jepet ALSE nën përgjegjësinë e vetme të Aplikantit dhe për t'i mundësuar ALSE që të kontrollojë nëse Aplikanti i përmbush kërkesat e përcaktuara në Seksionet 6.6

dhe 6.7. ALSE nuk do të mbajë përgjegjësi për informacionin e rremë ose të paplotë që jepet nga Aplikanti (ose nga Emetuesi, pasi Titujt të jenë pranuar në listim dhe ose tregtim) lidhur me pranimin në listim dhe ose tregtim të Titujve.

Neni 6502

ALSE mund të specifikojë në vijimësi në një ose më shumë Njoftime se cili dokumentacion konsiderohet i pranueshëm për qëllim të listimit/tregtimit të Titujve të një Aplikanti. Pa cënuar Nenin 6503 dhe përveç dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar sipas Nenit 6501, ALSE gjithashtu mund të specifikojë me anë të një Njoftimi dokumentet e tjera që duhet të paraqiten lidhur me klasa të caktuara Titujsh.

Neni 6503

I gjithë dokumentacioni që kërkohet të depozitohet sipas Kapitullit 6 do të jetë në gjuhën shqipe dhe nëse nevojitet, do të përkthehet nga një përkthyes i autorizuar, me përjashtim të rasteve kur ALSE vendos të pranohet dokumente në një tjetër gjuhë të huaj. Nëse adresa e regjistruar e Emetuesit ndodhet jashtë Zonës Ekonomike Evropiane (EEA), ALSE mund të kërkojë që pasqyrat financiare të Emetuesit të ri-deklarohen sipas Parimeve Përgjithësisht të Pranuarra të Kontabilitetit (GAAP) ose Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) të zbatueshme në juridiksionin në të cilin ALSE ka adresën e regjistruar dhe që ky rideklarim të kontrollohet nga një auditues i njohur prej saj.

SEKSIONI 6.6. KËRKESAT E PËRGJITHSHME TË LISTIMIT/TREGTIMIT PËR TITUJT

Neni 6601 KËRKESAT PËR LISTIM NË LISTËN ZYRTARE TË ALSE DHE TREGTIMIN E TITUJVE

Me pranimin e Titujve në listim/tregtim dhe për sa kohë Titujt janë të listuar:

6601/1 Forma dhe struktura ligjore e Emetuesit duhet të jetë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, si vijon:

- (i) statuti i Emetuesit përputhet me ligjet e vendit ku ndodhet selia e tij e regjistruar;
- (ii) Emetuesi, i cili kërkon të tregtojë Titujt në tregjet e ALSE, në përputhje me specifikimet e Pjesës IV dhe Pjesës V të Ligjit 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", duhet:
 - (a) Të jetë i regjistruar si Shoqëri Aksionare (SH.A.) në mënyrë që të tregtohet një nga nënsegmentet e Tregut ALSE, siç përcaktohet në Nenin 5101 të kësaj Rregulloreje;
 - (b) Të jetë i regjistruar të paktën si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K) vetëm në rastin e emetimit të dëftesave tregtare në mënyrë që të tregtohet në Tregun Hyrës, siç përcaktohet në Nenin 5101 të kësaj Rregulloreje.

6601/2 Emetuesi duhet të plotësojë kërkesat e çdo Autoriteti Kompetent përkatës, përfshi AMF-në;

6601/3 Përpara fillimit të tregtimit, Aplikanti për listim/tregtim duhet të plotësojë kërkesat në lidhje me publikimin e prospektit, siç kërkohet nga Ligjet Shqiptare dhe duhet të marrë miratimin e AMF paraprakisht.

Pas miratimit të prospektit nga AMF, Aplikanti për listim/tregtim duhet t'i japë ALSE versionin përfundimtar, duhet ta publikojë në faqen zyrtare të internetit dhe/ose botojë atë në përputhje me dispozitat e Ligjeve Shqiptare dhe kërkesat e ALSE, si dhe të informojë ALSE për kohën dhe vendin e botimit, e cila duhet të jetë të paktën dhjetë (10) ditë pune përpara datës zyrtare kur Titujt do të tregtohen në segmentin përkatës të tregut të ALSE.

6601/4 Titujt e Aplikantit për listim/tregtim që dëshiron të tregtohet duhet të jenë lirisht të pagueshme dhe të transferueshme;

6601/5 Duhet të ketë procedura të përshtatshme për klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve në lidhje me këto Tituj.

6601/6 Gjatë gjithë kohës që titujt janë të listuara/tregtuar në Tregun ALSE, Emetuesi duhet të jetë në përputhje me kërkesat për ndalimin me Abuzimin e Tregut, sipas përcaktimeve në Ligjet Shqiptare në fuqi dhe Rregullat e ALSE.

6601/7 Të publikojë në faqen zyrtare të internetit të Emetuesit informacion lidhur me:

- (i) drejtimin e Emetuesit (drejtori i përgjithshëm; anëtarët e bordit; drejtuesit e tjerë të lartë),
- (ii) cdo informacion tjetër që rrjedh nga detyrimet e Emetuesit në përputhje me Udhëzuesin e Listimin të ALSE për:
 - raportim periodik në vazhdimësi,
 - raportimin e informacionit të rëndësisë së vecantë;

Neni 6602

Emetuesi duhet të sigurohet që Titujt e së njëjtës klasë të gëzojnë të drejta të njëjta, në përputhje me Ligjet Shqiptare, statutin e Emetuesit dhe dokumente të tjera themelimi, nëse ka.

Neni 6603

Titujt duhet të emetohen në mënyrë të ligjshme në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme që rregullojnë këta Tituj, me statutin e Emetuesit dhe me dokumente të tjera themelimi, nëse ka.

Neni 6604

Emetuesi duhet të sigurohet që forma e Titujve të jetë në përputhje me kërkesat e Ligjeve Shqiptare të zbatueshme.

Neni 6605

Emetuesi duhet të garantojë që Titujt të jenë lirish të pagueshëm, të transferueshëm dhe të negociueshëm, të dematerializuar dhe të regjistruar në Institucionin përkatës që ofron shërbimin e Rregjistrimit, të Klerimit dhe Shlyerjes.

Neni 6606

Titujt që u japin të drejtë mbajtësve të blejnë Tituj të tjerë ("Tituj Bazë") konsiderohen të përshtatshëm për t'u pranuar për listim/tregtim vetëm në rast se në momentin e aplikimit:

- (i) Titujt Bazë pranohen për listim/tregtim në një treg të rregulluar ose, jashtë Bashkimit European, në një treg tjetër të organizuar që i nënshtrohet standardeve të barasvlershme të përcaktuara nga ALSE; ose
- (ii) Ekziston siguria e duhur që këta Tituj Bazë do të pranohen në një treg të rregulluar ose, jashtë Bashkimit European, në ndonjë treg tjetër të organizuar që i nënshtrohet standardeve të barasvlershme të përcaktuara nga ALSE në momentin kur mund të ushtrohet e drejta për t'i blerë ato.

Neni 6607

Emetuesi aplikon për pranimin në listim dhe/ose tregtim të të gjithë Titujve të tij të së njëjtës klasë, të emetuar apo të propozuar për t'u emetuar në momentin e aplikimit.

Neni 6608

Emetuesi mund të vendosë të shpërndajë plotësisht ose pjesërisht Titujt nëpërmjet një procesi centralizimi të organizuar nga ALSE, e cila e specifikon këtë procedurë në Udhëzimin të Këshillit Mbikëqyrës.

SEKSIONI 6.7. KËRKESA SHITESË PËR LISTIMIN/TREGTIMIN E KLASAVE TË VEÇANTA TË TITUJVE

Neni 6701

Përveç kërkesave të përgjithshme për listim dhe ose tregtim të përcaktuara në Seksionin 6.6, Seksioni 6.7 përmban disa kërkesa shitesë për pranimin në listim/tregtim të klasave specifike të Titujve.

Neni 6702 AKSIONET, DËFTESAT E DEPOZITARIT PËR AKSIONET DHE TITUJT E KAPITALIT

Sipas këtij Neni, termi "aksione" përfshin të gjitha aksionet, Dëftesat e depozitarit për aksionet dhe Titujt e tjere të kapitalit.

6702/1 Kushtet specifike për tregtimin e Aksioneve në Tregun Hyrës

- (i) Në mënyrë që të tregtohen në Tregun Hyrës, aksionet dhe Emetuesit e tyre duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Seksionin 6.6 të kësaj Rregulloreje;
- (ii) Përveç kriterëve të përcaktuara në pikën (i) të Nenit 6702/1, në Tregun Hyrës do të tregtohen ato aksione të cilat:
 - (a) Nuk përmbushin kushtet dhe kriteret për t'u tregtuar në Tregun Zyrtar Standard dhe as në Tregun Zyrtar Kryesor;
 - (b) Janë pjesë e një oferte private në përputhje të plotë me Nenin 27 të ligjit "Për Titujt";
 - (c) U përkasin shoqërive të krijuara rishtazi të cilat nuk kanë histori të aktivitetit të tyre;
 - (d) U përkasin Emetuesve me një pozicion financiar negativ (humbje financiare) gjatë vitit të fundit përpara datës së tregtimit;
 - (e) Kanë qenë pjesë e një procesi privatizimi; pajtohen me kërkesat e përcaktuara në pikën (ii), gërma (b) të Nenit 6601/1 dhe kanë më shumë se 50 aksionarë, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë nr. 832, datë 3.12.2014 "*Për procedurat e privatizimit me ankad të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë*".
- (iii) Emetuesit e përcaktuar në pikën (ii), gërma (c) të Nenit 6702/1, para se të pranohen në tregtim në Tregun Hyrës duhet të dorëzojnë në ALSE një plan biznesi të detajuar, sipas të cilit ata planifikojnë të gjenerojnë fonde. Ky plan biznesi duhet të miratohet nga AMF përpara dorëzimit në ALSE.
- (iv) Emetuesit e përcaktuar në pikën (ii), gërma (e) të Nenit 6702/1 nuk janë të detyruar të dorëzojnë një prospektpara se të pranohen në tregtim në Tregun Hyrës, meqenëse aksionet e tyre konsiderohen se janë ofruar publikisht.

6702/2 Kushtet specifike për listimin/tregtimin e Aksioneve në Tregun Zyrtar Standard

- (i) Në mënyrë që të listohen/tregtohen në Tregun Zyrtar Standard, aksionet dhe Emetuesit e tyre duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:
 - (a) Kushtet e përgjithshme për t'u listua rdhe ose tregtuar në ALSE:
 - aksionet dhe Emetuesit e tyre duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Seksionin 6.6 të kësaj Rregulloreje,
 - (b) Kushtet sasiore për Emetuesin:
 - Minimumi tre vitet e fundit aktivitet përpara datës së listimit/tregtimit::
 - Rezultate financiare pozitive (fitim financiar) gjatë vitit të fundit përpara datës së listimit/tregtimit;
 - Raporte vjetore të audituara për dy vitet e fundit financiare përpara datës së listimit/tregtimit;
 - Vlera minimale e kapitalit: një qind e tridhjetë milionë (130 000 000) Lek
 - përqindja e shpërndarjes së klasës së aksioneve në publik: min. 15%;
 - Numri i zotëruesve të aksioneve, pas mbarimit të ofertës publike: Min.100.
- (ii) Nëse përqindja e klasës së aksioneve në publik, sipas kushteve sasiore në Nenin 6702/2, nuk arrin 15%, ky kusht do të konsiderohet i përmbushur, nëse madhësia e klasës së aksioneve në publik tejkalon - në rastin e një listimi/tregtimi të parë në Tregun Zyrtar Standard - vlerën kontabël prej 33 00000 Lek, ose në qoftë se Kapitalizimi i Tregut të klasës së aksioneve për publikun ka vlerën një qind e tridhjetë milionë (130 000 000) Lek;
- (iii) Nëse ALSE e konsideron të arsyeshme, aksionet mund të listohen dhe/ose tregtohen në Tregun Zyrtar Standard, edhe në qoftë se një nga kriteret e përcaktuara në kushtet sasiore të Nenit 6702/2 nuk plotësohet, me kusht që devijimi të mos jetë i konsiderueshëm ose nëse

- ALSE gjykon se ka arsye të forta për të besuar se ky kusht do të plotësohet brenda një periudhe prej më pak se 12 muaj pas listimit/tregtimit në Tregun Zyrtar Standard;
- (iv) Përveç kësaj, ALSE mund të listojë dhe/ose tregtojë në Tregun Zyrtar Standard aksionet e shoqërisë së re të krijuar nga bashkimi i disa shoqërive ose nga ndarja e një shoqërie. Në këtë rast, kushtet për vitet e aktivitetit të shoqërisë dhe për raportet vjetore të audituara konsiderohen të plotësuara, nëse aksionet e të paktën njëres prej shoqërive të bashkuara, apo të shoqërisë që është ndarë, kanë qenë të listuaradhe/ose tregtuara në ALSE përpara fillimit të procedurës së ristrukturimit dhe përmbushin kushtet për tregtim në Tregun Zyrtar Standard.

6702/3 Kushtet specifike për tregtimin e Aksioneve në Tregun Zyrtar Kryesor

- (i) Në mënyrë që të listohen/tregtohen në Tregun Zyrtar Kryesor, aksionet dhe Emetuesit e tyre duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:
- (a) Kushtet e përgjithshme për t'u listuar dhe ose tregtuar në ALSE:
- aksionet dhe Emetuesit e tyre duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Seksionin 6.6 të kësaj Rregulloreje,
- (b) Kushtet sasiore për Emetuesin:
- Minimumi pesë vjet aktivitet përpara datës së listimit/tregtimit;
 - Rezultate financiare pozitive (fitim financiar) gjatë dy viteve të fundit përpara datës së listimit/tregtimit;
 - Raporte vjetore të audituara sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) për tre vitet e fundit ushtrimore përpara datës së listimit/tregtimit;
 - Vlera minimale e kapitalit: dy qind e gjashtëdhjetë milionë (260 000 000) Lek;
 - përqindja e shpërndarjes së klasës së aksioneve në publik: min. 25%;
 - Numri i zotëruesve të aksioneve pas mbarimit të ofertës publike: Min.250;
- (c) Kriteret e likuiditetit për Emetuesin:
- Numri mesatar mujor minimal i transaksioneve të ekzekutuara në aksione gjatë vitit të mëparshëm;
 - Volumet mesatare mujore minimale të tregtimeve të aksioneve të mbyllura gjatë vitit të mëparshëm;
 - Penetrimi mesatar mujor minimal i tregut gjatë vitit të mëparshëm;
- (ii) Nëse përqindja e klasës së aksioneve në publik, sipas kushteve sasiore në Nenin 6702/33, nuk arrin 25%, atëherë ky kusht do të konsiderohet i përmbushur, nëse përqindja e klasës së aksioneve në publik është të paktën 15 % dhe vlera e Kapitalizimit të Tregut të klasës së aksioneve është së paku dy qind e gjashtëdhjetë milionë (260 000 000) Lek.

6702/4 Pa çenuar Nenin 6205, ALSE mund të lejojë përjashtimin nga kërkesa e përcaktuara në Nenin 6702/1, pika (ii), nëse ALSE gjykon se kjo është në interes të Emetuesit ose në rastin e Dëftesave të depozitarit të Aksioneve, në interes të Emetuesit të Titujve Bazë ose të investitorit dhe nëse Emetuesi ka vendosur në dispozicion informacion të mjaftueshëm duke u dhënë mundësinë investitorëve të bëjnë një vlerësim të informuar të aktivitetit dhe pasivit, të gjendjes financiare, të fitimit dhe humbjeve, si dhe të prospekteve të Emetuesit ose, në rastin e Dëftesave të depozitarit të Aksioneve, atë të Emetuesit të Titujve Bazë dhe të të drejtave që u bashkëngjiten Titujve që do të pranohen në listim/tregtim.

Në këto raste, ALSE - sipas gjykimit të saj absolut - mund ta bëjë pranimin në listim/tregtim objekt të kërkesave shtesë, që lidhen me Kapitalizimin e Tregut, kapitalin e aksionarëve dhe/ose kërkesat për bllokimin, ose të çdo kushti tjetër të vendosur nga ALSE.

Neni 6703 OBLIGACIONET DHE TITUJ TË TJERË AFATSHKURTËR BORXHI

6703/1 Kushte të përgjithshme për listimin/tregtimin e Obligacioneve dhe Titujve të tjerë të Borxhit Afatshkurtër

Në mënyrë që të listohen/tregtohen në ALSE, obligacionet dhe Titujt e tjerë afatshkurtër të borxhit duhet të plotësojnë, sipas rastit, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Seksionin 6.6 të kësaj Rregulloreje;

6703/2 Kushte specifike për listimin/tregtimin e obligacioneve dhe Titujve të tjerë të Borxhit Afatshkurtër

Çdo Emetues që kërkon pranimin në listim/tregtim të obligacioneve dhe Titujve të tjerë të borxhit afatshkurtër, në momentin e listimit/tregtimit duhet të emetojë në total një shumë nominale minimale prej të paktën:

- (i) Një qind e tridhjetë milionë (130 000 000) Lek në rastin e një oferte publike të obligacioneve dhe të Titujve të tjerë të borxhit afatshkurtër; ose
- (ii) Njëzet e gjashtë milionë (26 000 000) Lek për të gjitha llojet e pranimeve në listim/tregtim të obligacioneve dhe Titujve të tjerë të borxhit afatshkurtër (në rast të një oferte private).

Shumat minimale të mësipërme nuk zbatohen në rastin e emetimit serial të programuar të Titujve të borxhit (tap issues), kur vlera e emetimit nuk është fiksuar.

6703/3 Kushte specifike për listimin/tregtimin e obligacioneve dhe të Titujve të tjerë të Borxhit Afatshkurtër në nënsegmente të Tregut ALSE

Përveç kushtit të përcaktuar në Nenin 6703/2, obligacionet dhe Titujt e tjerë të borxhit afatshkurtër duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për t'u listuar/tregtuar në nënsegmentet përkatëse të Tregut ALSE, si më poshtë:

- (i) Të gjithë Titujt e borxhit të emetuar nga Qeveria e Shqipërisë (bono thesari dhe obligacione thesari), nga Banka e Shqipërisë si dhe nga qeverisja vendore (bashkitë) listohen/tregtohen në Tregun Zyrtar Kryesor.
- (ii) Të gjithë Titujt e borxhit të emetuar nga institucionet dhe subjektet e qeverisjes qendrore, duke përfshirë edhe obligacionet e korporatave dhe Titujt me garanci kolaterale (asset-backed), mund të listohen/tregtohen në Tregun Zyrtar Kryesor pasi të kenë plotësuar kërkesat e Nenit 6703/5.
- (iii) Të gjithë Titujt e borxhit të emetuar nga Emetues privatë listohen/tregtohen si më poshtë:
 - (a) Titujt afatshkurtër të borxhit privat (p.sh. letra tregtare) me një vlerë nominale totale për çdo klasë Titujsh të emetuar deri në shumën tre qind e nëntëdhjetë milionë (390 000 000) Lek, listohen/tregtohen në Tregun Zyrtar Standard. Titujt afatshkurtër të borxhit privat të emetuara mbi këtë shumë mund të listohen/tregtohen në Tregun Zyrtar Kryesor, pasi të kenë plotësuar kërkesat e Nenit 6703/5;
 - (b) Titujt afatgjatë të borxhit privat (p.sh. të gjitha format e obligacioneve të korporatave) me një vlerë nominale totale për çdo klasë Titujsh të emetuar deri në shumën e një miliardë e tre qind milionë (1 300 000 000) Lek, listohen/tregtohen në Tregun Zyrtar Standard. Titujt afatgjatë të borxhit privat të emetuara mbi këtë shumë mund të listohen/tregtohen në Tregun Zyrtar Kryesor, pasi të kenë plotësuar kërkesat e Nenit 6703/5;
 - (c) Titujt e borxhit privat afatshkurtër dhe/apo afatgjatë të emetuara me ofertë publike të cilët nuk përmbushin kriteret për t'u listuar/tregtuar në Tregun Zyrtar Standard apo në Tregun Zyrtar Kryesorë, si dhe të gjithë titujt e borxhit të emetuar me ofertë private do të pranohen për tregtim në Tregun Hyrës.

Përveç kriteve të përmendura më lart në këtë pikë, Emetuesit privat duhet të plotësojnë edhe kriteret sasiore e cilësore si më poshtë:

- Për Tregun Hyrës:
 - Nuk ka kufizime sasiore specifike për pranimin për tregtimin e Titujve të Borxhit privat;
 - Në përputhje me pikën 6601/3 Emetuesi duhet të publikojë prospektin përkatës sipas mënyrave të parashikuara në Udhëzimin e Listimit të ALSE;
 - Të publikojë në faqen zyrtare të internetit të Anëtarit pasqyrat financiare vjetore, minimalisht në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.
- Për Tregun Zyrtar Standard:
 - Vlera minimale e kapitalit: gjashtëdhjetë e pesë milionë (65 000 000) Lek;
 - Minimumi dy (2) vitet e fundit aktivitet përpara datës së listimit/tregtimit;
 - Rezultat financiar pozitiv gjatë vitit të fundit përpara datës së listimit/tregtimit;
 - Raporte vjetore të audituara për vitin e fundit financiarë përpara datës së listimit/tregtimit
- Për Tregun Zyrtar Kryesor:
 - Vlera minimale e kapitalit: një qind e tridhjetë milionë (130 000 000) Lek;
 - Minimumi tre (3) vjet aktivitet përpara datës së listimit/tregtimit;

- Rezultat financiar pozitiv gjatë dy (2) viteve të fundit përpara datës së listimit/tregtimit;

6703/4 Aplikimi për pranimin në listim/tregtim duhet të lidhet me të gjitha obligacionet dhe Titujt e tjerëtë borxhit afatshkurtër që janë në nivel të barabartë.

6703/5 Emetuesit e kualifikuar për të listuar/tregtuar obligacionet e tyre dhe Titujt e tjerëtë borxhit afatshkurtër nëpërmjet një oferte publike në Tregun Zyrtar Kryesor marrin dhe publikojnë në dokumentet përkatëse të ofertës, një klasifikim (në lidhje me Emetuesin apo Titujt përkatës që do të ofrohen) nga një agjenci e klasifikimit të kredive (rating agency), e cila është e regjistruar në ose e çertifikuar nga ESMA apo nga çdo organ tjetër homolog dhe i miratuar nga AMF, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe në mënyrë specifike mes ALSE dhe Emetuesit. Titujt e përcaktuar në paragrafin e parë të Nenit 6703/2 gëzojnë të drejtën por jo detyrimin për të qenë në përputhje me Nenin 6703/5.

Neni 6704 KUOTAT E SHOQËRIVE TË INVESTIMIT TË EMETUARA NGA SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE

6704/1 Kushtet specifike për listimin/tregtimin e Kuotave

Pranimi i parë në listim/tregtimin e kuotave të një Shoqërie Investimi të emetuar nga një Sipërmarrjeje të Investimeve Kolektive duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

- (i) në kohën e pranimit në listim/tregtim, Kapitalizimi i Tregut të kuotave për të cilat kërkohet pranimi në listim/tregtim duhet të jetë:
 - (a) të paktën gjashtë qind e pesëdhjetë milionë (650 000 000) Lek, për kuotat me ofertë publike;
 - (b) të paktën një qind e tridhjetë milionë (130 000 000) Lek, për kuotat me ofertë private;
- (ii) në kohën e pranimit në listim/tregtim nëpërmjet një oferte publike, një numër i mjaftueshëm kuotash duhet t'i shpërndahet publikut. Një numër i mjaftueshëm i këtyre kuotave konsiderohet se i është shpërndarë publikut nëse të paktën 20% e kapitalit të nënshkruar që përfaqësohet nga klasa e kuotave në fjalë është në duart e publikut. Për ofrimin e kuotave nëpërmjet një oferte private këto kritere nuk gjejnë zbatim; dhe
- (iii) në kohën e pranimit në listim/tregtim nëpërmjet një oferte publike, numri i mbajtësve të kuotave duhet të jetë më i madh se 100. Për ofrimin e kuotave nëpërmjet një oferte private këto kritere nuk gjejnë zbatim;

6704/2 Kushtet specifike për listimin/tregtimin e Kuotave në nënsegmente të Tregut ALSE

Përveç kritereve që përshkruhen në Nenin 6704/1, ALSE liston/tregton këto kuota në nënsegmentet e mëposhtme:

- (i) Në *Tregun Hyrës*
Të gjithë kuotat e emetuara në një ofertë private tregtohen në Tregun Hyrës.
- (ii) Në *Tregun Zyrtar Standard*
 - (a) Të gjithë kuotat duhet të emetohen nëpërmjet një oferte publike;
 - (b) Kapitalizimi i Tregut deri në një miliardë e tre qind milionë (1 300 000 000) Lek;
 - (c) Përqindja e kuotave në duart e publikut deri në 50%;
 - (d) Numri i mbajtësve të kuotave deri në 250;
- (iii) Në *Tregun Zyrtar Kryesor*
 - (a) Të gjithë kuotat duhet të emetohen nëpërmjet një oferte publike;
 - (b) Kapitalizimi i Tregut më shumë se një miliardë e tre qind milionë (1 300 000 000) Lek;
 - (c) Përqindja e kuotave në duart e publikut më e madhe se 50%;
 - (d) Numri i mbajtësve të kuotave më i madh se 250;

Neni 6705 FONDET E INVESTIMIT DHE FONDET E INVESTIMIT TË TREGTUARA ELEKTRONIKISHT NË BURSË TË EMETUARA NGA SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE

6705/1 Kushtet për pranimin e parë në listim/tregtim të Fondeve të Investimit dhe Titujve të fondeve të investimit të tregtuara elektronikisht në bursë (ETFs), të emetuara nga Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive, përcaktohen në një Udhëzim të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 6706 TITUJ TË TJERË TË TRANSFERUESHËM

6706/1 Pranimi në listim/tregtim Titujve të tjerë të transferueshëm i nënshtrohet kërkesave të tjera specifike që mund të përcaktojë ALSE një Njoftim të veçantëduke marrë në konsideratë natyrën e Titujve për të cilët kërkohet listimi/tregtimi dhe, kur është e mundur, kërkesat e përgjithshme për listim/tregtim që specifikohen në Kapitullin 6 për Titujt të ngjashëm.

6706/2 ALSE mund të vendosë që disa Tituj të tjerë të transferueshëm të mos kualifikohen për t'u pranuar në listim dhe/ose tregtim.

SEKSIONI 6.8. MASAT PËR LISTIMIN/TREGTIMIN

Neni 6801 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

6801/1 Në lidhje me Titujt që pranohen në listim/tregtim në ALSE, kjo e fundit mund të marrë të gjitha masat që i konsideron të nevojshme për të lehtësuar funksionimin e drejtë, të rregullt dhe efikas të tregjeve të saj. ALSE informon, sa më shpejt të jetë e mundur, Emetuesin përkatës për çdo masë që ajo ka marrë.

6801/2 Në zbatim të Ligjeve Shqiptare, ALSE, ndër të tjera, mund të marrë masat e mëposhtme:

- (i) t'i vendosë Emetuesit kushte specifike për të garantuar se po respektohen detyrimet e vendosura dhe kërkesat e përcaktuara sipas Kapitullit 6, në çdo Njoftim, Udhëzim ose Formular Aplikimi; dhe/ose
- (ii) alokon një Titull në një segment të veçantë të Tregut ALSE; dhe/ose
- (iii) jep Njoftim duke informuar tregun se një Emetues nuk ka përmbushur detyrimet e tij, të përcaktuara në Rregullore; dhe/ose
- (iv) pezullon tregtimin e një Titulli; dhe/ose
- (v) heq nga listimidhe/ose tregtimi Titujt përkatës në përputhje me Nenin 6803; dhe/ose

Neni 6802 NDARJET SPECIFIKE - SEGMENTI I RIKUPERIMIT DHE SEGMENTI NËN-MBIKËQYRJE

6802/1 Qëllimi i alokimit të Titujve në Segmentin e Rikuperimit është grupimi i Titujve të Emetuesve që u nënshtrohen procedurave të paaftësisë paguese.

Qëllimi i alokimit të Titujve në Segmentin nën Mbikëqyrje është grupimi i Titujve të Emetuesve që nuk veprojnë në përputhje me Rregulloren.

Në kontekstin e alokimit të Titujve të Emetuesve në Segmentin e Rikuperimit ose Segmentin nën-Mbikëqyrje, ALSE shqyrton rregullisht situatën e Emetuesve.

6802/2 Kushtet dhe pasojat për Emetuesit, Titujt e të cilëve alokohen në ndarjet specifike që përmenden në Nenin 6802/1, përcaktohen në një Udhëzim të Këshillit Mbikëqyrës që nxjerr ALSE, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në kushtet për rillistimin/ritregtimin e këtyre Titujve në segmentet dhe nënsegmentet e mëparshme të ALSE.

Neni 6803 HEQJA NGA LISTIMI DHE/OSE TREGTIMI

6803/1 Në zbatim të Ligjeve Shqiptare, ALSE mund të heqë nga listimi dhe/ose tregtimi Titujt që janë pranuar në listim/tregtim në tregjet e saj:

- (i) me kërkesë të Emetuesit përkatës; ose
- (ii) me iniciativën e vet;
- (iii) me kërkesë të AMF-së.

ALSE mund të heqë nga listimi dhe/ose tregtimi Tituj me iniciativën e vet për çdo arsye të vlefshme që përfshin (pa kufizim):

- (a) paaftësinë e provuar të Emetuesit për të përmbushur detyrimet që i janë vendosur dhe kërkesat e përcaktuara sipas Rregullores ose Formularit të Aplikimit; ose
- (b) personi juridik që ka emetuar Titujt pushon së ekzistuari si pasojë e një likuidimi, shkrirjeje, shpërbërjeje (ose e veprimeve korporative të barasvlershme në çdo juridiksion);
- (c) Emetuesi i Titujve ka deklaruar falimentim (ose është deklaruar një procedurë analoge e zbatueshme në ndonjë juridiksion); ose
- (d) pa cënuar Nenin 4404, sipas gjykimit të ALSE në lidhje me një Titull, ndodhin ose kanë ndodhur fakte ose zhvillime që pengojnë vazhdimin e listimit dhe/ose tregtimit të këtij Titulli ose të cilat bëjnë që ALSE të besojë se për Titullin nuk mund të ruhet një treg i drejtë, i rregullt dhe efikas; ose
- (e) për një lloj të caktuar Titujsh nuk janë më të disponueshme shërbimet e përshtatshme të klerimit dhe/ose shlyerjes; ose
- (f) heqjen nga listimi dhe/ose tregtimi të aksioneve ose të Titujve të tjerë në të cilat ato mund të konvertohen ose me të cilat janë të këmbyeshme, sipas rasti; ose
- (g) në lidhje me një Emetues ndodhin ose kanë ndodhur fakte ose zhvillime të cilat, sipas gjykimit të ALSE ndikojnë negativisht në reputacionin e ALSE në tërësi;
- (h) Emetuesi ose zotëruesit e tij përfitues janë pjesë e Listës së Sanksioneve;
- (i) Emetuesi nuk është në zbatim të kushteve dhe kërkesave të kësaj Rregulloreje.

6803/2 Kur ALSE vendos të heqë një Titull nga listimi dhe/ose tregtimi, sipas pikës (ii) të Nenit 6803/1, zbatohen procedurat e mëposhtme:

- (i) ALSE informon Emetuesin për qëllimin e saj për heqjen nga listimi dhe/ose tregtimi dhe i jep Emetuesit mundësinë që të reagojë përpara se të merret vendimi përkatës për heqjen nga listimi dhe/ose tregtimi;
- (ii) ALSE përcakton datën në të cilën hyn në fuqi heqja e Titujve nga listimi dhe/ose tregtimi dhe informon AMF-në për sa më lart;
- (iii) ALSE njofton Emetuesin me shkrim për datën e planifikuar të heqjes nga listimi dhe/ose tregtimi;
- (iv) ALSE publikon datën në të cilën hyn në fuqi heqja e Titujve nga listimi dhe/ose tregtimi si edhe kushtet dhe çdo informacion tjetër përkatës në lidhje me heqjen nga listimi dhe/ose tregtimi;

Në datën në të cilën hyn në fuqi heqja e Titujve nga listimi dhe/ose tregtimi, marrëveshja ndërmjet Emetuesit përkatës dhe ALSE (e cila përbëhet nga Formulari i Aplikimit) zgjidhet pa qenë nevoja të ndërmerret asnjë veprim i mëtejshëm.

6803/3 Kur kërkesa për heqjen e Titujve nga listimi dhe/ose tregtimi bëhet nga Emetuesi sipas Nenit 6803/1 (i), zbatohet procedura e mëposhtme:

- (i) Emetuesi i Titujve përkatës kërkon me shkrim heqjen nga listimi dhe/ose tregtimi dhe deklaron arsyet përkatëse për heqjen nga listimi dhe/ose tregtimi;
- (ii) duke respektuar kushtet përkatëse për heqjen e Titujve nga listimi dhe/ose tregtimi, brenda 60 ditëve pune marrja e kërkesës me shkrim, ALSE përcakton datën në të cilën hyn në fuqi heqja e Titujve nga listimi dhe/ose tregtimi.
- (iii) ALSE publikon datën në të cilën hyn në fuqi heqja e Titujve nga listimi dhe/ose tregtimi dhe informacione të tjera përkatëse në lidhje me heqjen e Titujve nga listimi dhe/ose tregtimi.

ALSE mund të specifikojë me anë të një Udhëzimi kushtet që duhet të përmbushen kur heqja e Titujve nga listimi dhe/ose tregtimi është kërkuar nga Emetuesi.

6803/4 Pavarësisht nga sa më lart, ALSE mund të vendosë të mos heqë Titujt nga listimi dhe/ose tregtimi me kërkesë të Emetuesit nëse kjo do të kishte ndikim negativ në funksionimin e drejtë, të rregullt dhe efikas të tregut, për një afat jo më të gjatë se 12 muaj nga data e publikuar sipas Nenit 6803/3 (iii).

6803/5 Për heqjen e Titujve nga listimi dhe/ose tregtimi, ALSE mund të vendosë kërkesa shtesë, kur ajo i konsideron të përshtatshme.

6803/6 ALSE informon me shkrim AMF-në për heqjen e një Titulli nga listimi dhe/ose tregtimi.

6803/7 Në zbatim të Seksionit 1.7, Emetuesi mund të apelojë vendimin e ALSE për heqjen nga listimi dhe/ose tregtimi, në përputhje me Ligjet Shqiptare.

SEKSIONI 6.9. DETYRIMET E VAZHDUESHME

Neni 6901 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

6901/1 Objekti

Për sa kohë që Titujt e tij janë pranuar në listim/tregtim, çdo Emetues duhet të përmbushë detyrimet që përcaktohen në Seksionin 6.9.

ALSE mund t'i shpjegojë këto detyrime në mënyrë më të hollësishme në një ose më shumë Udhëzime. Për të shmangur çdo dyshim, asnjë nga detyrimet e përcaktuara në Nenin 6901 nuk i përjashton Emetuesit nga detyrimi për të respektuar detyrimet e publikimit ose raportimit që parashikohen në Ligjet Shqiptare.

6901/2 Tarifat

Emetuesi paguan menjëherë çdo tarifë të vendosur nga Këshilli Mbikëqyrës i ALSE në përputhje me kushtet që janë vendosur nga ALSE dhe që u janë komunikuar Emetuesve (Shtojca 2).

Neni 6902 LISTIMI/TREGTIMI TITUJVE TË SË NJËJTËS KLASËTËEMETUAR RISHTAZI

6902/1 Kur emetohen Tituj shtesë të së njëjtës klasë me Titujt që janë pranuar më parë në listim/tregtim, aplikimi për pranimin e këtyre Titujve shtesë në listim/tregtim bëhet:

- (i) sapo ato emetohen në rastin e ofertës publike të Titujve; dhe
- (ii) jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas emetimit të tyre në rastet të tjera, të ndryshme nga oferta publike.

Neni 6903 MARRËDHËNIET ME INVESTITORIN

6903/1 Trajtimi i barabartë

Emetuesi i trajton mbajtësit e Titujve të së njëjtës klasë, të emetuar prej tij, në mënyrë të barabartë, në përputhje me Ligjet Shqiptare.

6903/2 Informacioni

Emetuesi i jep tregut dhe publikut të gjitha informacionet e nevojshme për t'u mundësuar mbajtësve të Titujve të tij që të ushtrojnë të drejtat që gëzojnë.

Emetuesi i komunikon ALSE të gjitha informacionet që:

- (i) mund të ndikojnë në funksionimin e drejtë, të rregullt dhe efikas të tregjeve ku operon ALSE ose
- (ii) mund të ndryshojnë çmimin e Titujve (përfundimisht) në të njëjtën kohë kur ky informacion bëhet publik.

ALSE mund të përcaktojë me anë të një Udhëzimi detyrimet specifike lidhur me detyrimet e publikimit dhe raportimit.

Neni 6904 ADMINISTRIMI I VEPRIMEVE KORPORATIVE DHE I VEPRIMEVE TË TJERA ME TITUJ

6904/1 Çdo Emetues informon ALSE për veprimet korporative ose për veprime të tjera me Tituj (siç përshkruhen kryesisht në Nenin 6904/2), për Titujt e tij të pranuar në listim/tregtim, në mënyrë që të lehtësohet funksionimi i drejtë, i rregullt dhe efikas i tregut.

Informacioni përkatës i jepet ALSE të paktën dy (2) Ditë Tregtimi përpara:

- (i) shpalljes publike të orarit për këto veprime korporative ose veprime të tjera me Tituj ose
- (ii) se veprimet korporative ose veprimet e tjera me Tituj të kenë ndikim në treg ose në pozicionin e mbajtësve të Titujve përkatës.

Me kërkesë të ALSE, Emetuesi përkatës i dorëzon ALSE dokumentet mbështetëse juridike dhe korporative në lidhje me veprimet korporative dhe veprimet e tjera me Tituj.

ALSE mund të specifikojë më tej me anë të Udhëzimi të Këshillit Mbikëqyrës detajet, dokumentet dhe metodën e dorëzimit të informacioneve dhe dokumenteve që duhet t'i ofrohen dhe t'i dorëzohen asaj në zbatim të Nenit 6904/1.

Për të shmangur çdo dyshim, çdo detyrim i Emetuesit për t'i ofruar ALSE dokumentacionin e parashtruar në Kapitullin 6 vendoset me qëllimin e vetëm që t'i lejojë ALSE ushtrimin e të gjitha funksioneve të saj dhe përmbushjen e përgjegjësisë të saj si operator i një Tregu të Rregulluar. Gjatë shqyrtimit të këtij dokumentacioni, ALSE kryen vetëm kontrole të informacionit teknik që i lejon ALSE të operojë tregun, pa cënuar Nenin 6105. Asnjë nga detyrimet nuk përjashton faktin që Emetuesi duhet t'i dorëzojë të njëjtin dokumentacion edhe AMF-së.

6904/2 Informacioni që përmendet në Nenin 6904/1 përfshin (pa kufizim):

- (i) ndryshimet që ndikojnë në të drejtat përkatëse të klasave të ndryshme të Titujve;
- (ii) çdo emetim ose nënshkrim të Titujve;
- (iii) çdo riorganizim të detyrueshëm (p.sh. ndarja e aksioneve, ndarja e ndërsjellë e aksioneve, riblerja e pjesëshme ose e plotë e Titujve);
- (iv) çdo riorganizim vullnetar me ose pa elementin e opsionit (p.sh. ofertë me tender, ofertë sipas të drejtave, ofertë për riblerje);
- (v) çdo shpërndarje e Titujve (p.sh. dividend në aksione, emetimi i bonuseve);
- (vi) çdo shpërndarje në mjete monetare (cash) (p.sh. dividend në mjete monetare);
- (vii) çdo lajmërim për mospagesën e kuponëve ose dividendëve në mjete monetare (cash);
- (viii) çdo prospekt (kur kërkohet nga Ligjet Shqiptare) ose dokument publikimi i barasvlerëshëm, në lidhje me ofertat publike;
- (ix) çdo raport për statusin e likuidimit, dhe në mënyrë më të përgjithshme, çdo vendim në lidhje me çdo situatë (të përkohshme) pezullimi të pagesave, situatë falimentimi ose paaftësie paguese (ose procedurë analoge) që është dhënë ose deklaruar si i zbatueshëm në çdo juridiksion;
- (x) ndryshimi i emrit të Emetuesit; dhe
- (xi) pranimi në listim/tregtim ose tregtim në çdo Treg të Rregulluar ose çdo treg tjetër të organizuar.

6904/3 Nëse pranimi në listim/tregtim ka të bëjë me Dëftesat e depozitarit ose Tituj të tjerë që i japin të drejtë mbajtësve të blejnë Tituj të tjerë, informacioni që përmendet në Nenin 6904/1 përfshin gjithashtu (pa kufizim) veprimet korporative ose veprime të tjera me Tituj të Emetuesit të Titujve Bazë.

6904/4 Nëse pranimi në listim/tregtim ka të bëjë me kuota të një Shoqërie Investimi, informacioni që përmendet në Nenin 6904/1 të cilin Sipërmarrja e Investimeve Kolektive të kësaj Shoqërie Investimi duhet t'i japë ALSE përfshin gjithashtu (pa kufizime):

- (i) një shpallje të çdo shpërndarjeje;
- (ii) kuponët që deklarohen pa vlerë.

KAPITULLI 7: KOMISIONI DHEPROCEDURAT E ARBITRAZHIT

SEKSIONI 7.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 7101 TRAJTIMI IMOSMARRËVESHJEVE

Sipas Ligjeve Shqiptare të zbatueshme, çdo mosmarrëveshje ndërmjet Anëtarëve të ALSE përpara se t'i drejtohet gjykatave shqiptare, do t'i paraqitet Komisionit të Arbitrazhit të ALSE ("**Komisioni i Arbitrazhit**").

Neni 7102 PAANSHMËRIA NË ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE

Komisioni i Arbitrazhit do të zgjidhë çdo mosmarrëveshje ndërmjet Anëtarëve të ALSE, si dhe mosmarrëveshjet ndërmjet Anëtarëve/Emetuesëve të ALSE kundrejt ALSE, që lidhet me tregtimin e Titujve, në mënyrën më të drejtë, efikase dhe profesionale, zbatimin e drejtë të Ligjeve Shqiptare, Rregulloreve, Udhëzimeve të nxjerra nga ALSE.

Neni 7103 SELIA E KOMISIONIT TË ARBITRAZHIT

Komisioni i Arbitrazhit është një komision i përhershëm dhe i pavarur i ngritur brenda ALSE, me seli në zyrat qendrore të ALSE.

SEKSIONI 7.2. PËRBËRJA E KOMISIONIT TË ARBITRAZHIT

Neni 7201 PËRBËRJA E KOMISIONIT TË ARBITRAZHIT

7201/1 Komisioni i Arbitrazhit përbëhet nga 10 anëtarë, një prej të cilëve është Kryetari.

7201/2 Anëtarët e Komisionit të Arbitrazhit emërohen nga Këshilli Mbikëqyrës i ALSE (në vijim: "Këshilli") me shumicë të thjeshtë, me propozim të Administratorit të ALSE. Këshilli vendos se cili prej arbitrave do të shërbejë si Kryetar i Komisionit.

7201/3 Mandati i emërimit të anëtarëve të Komisionit të Arbitrazhit është 3 vjet, me të drejtë riemërimi për një mandat shtesë.

7201/4 Anëtarët e Komisionit të Arbitrazhit duhet të jenë individë me integritet profesional dhe ekspertizë në fushën ligjore, ekonomike, financiare, të inxhinierisë financiare ose të tregtimit të Titujve. Anëtarët e Komisionit të Arbitrazhit mund të jenë edhe individë me njohuri akademike në këto fusha ekspertize dhe me një përvojë minimale 5-vjeçare në mësimdhënie.

7201/5 Të paktën 3 prej anëtarëve të Komisionit të Arbitrazhit duhet të jenë gjithmonë juristë.

7201/6 Anëtarët e Komisionit të Arbitrazhit nuk duhet të jenë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe të Këshillit Drejtues të ALSE ose anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe të Këshillit Drejtues të Institucioneve të tjera të lidhura me ALSE dhe/ose Anëtarët/Emetuesit e saj.

7201/7 Anëtarët e Komisionit të Arbitrazhit mund të lirohen nga detyra përpara përfundimit të mandatit të tyre, në rrethanat e mëposhtme:

- me kërkesë të tyre, të dërguar Këshillit Mbikëqyrës të ALSE;
- kur dënohen me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- kur nuk janë në gjendje të kryejnë detyrën e tyre si arbitra.

7201/8 Lirimi nga detyra i anëtarit të Komisionit të Arbitrazhit duhet të konfirmohet nga Këshilli Mbikëqyrës i ALSE, i cili duhet të emërojë një anëtar të ri në po atë mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës ALSE.

Neni 7202 SEKRETARI I KOMISIONIT TË ARBITRAZHIT

Komisioni i Arbitrazhit asistohet nga një Sekretar. Sekretari emërohet nga Këshilli Mbikqyrësi ALSE me propozim të Administratorit të ALSE.

SEKSIONI 7.3. VENDIMARRJA E KOMISIONIT TË ARBITRAZHIT

Neni 7301 PANELET E ARBITRAZHIT

Arbitrat i marrin vendimet në panele të përbëra nga tre (3) arbitra, ku njëri prej arbitrave do të jetë në rolin e Kryetarit të trupës (panelit të Arbitrazhit) i cili do të ketë rolin për të drejtuar seancën, ndërsa dy arbitrat e tjerë do të jenë në rolin e arbitrave të zakonshëm (arbitrat e përzgjedhur nga palët).

Neni 7302 FUSHA E VEPRIMTARISË SË PANELEVE

7302/1 Për marrjen e vendimit, arbitrat zbatojnë Rregulloret, Procedurat, Udhëzimet e nxjerra nga ALSE, si dhe çdo dispozitë përkatëse të Ligjeve Shqiptare.

7302/2 Procedura e arbitrazhit përpara panelit të arbitrazhit zhvillohet në seanca të mbyllura për publikun, gjatë të cilave palët gëzojnë të drejtën për t'u dëgjuar.

7302/3 Deri në dhënien e vendimit përfundimtar të arbitrazhit, punimet e panelit të arbitrazhit mbeten konfidenciale dhe konfidencialitetin e tyre duhet ta ruajnë të gjithë pjesëmarrësit në seancat e arbitrazhit.

SEKSIONI 7.4. HAPJA E PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT

Neni 7401 ANKIMI PËR MOSMARRËVESHJEN

7401/1 Procedura e arbitrazhit nis me depozitim të një ankimi nga një Anëtar i ALSE apo Emetues, pranë Sekretarit të Komisionit të Arbitrazhit.

7401/2 Në ankim duhet të jepen faktet dhe provat që vërtetojnë ekzistencën e një mosmarrëveshjeje me Anëtarin kundër të cilit depozitohet ankimi (i padituri) apo kundrejt Bursës ALSE.

7401/3 Ankimi duhet të përfshijë të paktën elementet e mëposhtme:

- emrin/adresën e paditësit;
- emrin/adresën e të paditurit;
- objektin e mosmarrëveshjes;
- bazën ligjore ku mbështet Ankimi.

Neni 7402 MBROJTJA NDAJ ANKIMEVE

7402/1 Pas marrjes së ankimit të plotë, Sekretari i Komisionit të Arbitrazhit i dërgon të paditurit nëpërmjet postës dhe/ose postës elektronike një kopje të ankimit, së bashku me dokumentet shoqëruese.

7402/2 I padituri mund të paraqesë me shkrim argumentet e tij/saj kundërshtuese brenda 5 ditësh pune nga marrja e ankimit. Argumentet kundërshtuese duhet të përfshijnë të gjithë informacionin që mund të ndihmojë në zgjidhjen e menjëhershme dhe të plotë të mosmarrëveshjes.

7402/3 Mosparaqitja e argumenteve kundërshtuese brenda afatit të parashikuar në Nenin e mësipërm 7402/2 nga ana e të paditurit, nuk çon në pezullimin e procedurave të arbitrazhit. Brenda 3 ditësh pune pas përfundimit të këtij afati, Sekretari i thërret palët që janë në mosmarrëveshje në seancën paraprake të arbitrazhit, e cila kryesohet nga Kryetari i Komisionit të Arbitrazhit.

7402/4 Seanca paraprake e arbitrazhit do të jetë në formën e një seance ndërmjetsuese mes palëve në mosmarrveshje, ku secila prej palëve duhet të mundohet të bejë më të mirën për arttijen e një marrveshje me palën tjetër dhe shuarjes së konfliktit mes tyre.

SEKSIONI 7.5. EMËRIMI I PANELIT TË ARBITRAZHIT

Neni 7501 EMËRIMI I ARBITRAVE

7501/1 Gjatë seancës paraprake të arbitrazhit, secila prej palëve në mosmarrëveshje emëron një arbitër nga anëtarët e Komisionit të Arbitrazhit.

7501/2 Nëse asnjë prej palëve nuk arrin të emërojë një arbitër, atëherë Kryetari i Komisionit të Arbitrazhit do t'i emërojë ata në emër të palëve.

7501/3 Kryetari i panelit (arbitri i tretë) zgjidhet unanimisht nga dyja palët e përfshira në mosmarrveshje. Nëse palët nuk arrijnë një marrëveshje në lidhje me emërimin e kryetarit, atëherë Kryetari i Komisionit në vullnetin e tij mund të zgjedhë ta kryesojë vetë panelin ose t'ia caktojë këtë detyrë një arbitri tjetër.

Neni 7502 PAVARËSIA E ARBITRAVE

7502/1 Të gjithë arbitrat e emëruar që janë pjesë e panelit të arbitrazhit duhet të jenë të pavarur nga palët në mosmarrëveshje dhe të sigurojnë paanshmëri gjatë kohëzgjatjes së procedurave të arbitrazhit.

7502/2 Të gjithë arbitrat e emëruar që janë pjesë e panelit të arbitrazhit duhet të njoftojnë menjëherë Kryetarin e Komisionit të Arbitrazhit për çdo rrethanë ose fakt mbi konflikteve të interesit të mundshëm apo ekzistente të cilat mund të ndikojë në paanshmëri në vendimmarrje.

7502/3 Kryetari i Komisionit të Arbitrazhit mund të vendosë që të përjashtojë një arbitër nga paneli i arbitrazhit dhe ta zëvendësojë atë me një anëtar tjetër pas marrjes së një kërkesë të arsyetuar nga cilado palë e mosmarrëveshjes ose pas marrjes së informacionit nga arbitri i caktuar sipas Nenit 7502/2 të mësipërm.

SEKSIONI 7.6. SEANCAT E PANELIT TË ARBITRAZHIT

Neni 7601 SEANCAT E ARBITRAZHIT

7601/1 Procedurat e arbitrazhit nisin brenda 3 ditësh pune pas formimit të panelit të arbitrazhit.

7601/2 Palët në mosmarrëveshje mund të zgjedhin që të përfaqësohen në arbitrazh nga një përfaqësues ligjor. Autorizimi për përfaqësuesin ligjor duhet të jetë me shkrim.

7601/3 Seancat e arbitrazhit mund të zhvillohen edhe në mungesë të njërit prej palëve në mosmarrëveshje, me kusht që kjo e fundit të jetë njoftuar në mënyrën e duhur për seancën dëgjimore. Megjithatë, në rast mungese për arsye të justifikueshme, paneli i arbitrave mund të vendosë shtyrjen e seancës dëgjimore maksimumi deri në 3 ditë pune.

7601/4 Gjatë seancave të arbitrazhit, palët në mosmarrëveshje mund të dorëzojnë çdo dokument që e konsiderojnë të rëndësishëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe mund të thërrasin edhe dëshmitarë.

Neni 7602 PROCESVERBALI

Diskutimet gjatë seancave të arbitrazhit regjistrohen me anë të regjistrimit vokal (audio recording) e cila do të zbardhet brenda 3 ditë pune në procesverbal. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët

e panelit të arbitrazhit dhe nga palët në mosmarrëveshje ose përfaqësuesit e tyre, mosnëshkrimi i procesverbalit nga cilido prej pjesmarrësve në seancën e arbitrazhit nuk do të sjellë pavlefshmërinë e tij.

SEKSIONI 7.7. VENDIMI I PANELIT TË ARBITRAZHIT

Neni 7701 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJES ME MIRËKUPTIM

7701/1 Paneli i arbitrazhit mund ta mbyllë procedurën e arbitrazhit në rast se gjatë kësaj procedure palët arrijnë një marrëveshje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe me kushtin që kjo marrëveshje e arritur prej tyre të jetë në përputhje me Ligjet e zbatueshme Shqiptare.

7701/2 Me kërkesë të palëve në mosmarrëveshje, paneli i arbitrazhit mund të marrë një vendim për zyrtarizimin e marrëveshjes së arritur ndërmjet palëve.

Neni 7702 VENDIMI I ARBITRAZHIT

7702/1 Pasi dëgjon palët në mosmarrëveshje dhe pasi merr provat e paraqitura nga palët, paneli i arbitrazhit e shpall seancën të mbyllur dhe tërhiqet për të marrë vendimin.

7702/2 Vendimi i arbitrazhit merret me shumicën e votave të panelit të arbitrazhit. Vendimi i arbitrazhit jepet me shkrim dhe përmban arsyetimin e panelit të arbitrazhit, bazën ligjore mbi të cilën është marrë dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e panelit të arbitrazhit.

7702/3 Vendimi i arbitrazhit duhet të merret brenda 3 ditësh pune nga mbyllja e seancës dëgjimore. Në vendimin e arbitrazhit tregohet data dhe vendi i arbitrazhit.

7702/4 Sekretari i Komisionit të Arbitrazhit i dërgon një kopje origjinale të vendimit të gjitha palëve në mosmarrëveshje, si dhe palëve që duhet të kenë djeni (Autoritetet Kompetente, Bursa ALSE, Institucionet e Klerimi dhe Shlyerjes së Titujve).

SEKSIONI 7.8. SHPENZIMET DHE TARIFAT E PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT

Neni 7801 PËRGJEGJËSIA PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË ARBITRAZHIT

7801/1 Si parakusht për nisjen e procedurës së arbitrazhit, pala që paraqet ankimin duhet t'i paguajë tarifat e arbitrazhit pranë Sekretarit të Komisionit të Arbitrazhit. Gjithashtu Sekretari i Komisionit të Arbitrazhit i kërkon palës së paditur sigurimin e shumës përkatëse lidhur me tarifat e Komisionit të Arbitrazhit. Mospagimin i këtyre tarifave do të përbente shkelje nga ana e Anëtarit mospagues. ALSE është përgjegjëse për ndjekjen e shkeljeve të Anëtarëve të referuara sipas këtij Neni, si dhe arkëtimin e shumave të cilat duhet të ishin siguruar më parë.

7801/2 Tarifat në arbitrazhit përfshijnë tarifat e arbitrave të panelit të arbitrazhit dhe shpenzimet administrative të arbitrazhit. Tarifat e arbitrazhit miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës i ALSE (Shtojca5).

7801/3 Në vendimin e arbitrazhit, paneli i arbitrazhit vendos se cila palë në mosmarrëveshje do të ketë detyrimin për të mbuluar shpenzimet e arbitrazhit ose vendos t'i ndajë ato ndërmjet palëve.

SEKSIONI 7.9. RËNDËSIA E VENDIMIT TË ARBITRAZHIT

Neni 7901 ZBATIMI I VENDIMIT TË ARBITRAZHIT

7901/1 Palët në procedurën e arbitrazhit janë të detyruara që të zbatojnë vendimin e arbitrazhit.

7901/2 Vendimi i arbitrazhit nuk mund të apelohej. Megjithatë, cilado prej palëve në arbitrazh mund t'i paraqesë ankimet e veta në gjykatat kompetente shqiptare, në përputhje me dispozitat e Kodit Shqiptar të Procedurës Civile.

KAPITULLI 8: MONITORIMI I ANËTARËVE TË ALSE

SEKSIONI 8.1. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR ZBULIMIN DHE PARANDALIMIN E ABUZIMIT ME TREGUN

Neni 8101 OBJEKTI I KAPITULLIT 8

Kapitulli 8 përcakton rregullat dhe procedurat që zbatohen nga Anëtarët, për menaxhimin e urdhrave në tregun e bursës ALSE, dhe për transaksionet e ekzekutuara prej tyre nëpërmjet Sistemit ETS, për llogari të tyre ose për llogari të klientëve të tyre.

Neni 8102 NDALIMI I ABUZIMIT ME TREGUN NË ALSE

Në bazë të dispozitave të ligjit “Për Titujt”, aktet e ndaluara për abuzimin me tregun janë:

1. Tregtimi bazuar në informacion të privilegjuar sipas Neneve 93 dhe 94 të ligjit nr. 9879 datë 21.2.2008 “Për titujt”,
2. Manipulimi i Tregut sipas Nenit 98 të ligjit nr. 9879 datë 21.2.2008 “Për titujt”.

Neni 8103 PARANDALIMI DHE ZBULIMI I MANIPULIMIT ME TREGUN

8103/1 E drejta e ALSE për të ndërmarrë veprime

Me synimin për të shqyrtuar nëse tregtimi në ALSE është i drejtë dhe i rregullt apo jo, si dhe me qëllim zbulimin e ndonjë akti të mundshëm të abuzimit me tregun, bursa ALSE ndërmerr veprime për parandalimin dhe zbulimin e abuzimit me tregun, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në këtë Nen.

8103/2 Rregullat dhe procedurat për parandalimin e manipulimit me tregun

Rregullat dhe procedurat për parandalimin e manipulimit të tregut janë kryesisht dispozitat e Neneve të kësaj Rregullore ose të udhëzimeve që hartohen mbi bazën e tyre dhe parashikojnë parandalimin e manipulimit të tregut, së bashku me rregullat, procedurat dhe veprimet e tjera të ALSE në këtë fushë, dhe më konkretisht:

1. Rritja e ndërgjegjësimit të pjesëmarrësve në treg dhe edukimi i tyre mbi manipulimin me tregun;
2. Testimi i nivelit të njohurive të Brokerave si përdorues të ardhshëm të Sistemit ETS në lidhje me rregullat mbi ndalimin e manipulimit të tregut gjatë provimevetë aftësisht për përdorimin e Sistemit ETS;
3. Mundësimi i një sistemi të mirë informacioni dhe mekanizmave të mjaftueshme të tregtimit;
4. Analiza periodike të kushteve në tregun e bursës ALSE në aspektin e mjaftueshmërisë së mekanizmave të saj të tregtimit;
5. Informimi i pjesëmarrësve të tregut në ALSE për kushtet në tregun e bursës;
6. Pezullimii tregtimit në rastet e asimetrisë së informacionit në tregun e ALSE.

8103/3 Rregullat dhe procedurat për zbulimin e manipulimit me tregun

Rregullat dhe procedurat për zbulimin e manipulimit të tregut janë kryesisht dispozitat e Neneve të kësaj Rregullore ose të udhëzimeve që janë të hartuara mbi bazën e tyre dhe parashikojnë zbulimin e manipulimit të tregut, së bashku me rregullat, procedurat dhe veprimet e tjera të ALSE në këtë fushë, dhe më konkretisht:

1. Monitorimi i trendit dhe zbulimii devijimeve të rëndësishme në lëvizjet e çmimeve apo volumet e tregtimit të Titujve;
2. Monitorimi i trendit dhe zbulimi i devijimeve të rëndësishme në shpeshhtësinë e urdhrave, mënyra e regjistrimit të tyre në COB dhe mënyra e ekzekutimit të tyre;
3. Monitorimi dhe analizimi i formimit të çmimit brenda fazave përkatëse të tregtimit të Titujve;
4. Monitorimi i anulimeve dhe modifikimeve të transaksioneve të ekzekutuara;
5. Monitorimi i shlyerjes së transaksioneve të realizuara në tregun e bursës;
6. Monitorimi i lidhjes midis njoftimeve të Emetuesit dhe lëvizjeve të çmimeve, përpara ose pas njoftimeve publike;
7. Marrja e të dhënave nga Anëtarët e ALSE, në bazë të Nenit 8202/3 të Rregullores.

8103/4 Vlerësimi i manipulimit me tregun

Gjatë vlerësimit për të parë nëse sjellja specifike e një Anëtari të ALSE përbën manipulim të dyshuar të tregut siç parashikohet nga Neni 98 dhe 99 të ligjit "Për Titujt", ALSE merr parasysh në veçanti por pa u kufizuar me to, faktorët e mëposhtëm:

1. Nivelin e transparencës së praktikave të tregut të bursës ALSE;
2. Nivelin e kërkuar të mbrojtjes së investitorëve dhe të mbrojtjes së operacioneve të tregut në ALSE, veçanërisht bashkëveprimin e duhur të kërkesës dhe ofertës për Titujt;
3. Efektin mbi likuiditetin dhe efikasitetin e tregut;
4. Nëse praktika përkatëse merr parasysh ose jo mekanizmin e tregtimit dhe sistemin e tregtimit në ALSE;
5. Nëse praktika përkatëse lejon ose jo pjesëmarrësit e tregut të reagojnë siç duhet dhe në kohën e duhur për situatën e re të krijuar në treg nga kjo praktikë;
6. Nëse një praktikë e tillë paraqet ose jo rrezik për integritetin e tregut;
7. Gjetjet dhe rekomandimet e AMF-sëtë cilat i referohen zbulimit dhe parandalimit të manipulimit të tregut;
8. Karakteristikat strukturore të tregut të bursës ALSE, llojin e Titujve, dhe karakteristikat e pjesëmarrësve të tregut;
9. Ndryshimet e rëndësishme në mjedisin e tregut, të tilla si ndryshimet e rregullave të tregtimit ose të sistemit të tregtimit.

Neni 8104 ROLI I SISTEMIT TË INFORMACIONIT NË PARANDALIMIN DHE ZBULIMIN E MANIPULIMIT TË TREGUT

Në kuadër të rolit të rëndësishëm që ka sistemi i informacionit në bursën ALSE, rregullat dhe procedurat për parandalimin dhe zbulimin e manipulimit të tregut janë kryesisht si më poshtë vijon:

1. Zhvillimi dhe integrimi i kontrolleve dhe i paralajmërimeve në Sistemin ETS;
2. Zhvillimi dhe sigurimi i sistemeve, mekanizmave dhe algoritmeve të duhura të tregtimit;
3. Menaxhimi i kufizimeve të përditshme dhe dinamike të lëvizjes së çmimeve dhe parametrave të tjerë të tregtimit;
4. Zhvillimi dhe ofrimi i mbështetjes me informacion për monitorimin e respektimit të rregullave tregtare mbi ndalimin e manipulimit të tregut;
5. Zhvillimi dhe ofrimi i mbështetjes me informacion për zbulimin e transaksioneve të dyshimta.

SEKSIONI 8.2. MONITORIMI I ANËTAREVE DHE TRANSAKSIONEVE NË ALSE

Neni 8201 MONITORIMI I ANËTARËVE

8201/1 Monitorimi i Anëtarëve gjatë përmbushjes së detyrave të tyre

Monitorimi i Anëtarëve të ALSE gjatë përmbushjes së detyrave të tyre sipas rregullave dhe udhëzimeve vlen kryesisht për monitorimin dhe zbulimin e shkeljes së dispozitave të mëposhtme të rregullave dhe udhëzimeve:

1. Rregullat për detyrimet e Anëtarëve, sipas Seksioni 2.4 të kësaj Rregullore;
2. Rregullat mbi kushtet për shlyerjen e transaksioneve në ALSE dhe menaxhimin e urdhrave të tregtimit, në përputhje me Seksionet 2.5, 4.2, 4.4 dhe 4.6 të kësaj Rregullore;
3. Rregullat për tregtimin në ALSE, sipas Kapitullit 4 të kësaj Rregullore;
4. Rregullat për parandalimin dhe zbulimin e abuzimit me tregun sipas Seksionit 8.1 të kësaj Rregullore.

8201/2 Rëndësia e Shkeljeve

Shkelja e dyshuar e rregullave sipas pikës 4 të Nenit 8201/1 përbën një shkelje të dyshuar të rëndësishme të rregullave dhe udhëzimeve.

Mosrespektimi i detyrimeve nga ana e tyre, ose shkelja e rregullave të parashikuara nga pikat 1, 2 dhe 3 të Nenit 8201/1 nuk përbën një shkelje domethënëse të rregullave dhe udhëzimeve, përveç rasteve të mëposhtme:

- (i) Rrethanave të një rasti të veçantë, të konsideruar nga ALSE si i tillë;

- (ii) Përsëritjes së shkeljeve, përkatësisht dy (2) shkelje identike apo të ngjashme brenda një periudhe gjashtë (6) mujore;
- (iii) Shkeljes së njëkohshme të disa dispozitave;
- (iv) Vendimet e AMF-së parashikojnë ndryshe.

Për të vendosur nëse një shkelje është apo jo një shkelje e rëndësishme e rregullave dhe udhëzimeve, merret parasysh edhe ndikimi i mundshëm i shkeljes në operacionet e drejta dhe të rregullta të tregut të ALSE.

Neni 8202 MONITORIMI I TRANSAKSIONEVE

8202/1 Objekti i monitorimit të transaksioneve në ALSE

ALSE monitoron ekzekutimin e transaksioneve në bursë, në mënyrë që të zbulojë:

1. Shkeljen e rregullave të tregtimit, siç parashikohet në Kapitullin 4 të kësaj Rregullore;
2. Kushtet e parregullta të tregtimit, siç parashikohet nga paragrafi i dytë i këtij Neni;
3. Praktikrat që janë karakteristikë e abuzimit të tregut, siç parashikohet nga Seksioni 8.1 i kësaj Rregullore.

Kushtet e parregullta të tregtimit janë kryesisht kushtet e parregullta të tregtimit nga ana e bursës ALSE, një Anëtar i ALSE dhe/apo sistemeve të lidhura, të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi efikasitetin dhe cilësinë e realizimit të tregtimit apo formimin e çmimeve. Këto kushte të parregullta të cilat mund të ndodhin një herë të vetme por mund të jenë edhe në mënyrë të përsëritur, mund të komprometojnë në mënyrë të konsiderueshme operacionet e rregullta dhe të drejta të tregut të bursës, janë të tilla si:

1. Mjaftueshmëria, efikasiteti dhe cilësia e punës dhe e parametrave të mekanizmit të zgjedhur të tregtimit për një titull;
2. Çrregullimet, vonesat apo pasaktësitë në punën e sistemit të tregtimit të bursës ose në terminalin e tregtimit të një Anëtari;
3. Çrregullimet, vonesat apo pasaktësitë në funksionimin e sistemit të informacionit të Anëtarit(ve), apo shpërbërjen e sistemit të informacionit të bursës dhe të sistemit të informacionit të Anëtari(ve);
4. Çrregullimet, vonesat apo pasaktësitë në punën e sistemeve të informacionit që sigurojnë funksionimin normal të tregut të bursës (sistemi i shlyerjes, sistemi i transaksioneve të pagesave, etj);
5. Kushtet e tjera të parregullta të tregtimit që mund të shkaktojnë çrregullime të mëdha në tregun e bursës ALSE.

8202/2 Metodrat e monitorimit të transaksioneve në ALSE

Monitorimi i transaksioneve në ALSE që synon zbulimin e sinjaleve të abuzimit me tregun zbatohet kryesisht mbi bazën e vlerësimit të rrezikut për të gjithë tregjet e ALSE, duke pasur parasysh kryesisht kriteret e mëposhtme:

1. Volumet e tregtimit dhe likuiditetin e një Titulli;
2. Segmentin e tregut të ALSE ku është i listuar dhe tregtohet një Titull;
3. Gjetjet e mëparshme të procedurave të monitorimit;
4. Ndryshimet e rregullave që lidhen me tregtimin në ALSE dhe me abuzimin e tregut;
5. Klasifikimi i një Titulli në një prej metodave të tregtimit (e vazhdueshme; ankand);
6. Llojin e Titullit të tregtuar;
7. Nivelin e shpërndarjes së pronësisë tek investitorët të cilët nuk janë të mirë-informuar;
8. Udhëzime të hollësishme nga AMF, nëse ka.

Në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe kriterëve të parashikuara nga paragrafi i parë i këtij Neni, miratohet plani vjetor i monitorimit, i cili përshtatet sipas rrethanave të vlerësimit potencialisht të ndryshuar të riskut, nëse kjo është e nevojshme për shkak të rrethanave të reja në tregun e bursës ALSE.

8202/3 Marrja e të dhënave në monitorimin e transaksioneve në ALSE

ALSE monitoron ekzekutimin e transaksioneve në tregjet e bursës nga Anëtarët e saj përmes terminaleve mbikqyrëse të veçanta në Sistemin ETS. Kjo zakonisht përfshin vetëm të dhëna dhe informacion mbi urdhrat e regjistruar dhe transaksionet e ekzekutuara në ALSE, duke i nxjerrë ato direkt nga Sistemi ETS.

Të dhënat dhe informacionet e rëndësishme për zbatimin e detyrave në bazë të Kapitullit 8 dhe 9 të Rregullores, të cilat ALSE nuk mund t'i marrë sipas mënyrës së parashikuar nga paragrafi i parë i këtij Neni, bursa mund t'i kërkojë nga një Anëtar. Të dhënat dhe informacionet e tilla janë kryesisht sa më poshtë vijon:

1. Të dhënat nga libri i urdhrave dhe transaksioneve të Titujve të një Anëtari, në të cilin Anëtari hedh të dhënat për çdo urdhër dhe për çdo transaksion blerje dhe shitje që ka realizuar në tregun e ALSE për llogari të një klienti ose për llogari të vet;
2. Informacion nga të dhënat që një Anëtar mban për klientët;
3. Të dhënat për llojin dhe datën e marrëveshjes për shërbimet financiare që janë lidhur ndërmjet Anëtarit të ALSE dhe një klienti;
4. Çdo e dhënë tjetër në lidhje me monitorimin e tregimit në tregun e ALSE.

Në qoftë se është e mundur që të dhënat dhe informacionet të merren, siç parashikohet nga paragrafi i dytë i këtij Neni, direkt nga një regjistrar titujsh apo depozitar qendror, atëherë bursa ndjek këtë metodë pa ndonjë kërkesë paraprake ndaj Anëtarit përkatës.

Kushtet dhe mënyrat e mbledhjes të së dhënave sipas paragrafit të dytë dhe të tretë të këtij Neni, mund të detajohen në udhëzime.

KAPITULLI 9: RREGULLAT E SJELLJES

SEKSIONI 9.1. TË PËRGJITHSHME

Neni 9101 OBJEKTI I KAPITULLIT 9

Kapitulli 9 përcakton rregullat e sjelljes specifike për ALSE, që duhet të respektojnë Anëtarët gjatë tregtimit në këtë Treg të Rregulluar.

Neni 9102 DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË INTEGRITETIT, TRAJTIMIT TË DREJTË DHE KUJDESIT

9102/1 Gjatë tregtimit në ALSE, Anëtarët duhet:

- (i) të respektojnë standarde të larta të integritetit, të sjelljes në treg dhe të trajtimit të drejtë;
- (ii) të veprojnë me aftësitë dhe kujdesin e duhur; dhe
- (iii) të shmangin çdo veprim apo sjellje që mund të dëmtojë reputacionin e ALSE.

9102/2 Anëtarët duhet të sillen me përgjegjësi gjatë përdorimit të SistemitETS dhe të pajisjeve të tjera të vëna në dispozicion nga ALSE dhe duhet të përdorin Sistemin ETS dhe këto pajisje vetëm kur ekziston një nevojë legjitime.

9102/3 Anëtarët që veprojnë në emër të Klientëve duhet të sigurohen që çdo Klient të jetë i informuar për karakteristikat e rrezikut të Titujve në fjalë, në përputhje me Ligjet Shqiptare.

Neni 9103 BASHKËPUNIMI ME ALSE

9103/1 Gjatë tregtimit në ALSE, administratorët, nëpunësit, punëmarrësit, agjentët, përfaqësuesit e Anëtarëve duhet të veprojnë në mënyrë të hapur dhe bashkëpunuese, duhet të jenë të ndershëm dhe të vërtetë dhe nuk duhet të mashtrinë apo të fshehin ndonjë çështje të rëndësishme.

9103/2 Në mënyrë të veçantë, pa kufizuar përgjithësinë e Nenit 9103/1, një Anëtar duhet:

- (i) t'i përgjigjet plotësisht dhe në kohë të gjitha kërkesave për informacion të bëra nga ALSE në lidhje me aktivitetin e kryer në ALSE ose çështjet që kanë lidhje me këtë aktivitet dhe duhet të mundësojë akses në të gjithë librat, të dhënat, regjistrimet audio dhe llojet e tjera të dokumenteve, dhe
- (ii) të njoftojë menjëherë ALSE për çdo çështje që parashikohet të përbëjë shqetësim për ALSE në kontekstin e marrëdhënies së saj me këtë Anëtar, duke përfshirë (pa kufizim) çdo veprim korporativ ose veprime të tjera me Tituj që mund të shkaktojnë moszbatimin e Rregullores nga Anëtari. Kjo detyrë e dhënies së informacionit lind menjëherë sapo Anëtari informohet ose ka baza të arsyeshme për të besuar se ka lindur apo do të lindë ky shqetësim.

Neni 9104 MOS-LEJIMI I MASHTRIMIT OSE KEQINFORMIMIT

9104/1 Gjatë kryerjes së aktivitetit për veten dhe/ose në emër të Klientëve të tij, Anëtari nuk duhet të përfshihet dhe/apo të ndihmojë me vetëdije ose të mos marrë hapat e nevojshme për të parandaluar:

- (i) ndonjë veprim ose sjellje që çon ose pritet të çojë në lëvizjen artificiale dhe/ose jonormale të çmimit ose vlerës së ndonjë Titulli të pranuar në listim/tregtim ose ndonjë instrumenti përbërës të Titullit të pranuar në listim/tregtim ose të nivelit të ndonjë indeksi në përbërje të së cilit është një Titull i pranuar në listim/tregtim.
- (ii) futjen e urdhrave artificialë ose përfshirjen në ose shkaktimin e ndonjë transaksioni artificial;
- (iii) raportimi i një transaksioni fiktiv ose të dhënave të tjera të rreme tëALSE ose të bërit që këto të dhëna të futen në Sistemin ETS;
- (iv) çdo veprim ose sjellje që krijon ose pritet të krijojë ndonjë përshtypje të rreme ose keqinformuese për tregun, çmimin ose vlerën e një Titulli të pranuar në listim/tregtim;

- (v) çdo veprim ose çdo lloj sjellje tjetër që mund të dëmtojë integritetin dhe transparencën e ALSE; ose

9104/2 Për të shmangur çdo dyshim, një Anëtar është përgjegjës për të gjithë aktivitetin që kryhet në emër të tij, pavarësisht nëse ky aktivitet ushtrohet ose jonë emër të një klienti, dhe pavarësisht nëse ky aktivitet është futur nga ky Klient në Sistemin ETS nëpërmjet Anëtarit apo me anë të një AutORS në emër të një Aksesit të Sponsorizuar.

9104/3 Kur një Anëtar vihet në dijeni të një veprimi ose sjellje të ndërmarrë nga një Klient ose një Brokleri ose një individ që tregton nëpërmjet një Brokleri, e cila është ose duket se është e papajtueshme me kërkesat e Nenit 9104, ai e raporton atë menjëherë tek ALSE sipas Nenit 9103. Çdo Anëtar duhet të garantojë se ai ka ngritur kontrollet dhe procedurat e përshtatshme për të identifikuar veprimtaritë e kryera nga Klientët e tij, ose nëpërmjet Brokerave të tij, të cilat mund të jenë të papajtueshme me kërkesat e Nenit 9104.

Neni 9105 PËRDORIMI I SISTEMIT TË TREGTIMIT TË ALSE

9105/1 Kur përdor Sistemin ETS dhe pajisje të tjera të lidhura me të, një Anëtari i ndalohet të përfshihet në praktika që mund të çojnë në degradimin e shërbimit ose që mund të çojnë në një treg të çrregullt. Këto praktika përfshijnë, por nuk kufizohen me, dorëzimin e mesazheve elektronike ose kërkesave të paautorizuara ose të tepërta në Sistemin ETS.

Neni 9106 KONTROLLET E BRENDSHME

9106/1 Anëtari ngre dhe mban një sistem të përshtatshëm kontrollesh të brendshme i cili garanton që Anëtari të jetë vazhdimisht në pajtim me të gjitha kërkesat e vendosura sipas Rregullores ose në zbatim të saj.

9106/2 Sistemi i kontrolleve të brendshme përmban procedura të brendshme specifike për kompetencat e Anëtarit në ALSE. Këto procedura dokumentohen dhe përditësohen rregullisht. Në rastin kur një Anëtar ushtron aktivitet në emër të Klientëve, ai duhet të ketë ngritur kontrolle dhe procedura të përshtatshme për të garantuar, deri në masën e mundshme, që ky aktivitet të jetë në pajtim, ndër të tjera, me Nenin 9104.

9106/3 Kontrollet e brendshme të një Anëtari përfshijnë kontrollet e menaxhimit të rrezikut para dhe pas tregtimit që i përshtaten natyrës, shkallës dhe kompleksitetit të aktivitetit të Anëtarit në ALSE. Për të shmangur çdo dyshim, kjo, ndër të tjera, nënkupton se një Anëtar garanton se ai ka marrë masat e përshtatshme:

- (i) për të shqyrtuar urdhrat përpara regjistrimit (futjes) së tyre në COB, pavarësisht nëse këto urdhra janë regjistruar manualisht ose në mënyrë elektronike (duke përfshirë nëpërmjet një AutORS në emër të një Aksesit të Sponsorizuar); dhe
- (ii) për të monitoruar rrezikun e pozicionit dhe rrezikun financiar në aktivitetin që ai kryen në emër të tij dhe në emër të Klientëve të tij.

9106/4 Sipas masave të vendosura nga një Anëtar në zbatim të Nenit 9106/3, Anëtari duhet të jetë në gjendje t'i vërtetojë ALSE se kërkesat monitoruese të mëposhtme janë integruar në sistemet e Anëtarit për kontrollin e rrezikut:

- (i) kufijtë e pozicionit;
- (ii) përcaktimet e përdoruesit (d.m.th. aftësia për të përcaktuar përdoruesit individualë);
- (iii) përcaktimet e produktit (d.m.th. aftësia për të kufizuar aksesin në disa Tituj specifike të pranuar në listim/tregtim ose në grupe specifike të Titujve të pranuar në listim/tregtim);
- (iv) sasia maksimale e urdhrat për përdorues; dhe
- (v) ose refuzimin automatik të urdhrat kur tejkalohet një kufi ose bllokimi i urdhrat përmes një refuzimi manual nga një menaxher i autorizuar i rrezikut.

9106/5 ALSE mund të specifikojë me anë të Njoftimit kërkesat shtesë në lidhje me shqyrtimin para tregtimit dhe menaxhimin e rrezikut pas tregtimit.

9106/6 Një Anëtar merr masat e përshtatshme për të garantuar që i gjithë stafi i përfshirë në kryerjen e aktivitetit në ALSE të jetë i përshtatshëm, i trajnuar mirë dhe i mbikëqyrur siç duhet.

9106/7 ALSE mund të vërë në dispozicion të Anëtarëve të saj dhe të Agjentëve të Klerimit dhe Shlyerjes (CSM) instrumente për menaxhimin e rrezikut para dhe pas tregtimit, duke përfshirë masa që do t'i lejonin një CSM të anulonte menjëherë aksesin në Sistemin ETS për një Anëtar për të cilin ai bën klerim ose që do t'i lejonin një Anëtar që të pezullonte aksesin e tij. Kushtet për përdorimin e këtyre instrumenteve dhe masave specifikohen me anë të Njoftimit.

SEKSIONI 9.2. GJURMUESHMËRIA E AUDITIMIT

Neni 9201 REGJISTRIMI I DETAJEVE TË URDRIT

9201/1 Në zbatim të Ligjeve Shqiptare, një Anëtar garanton se çdo urdhër i marrë nga një Klient regjistrohet dhe i vihet shënjimi kohor menjëherë. Regjistrimit të urdhrin duhet t'i vihet sërish shënjimi kohor menjëherë sapo ai ekzekutohet dhe gjithashtu edhe në kohën e donjë ndryshimi ose anulimi të urdhrin nga ana e Klientit.

9201/2 Të dhënat e urdhrin mund të mbahen në mandatet e urdhrin ose nëpërmjet mjeteve elektronike ose nëpërmjet mjeteve të tjera të specifikuara nga ALSE, me kusht që këto metoda regjistrimi të jenë në pajtim me kërkesat e Nenit 9201.

9201/3 Të dhënat e urdhrave duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm dhe çdo informacion shtesë që kërkohet nga ALSE:

- (i) Identitetin e individit që regjistron urdhrin në Sistemin ETS dhe, kur gjen zbatim, terminalin ku ai dorëzohet;
- (ii) identitetin e individit që plotëson të dhënat e urdhrin;
- (iii) identifikimin e klientit;
- (iv) blej/shes;
- (v) volumi;
- (vi) Titulli i pranuar në listim/tregtim;
- (vii) muaji i dorëzimit/skadimit (nëse gjen zbatim);
- (viii) çmimi ose taveni i çmimit;
- (ix) lloji i urdhrin dhe kushtet e ekzekutimit/shënimet për urdhrin; dhe

9201/4 Të gjitha të dhënat e urdhrin, të çfarëdo lloji qofshin, duhet të jenë:

- (i) të qëndrueshme, të sigurt dhe të patjetërsueshme;
- (ii) të bëhen të disponueshme:
 - (a) menjëherë në ditën e transaksionit; dhe
 - (b) brenda një periudhe kohore të arsyeshme pas transaksionit, kur kërkohen nga ALSE; dhe
- (iii) të paraqiten në një mënyrë që është lehtësisht e deshifrueshme nga ALSE.

9201/5 Anëtarët që përdorin mjete elektronike për të mbajtur të dhënat e urdhrin duhet të kenë ngritur procedura për ngjarje të paparashikuara në rast avarish në sisteme, që mund të përfshijnë sisteme mbështetëse ose përdorimin e një gjurmueshmërie auditimi të bazuar në kopje të mbajtura në letër, në mënyrë që të mos ketë humbje të të dhënave të gjurmueshmërisë së auditimit.

Neni 9202 MBAJTJA E INFORMACIONIT

9202/1 Anëtari ruan për një periudhë 5 (pesë) vjeçare të dhënat për:

- (i) parametrat e ekzaminimit automatik dhe modifikimet e tyre si edhe urdhrat e refuzuar, sipas Nenit 9106/3;
- (ii) urdhrat, e radhitur në rend kronologjik, sipas Nenit 9201/1; dhe
- (iii) transaksionet dhe, nëse është e zbatueshme, shlyerjen e tyre dhe ruajtjen e Titujve që tregtohen në ALSE.

Të gjitha të dhënat që mbahen sipas Nenit 9202 janë të disponueshme për inspektim nga ALSE.

KAPITULLI 10: MASAT NË RASTIN E SHKELJES SË RREGULLAVE

SEKSIONI 10.1. OBJEKTI I KAPITULLIT 10

Neni 10101

Një shkelje e pretenduar e një detyrimi të Rregullores, nga një Anëtar, që lidhet me funksionimin e tregjeve të ALSE trajtohet në përputhje me dispozitat e këtij Kapitulli.

Neni 10102

Ky Kapitull nuk çënon:

- (i) asnjë veprim/dhe ose masë që mund të marrë ALSE bazuar në procedurat e përcaktuara në një pjesë tjetër të Rregullores;
- (ii) të drejtën për të kryer kontrollenë terren sipas Kapitullit 2;
- (iii) çdo dispozitë të Ligjeve Shqiptare që zbatohet nga Autoritetet Kompetente.

Neni 10103 MASA TË MENJËHERSHME

Në rastin kur shkelja e Rregullores nga një Anëtar përbën një kërcënim për integritetin ose sigurinë e tregjeve, ose sipas udhëzimeve të AMF, ALSE mund të marrë masa të menjëhershme për të mbrojtur tregun, duke përfshirë pezullimin e të gjitha ose të disa prej të drejtave të Anëtarit për tregtim në përputhje me Nenin 2603 të kësaj Rregullore.

Këshilli Mbikëqyrës i ALSE, me anë të një Vendimi të veçantë, mund t'i delegojë Administratorit të ALSE të drejtën për të ndërmarrë masa të menjëhershme, siç përshkruhen në paragrafin e parë të Nenit 10103.

Megjithatë, vendimi i Administratorit të ALSE është i përkohshëm dhe duhet t'i paraqitet Këshillit Mbikëqyrës ALSE për miratim (ose refuzim) jo më vonë se tre (3) ditë pasi masa e menjëhershme është zbatuar për Anëtarin.

SEKSIONI 10.2. PROCEDURA

Neni 10201 SHQYRTIMI

Për shqyrtimin e shkeljes së pretenduar ALSE mund:

- (i) t'i kërkojë Anëtarit që t'i japë çdo informacion, kopje të të dhënave dhe dokumenteve që mund të kenë lidhje me shqyrtimin e Shkeljes së Pretenduar;
- (ii) të dërgojë një përfaqësues në zyrat e një Anëtari në çdo kohë gjatë orarit normal të punës në vendin dhe/ose shtetin në të cilin ndodhen këto zyra, i cili mund të kërkojë akses të menjëhershëm në të gjitha informacionet, të dhënat dhe dokumentet që mban një Anëtar të cilat mund të kenë lidhje me shqyrtimin e Shkeljes së Pretenduar; dhe/ose
- (iii) t'i kërkojë çdo Anëtarit që të takohet me ndonjë prej administratorëve, zyrtarëve, punonjësve, agjentëve dhe përfaqësuesve të tij në një kohë dhe vend të specifikuar, ose në zyrat e ALSE ose në zyrat e Anëtarit, me qëllim që t'u përgjigjen pyetjeve ose të japin shpjegime që mund të kenë lidhje me shqyrtimin e Shkeljes së Pretenduar.

Neni 10202 KONFIDENCIALITETI

ALSE përdor çdo informacion të marrë në zbatim të Nenit 10201 vetëm për qëllimet dhe brenda objektit të Kapitullit 10 dhe të çdo procedure arbitrazhi ose gjyqësore dhe nuk do ta bëjë këtë informacion publik përveç se:

- (i) për AMF ose autoritete të tjera publike që kanë juridiksion për çështjen në fjalë;
- (ii) kur i kërkohet ndryshe nga ligjet dhe rregulloret e zbatueshme; ose
- (iii) sipas marrëveshjeve për shkëmbimin e informacionit me bursa të tjera ose Institucione Klerimi dhe Shlyerje, nëse edhe këto marrëveshje duhet të respektojnë një konfidencialitet të barasvlershëm.

Neni 10203 RAPORTI

10203/1 Në rastet kur ka një Shkelje të Pretenduar ALSE bën një raport me shkrim.

10203/2 Në këtë raport përfshihen gjetjet e ALSE dhe një referencë për nenet e Rregullores që pretendohet se janë shkelur nga Anëtari përkatës.

10203/3 Menjëherë pas përfundimit të tij ALSE ia dërgon këtë raport Anëtarit përkatës.

10203/4 ALSE i jep Anëtarit përkatës një mundësi për të dhënë përgjigjen e tij me shkrim brenda dy (2) javësh pas marrjes së raportit, përveç se kur specifikohet ndryshe.

10203/5 Çdo koment që bën Anëtari i bashkëngjitet raportit të përmendur.

Neni 10204 TAKIMI SQARUES

10204/1 Pas përfundimit të raportit dhe pas marrjes së komenteve me shkrim të Anëtarit, nëse ka, ALSE organizon një takim me Anëtarin. Ky takim i lejon të dyja palët që të bëjnë pyetje të tjera dhe të japin përgjigje për një Shkelje të Pretenduar.

10204/2 Takimi mbahet në mjediset e ALSE ose, nëse bien dakord të dyja palët, në një vend tjetër.

10204/3 Në këtë takim të dyja palët, sipas gjykimit të tyre, mund të sjellin një përfaqësues, ekspert ose ndonjë person tjetër të autorizuar. Secila palë do të garantojë konfidencialitetin e informacionit jopublik që u jepet pjesëmarrësve në takim dhe mban përgjegjësi për shkeljen e konfidencialitetit nga të pranishmit në emër të tyre, përveç se kur pjesëmarrësit kanë një detyrim ligjor për ta publikuar informacionin. Të dyja palët kanë mundësinë që të kundërshtojnë pjesëmarrjen e ekspertëve ose personave të tjerë nëse ata mund të vërtetojnë se këta persona preken nga konfliktet e interesit.

10204/4 Numri i personave që marrin pjesë në takim për secilën palë nuk është më i madh se tetë, përveç se kur ALSE dhe Anëtari bien dakord ndryshe.

10204/5 Sipas një kërkesë paraprake nga Anëtari, ALSE mban procesverbalin e këtij takimi, i cili nënshkruhet nga ALSE dhe Anëtari.

SEKSIONI 10.3. KORRIGJIMI, PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI

Neni 10301

Në rastet kur janë shkelur nenet e Rregullores ALSE mund:

- (i) t'i kërkojë Anëtarit që të përmbushë detyrimet e tij në zbatim të Rregullores ose të kërkojë korrigjim në favor të ALSE brenda një afati të specifikuar për shkeljen nga ana e një Anëtari të një detyrimi të parashikuar nga Rregullorja;
- (ii) ose:
 - (a) t'i kërkojë Anëtarit likuidimin e dëmeve për një shkelje të Rregullores, për një shumë të caktuar nga 70 000 Lek deri në 32 500 000 Lek, sipas një shkalle të shpallur në Njoftim; ose
 - (b) të kërkojë një kompensim të çdo lloji për dëmin që i është shkaktuar interesit të ALSE si aktivitet tregtar dhe si një Treg i Rregulluar ose integritetit ose sigurisë së tregjeve të saj, nëse dëmi është vërtetuar se është më i lartë sesa shuma e caktuar në germën (a). Ankimi kufizohet vetëm në dëmin e drejtpërdrejtë, përveç rastiit të shkeljes me dashje ose pakujdesisë së rëndë;
- (iii) të pezullojë disa nga të drejtat e Anëtarit për tregtim ose për Anëtarësim për një periudhë kohore prej jo më shumë se gjashtë (6) muaj;
- (iv) të pezullojë Anëtarësimin e Anëtarit në ALSE për një periudhë kohore prej jo më shumë se gjashtë (6) muaj;
- (v) të ndërpresë (përfundojë) aksesin në disa pajisje;
- (vi) t'i japë fund (përfundojë) Anëtarësimin të Anëtarit në ALSE; dhe/ose
- (vii) të publikojë të gjithë se një pjesë të vendimit të marrë nga ALSE në zbatim të kësaj Rregullore.

Neni 10302

Anëtari përkatës informohet për vendimin e ALSE nëpërmjet një shkrese zyrtare të dërguar me postë me konfirmim marrje.

Neni 10303

ALSE informon menjëherë Anëtarët e tjerë, Institucionin e Klerimit dhe Shlyerjes për:

- (i) një pezullim ose përfundim të Anëtarësimit të ndonjë Anëtari;
- (ii) periudhën e këtij pezullimi; dhe
- (iii) vendimin e Anëtarit për të kundërshtuar vendimit përpara një gjykate kompetente ose një institucioni arbitrazhi.

SEKSIONI 10.4. RAPORTIMI DHE PUBLIKIMI**Neni 10401 RAPORTIMI**

ALSE:

- (i) i raporton AMF-së për monitorimin e pajtueshmërisë si edhe për shkeljet e kësaj Rregullore mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet ALSE dhe AMF;
- (ii) njofton menjëherë AMF-në për një vendim për të pezulluar ose hequr të drejtat e Anëtarit për tregtim ose për Anëtarësim sipas Kapitullit 10;
- (iii) përgatit dhe publikon një raport të përgjithshëm për zbatimin e Kapitullit 10 herë pas here, por të paktën një herë në vit. Kur është e nevojshme për të mbrojtur integritetin ose sigurinë e tregjeve ky raport mund të bëjë publikë identitetet e Anëtarëve të përfshirë.

Neni 10402 SHKELJA E LIGJEVE SHQIPTARE

Në rast se ALSE, gjatë shqyrtimit të një Shkeljeje të Pretenduar ose në ndonjë rast tjetër, konstaton shenja të konsiderueshme të një shkelje të mundshme të Ligjeve Shqiptare, ajo e raporton këtë çështje sa më parë tek Autoriteti Kompetent përkatës, përfshi AMF-në.

SEKSIONI 10.5. PËRGJEGJËSIA PAS PËRFUNDIMIT TË ANËTARËSIMIT OSE PAS DORËHEQJES**Neni 10501**

Përfundimi ose dorëheqja nga Anëtarësimi në ALSE nuk cenon të drejtën e ALSE për të kërkuar prova dhe për të kërkuar kompensim financiar sipas Nenit 1030 (ii) për dëmet e shkaktuara nga ndonjë shkelje e Rregullores nga ana e një Anëtari.

KAPITULLI 11: KOMITETI I DISIPLINËS

SEKSIONI 11.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 11101 TRAJTIMI I RASTEVE PËR SHKELJE

Kompetencë e Komitetit të Disiplinës ("Komiteti i Disiplinës") do jetë shqyrtimi i shkeljeve të konstatuara, marrja e masave dhe/ose propozimi i masave në Këshillin Mbikëqyrës sipas rastit, në përputhje me Rregulloren e Penaliteteve të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bursës ALSE.

Objekt trajtimi i Komitetit të Disiplinës do të jenë çështjet kundrejt Anëtarëve të ALSE lidhur me konstatimet e ALSE për shkeljet që kanë kryer Anëtarët kundrejt Anëtarëve të tjerë të tregut ALSE apo kundrejt ALSE dhe që bien në kundërshtim me këtë Rregullore dhe/apo rregulla dhe udhëzime të nxjerra rishtazi nga ALSE.

Neni 11102 PAANSHMËRIA NË MARRJEN E VENDIMEVE

Komiteti i Disiplinës do të jetë përgjegjës për marrjen dhe vendosjen e masave disiplinore, propozimin e masave në Këshillin Mbikëqyrës (sipas rastit), në mënyrën më të drejtë, efikase dhe profesionale, kundrejt Anëtarëve të ALSE, lidhur me shkeljet dhe/apo ushtrimin e veprimtarisë në mospërputhje me Ligjet Shqiptare dhe Rregullat e ALSE në fuqi, kundrejt Anëtarëve të ALSE dhe vetë ALSE, që lidhet me tregtimin e Titujve.

Neni 11103 SELIA E KOMITETIT TË DISIPLINËS

Komiteti i Disiplinës është një komitet i përhershëm dhe i pavarur i ngritur brenda ALSE, me seli në zyrat qendrore të ALSE.

SEKSIONI 11.2. PËRBËRJA E KOMITETIT TË DISIPLINËS

Neni 11201 PËRBËRJA E KOMITETIT TË DISIPLINËS

11201/1 Komiteti i Disiplinës përbëhet nga 5 anëtarë, një prej të cilëve është Kryetari.

11201/2 Anëtarët e Komitetit të Disiplinës emërohen nga Këshilli Mbikëqyrës i ALSE (në vijim: "Këshilli") me shumicë të thjeshtë, me propozim të Administratorit të ALSE.

11201/3 Mandati i emërimit të anëtarëve të Komitetit të Disiplinës është 3 vjet, me të drejtë riemërimi për një (1) mandat shtesë.

11201/4 Një (1) prej Anëtarëve të Komitetit të Disiplinës do të jetë punonjës i ALSE i cili e ushtron funksionin e tij me kohë të plotë/pjesë pranë ALSE, duke përfshirë por pa u kufizuar në: Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të ALSE, Administratorin e ALSE, drejtues të njësisë brenda ALSE apo punonjës specialist të ALSE. Pavarësisht nëse është përcaktuar ndryshe në nenin 11201/3, mandati i këtij anëtarit të Komitetit të Disiplinës, i cili do të zgjidhet si anëtar i parë, do të jetë një (1) vjeçar.

11201/5 Një (1) prej Anëtarëve do të përzgjidhet me konsensus nga Anëtarët ALSE. Anëtar i përzgjedhur nga Anëtarët ALSE për të qënë pjesë e Komitetit të Disiplinës, nuk duhet të jetë në rolin e punonjësit apo përfituesit fundor (pronarit/aksionerit) në asnjë prej shoqërive që janë në rolin e Anëtarit ALSE. Pavarësisht nëse është përcaktuar ndryshe në nenin 11201/3, mandati i këtij anëtarit të Komitetit të Disiplinës, i cili do të zgjidhet si anëtar i parë, do të jetë dy(2) vjeçar.

11201/6 Tre (3) anëtarët e tjerë të Komitetit të Disiplinës do të përzgjidhen nga jashtë ALSE. Këta tre (3) anëtarë do të vinë përkatësisht nga:

- Një (1) anëtar nga fusha e jurisprudencës;
- Një (1) anëtar nga fusha e ekonomisë dhe financiare;
- Një (1) anëtar nga bota akademike e cila i përket dy pikave më sipër.

Mandati i këtij anëtarit të Komitetit të Disiplinës, do të jetë një mandat i plotë tre (3) vjeçar i parashikuar më lart në nenin 11201/3.

11201/7 Kryetari i Komitetit të Disiplinës do të zgjidhet me votim nga anëtarët e Komitetit të Disiplinës. Të drejtën për të qënë në rolin e Kryetarit të Komitetit të Disiplinës do ta kenë vetëm Anëtarët e përcaktuar në pikën 11201/6Mandati i kryetarit të Komitetit të Disiplinës do të jetë 1 (një) vjeçar. Mandati i Kryetarit të Komitetit të Disiplinës nuk mund të shtrihet përtej mandatit si Anëtarë i Komitetit të Disiplinës.

11201/8 Anëtarët e Komitetit të Disiplinës mund të përfundojnë mandatin e tyre përpara përfundimit të emërimit të tyre, në rrethanat e mëposhtme:

- me kërkesë të tyre, të dërguar Këshillit Mbikëqyrës të ALSE;
- kur dënohen me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- kur nuk janë në gjendje të kryejnë detyrën e tyre si anëtarë.
- kur për arsye të ndryshme anëtari i Komitetit të Disiplinës largohet/apo i përfundon kontrata e punës me ALSE (e aplikueshme vetëm për anëtarët e referuar sipas pikës 11201/4 të kësaj Rregullore).
- kur një gjë e tillë kërkohet nga Anëtarët e ALSE për anëtarin e Komitetit të Disiplinës të zgjedhur prej tyre sipas pikës 11201/5 të kësaj Rregulloreje.

11201/9 Përfundimi i mandatit të anëtarit të Komitetit të Disiplinës duhet të konfirmohet nga Këshilli Mbikëqyrës i ALSE, i cili duhet të emërojë një anëtar të ri në po atë mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës të ALSE.

Neni 11202 SEKRETARI I KOMITETIT TË DISIPLINËS

Komiteti i Disiplinës asistohet nga një Sekretar. Sekretari i Komitetit të Disiplinës duhet të jetë me profesion "Jurist". Sekretari emërohet nga Kryetari i Komitetit të Disiplinës me një mandat dy (2) vjeçar. Gjatë ushtrimit të funksionit të tij, Sekretari përdor ambjentet dhe pajisjet e ofruara nga Bursa ALSE.

SEKSIONI 11.3. VENDIMARRJA E KOMITETIT TË DISIPLINËS

Neni 11301 VENDIMARRJA

Anëtarët e Komitetit të Disiplinës i marrin vendimet në trupë të përbëra nga pesë (5) anëtarë, ku njëri prej anëtarëve do të jetë në rolin e Kryetarit të Komitetit i cili do të ketë rolin për të drejtuar mbledhjen, ndërsa katër (4) anëtarët e tjerë do të jenë në rolin e anëtarëve të zakonshëm. Në rastet kur Kryetari i Komitetit të Disiplinës është në pamundësi për të marrë pjesë në punimet e Komitetit të Disiplinës, Kryetari i delegon me shkrim (letër, postë elektronike, fax të dërguar tek sekretari i Komitetit të Disiplinës) kompetencat e tij një Anëtar tjetër të Komitetit të Disiplinës.

11301/2 Anëtarët e Komitetit të Disiplinës gjatë procesit të shqyrtimit, vendimarrjes, dhe propozimit të masave lidhur me rastet e paraqitura duhet të sigurojnë paanshmëri gjatë shqyrtimit të çështjeve dhe të jenë në përputhje me Rregullat dhe procedurat ALSE në fuqi.

Neni 11302 FUSHA E VEPRIMTARISË SË KOMITETIT TË DISIPLINËS

11302/1 Për marrjen e vendimit dhe/apo propozimit të masave Këshillit Mbikëqyrës ALSE anëtarët e Komitetit zbatojnë Rregulloret, Procedurat, Udhëzimet e nxjerra nga ALSE, si dhe çdo dispozitë përkatëse të Ligjeve Shqiptare.

11302/2 Mbledhjet e Komitetit të Disiplinës zhvillohen në seanca të mbyllura për publikun, gjatë të cilave anëtarët e Komitetit të Disiplinës sipas rasti përcaktojnë shkeljen dhe vendosin masën e penaltit për Anëtarin e ALSE që ka kryer shkeljen.

11302/3 Punimet e Komitetit të Disiplinës mbeten konfidenciale për publikun deri në shpalljen zyrtare të vendimit dhe/ose propozimit, konfidencialiteti i punimeve është i detyrueshëm për t'u zbatuar prej të gjithë pjesëmarrësve në punimin e Komitetit të Disiplinës.

SEKSIONI 11.4. NISJA E MBLEDHJES SË KOMITETIT TË DISIPLINËS

Neni 11401 KËRKESA PËR MARRJEN E MASAVE PENALIZUESE

11401/1 Procedura e Komitetit të Disiplinës nis me depozitimin e një kërkesë nga ana e Administratorit të ALSE lidhur me marrjen e masave penalizuese kundrejt Anëtarit ALSE për të cilin ka konstatime që ka kryer shkelje në bazë të kësaj Rregullore si dhe rregullave dhe Udhëzimeve të tjera të miratuara nga ALSE.

11401/2 Kërkesa drejtuar Komitetit të Disiplinës duhet të përmbajë faktet dhe provat që vërtetojnë ekzistencën e shkeljes së kryer nga Anëtari ALSE kundër të cilit do të merren apo propozohen (Këshillit Mbikëqyrës ALSE) masat penalizuese në bazë të kësaj Rregulloreje si dhe Rregulloreve, Udhëzimeve të miratuara nga ALSE.

11401/3 Kërkesa duhet të përfshijë të paktën elementet e mëposhtme:

- emrin/adresën e Anëtarit të ALSE që ka kryer shkeljen;
- llojin e shkeljes;
- bazën ligjore ku bazohet konstatimi për shkeljen e kryer nga Anëtari ALSE;
- propozimin lidhur me masën shtrënguese për t'u aplikuar;

SEKSIONI 11.5. SEANCAT E PANELIT TË KOMITETIT TË DISIPLINËS

Neni 11501 SEANCAT E KOMITETIT TË DISIPLINËS

11501/1 Pas paraqitjes së kërkesës nga Administratori i ALSE anëtarët e Komitetit të Disiplinës nisin punën për shqyrtimin e çështjes dhe marrjen e vendimit rreth masës apo propozimit për marrjen e masës penalizuese lidhur me Anëtarin ALSE të pretenduar si shkelës.

11501/2 Mbledhjet e Komitetit të Disiplinës zhvillojnë punime dhe marrin vendime me prezencën minimalisht të 3/5 të gjithë anëtarëve të Komitetit të Disiplinës. Në rastet kur nuk përmbushet kuorumi për zhvillimin e punimeve dhe marrjen e vendimeve, mbledhjet e Komitetit të Disiplinës do të shtyhen për një datë tjetër e cila nuk do të jetë më e vonë se 5 ditë pune pas datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes së parë.

11501/3 Gjatë mbledhjes së Komitetit të Disiplinës, Anëtari ALSE për të cilin është konstatuar se ka kryer shkelje, ka të drejtë të dorëzojë çdo dokument që e konsideron të rëndësishëm për sqarimin e situatës apo kundërshtimin e konstatimeve të shkeljes që janë bërë ndaj tij, përpara se të përgatitet propozimi për Këshillin Mbikëqyrës të ALSE.

Neni 11502 PROCESVERBALI

Procesverbali i mbledhjes së Komitetit të Disiplinës duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, mosnëshkrimi i procesverbalit nga cilido prej pjesëmarrësve në seancën e Komitetit të Disiplinës nuk do të sjellë pavlefshmërinë e tij.

SEKSIONI 11.6. VENDIMI I KOMITETIT TË DISIPLINËS

Neni 11601 VENDIMI I KOMITETIT TË DISIPLINËS

11601/1 Vendimi i Komitetit të Disiplinës duhet të merret jo më vonë se 2 ditë pune nga data e nisjes së mbledhjes. Në vendimin e Komitetit të Disiplinës tregohet data në të cilën është marrë vendimi dhe koha kur bëhet efektive masa penalizuese e vendosur.

11601/2 Vendimet e Komitetit të Disiplinës janë të vlefshme kur merren me vendimin e shumicës së anëtarëve pjesëmarrës në mbledhjen e Komitetit të Disiplinës. Në rastet kur vendimarrja e

anëtarëve të Komitetit të Disiplinës është në barazim votash, vota e kryetarit të Komitetit të Disiplinës do të prevalojë për caktimin e anës fituese.

11601/3 Vendimi i Komitetit të Disiplinës duhet të jetë në përputhje me Ligjet Shqiptare, Rregulloren dhe procedurat ALSE në fuqi, si dhe në veçanti me Rregulloren e Penaliteteve në Bursën ALSE.

11601/4 Vendimi i Komitetit të Disiplinës i përcillet palëve të interesuara dhe atyre që në bazë të Ligjeve Shqiptare në fuqi do duhet të kenë dijeni, me shkrim dhe i arsyetuar së bashku me bazën ligjore ku Komiteti i Disiplinës është bazuar për marrjen e këtij vendimi.

11601/5 Vendimi i Komitetit të Disiplinës i komunikohet palëve të interesuara të përmendura në pikën 11601/4 vetëm nga Bursa ALSE pasi vendimi të jetë dorëzuar nga sekretari i Komitetit të Disiplinës në protokollin e Bursës ALSE.

SEKSIONI 11.7. SHPENZIMET DHE TARIFAT E PROCEDURËS SË KOMITETIT TË DISIPLINËS

Neni 11701 PËRGJEGJËSIA PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KOMITETIT TË DISIPLINËS

11701/1 Çelja e punimeve të Komitetit të Disiplinës do të sjellë detyrimin palëve të cilat janë pjesë e shqyrtimit të çështjes në Komitet për pagesën e tarifave të Komitetit të Disiplinës sipas (Shtojca 6).

11701/2 Tarifat e Komitetit të Disiplinës përfshijnë tarifën e anëtarëve, sekretarit të Komitetit të Disiplinës dhe shpenzimet administrative të saj. Tarifat e Komitetit të Disiplinës miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës i ALSE (Shtojca 6).

11701/3 Në vendimin e Komitetit të Disiplinës, vendoset se cila palë do të ketë detyrimin për të mbuluar shpenzimet e Komitetit të Disiplinës ose vendos t'i ndajë ato ndërmjet palëve. Mospagimin i këtyre tarifave do të përbente shkelje nga ana e Anëtarit mospagues. ALSE është përgjegjëse për ndjekjen e shkeljeve të Anëtarëve të referuara sipas këtij Neni, si dhe arkëtimin e shumave të cilat duhet të ishin siguruar më parë.

SEKSIONI 11.8. RËNDËSIA E VENDIMIT TË KOMITETIT TË DISIPLINËS

Neni 11801 ZBATIMI I VENDIMIT TË KOMITETIT TË DISIPLINËS

11801/1 Vendimet e Komitetit të Disiplinës janë të detyruara që të zbatohen nga të gjithë Anëtarët e ALSE.

11801/2 Vendimet e Komitetit të Disiplinës të cilat në bazë të kësaj Rregulloreje dhe Rregullores së Penaliteteve në Bursën ALSE janë në kompetencë të Këshillit Mbikëqyrës ALSE, nuk janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga Anëtarët ALSE pa u miratuar paraprakisht në formën përfundimtare që Këshilli Mbikëqyrës ALSE vendos.

11801/3 Vendimi i Komitetit të Disiplinës mund të apelohej në Komisionin e Arbitrazhit. Komisioni i Arbitrazhit është organi përgjegjës për shqyrtimin e mosmarrveshjeve ndërmjet Anëtarëve të ALSE kundrejt njëri-tjetrit si dhe vetë ALSE.

Neni 11802

Komiteti i Disiplinës raporton 1 (një) herë në 6 (gjashtë) muaj në Këshillin Mbikëqyrës ALSE lidhur me veprimtarinë e organit për rastet e shqyrtuara, Anëtarët shkelës, llojet e shkeljeve më të shumta si dhe llojet e rasteve të cilat krijohen më shumë mosmarrëveshje me palëve. Raporti gjithashtu do të përmbajë dhe rekomandime lidhur me ndryshimet e mundshme në Rregullore dhe procedurat ALSE që Komiteti i Disiplinës i shikon si të arsyeshme, për të zhvilluar dhe përmirësuar tregun ALSE.

Neni 11803

ALSE do të nxjerrë një Udhëzim të veçantë, ku do të rregullojë procedurat për mbledhjen, marrjen e vendimeve, kuorumin, si dhe çdo çështje tjetër të nevojshme, e cila ka nevojë për tu rregulluar dhe që nuk është përmendur në Kapitullin 11 të kësaj Rregullore.

Shtojca 1: Marrëveshje Pranimi për Anëtarësim në Bursa Shqiptare e Titujve ALSE

**MARRËVESHJE PRANIMI PËR ANËTARËSIM NË
BURSA SHQIPTARE E TITUJVE ALSE**

Emërtimi i Aplikantit për Anëtar: _____

NUIS: _____

Nr. i licencës lëshuar nga AMF: _____

Në lidhje me aplikimin për Anëtarësim në ALSE, dhe në rast se ky aplikim miratohet nga ALSE, Aplikanti pranon dhe merr përsipër të zbatojë kushtet dhe afatet e mëposhtme.

Aplikanti që anëtarësohet në ALSE merr përsipër dhe pranon:

1. Të zbatojë legjislacionin shqiptar të titujve në përgjithësi dhe rregulloret, njoftimet apo udhëzimet e ALSE si edhe vendimet e marra apo penaltetet e vendosura nga ALSE, siç mund të ndryshohen herë pas here nga ALSE;
2. Ta paguajë në kohën e duhur të gjitha tarifat dhe detyrimet e anëtarit siç llogariten nga ALSE në përputhje me rregullore dhe kushtet e saj, siç mund të ndryshohen herë pas here nga ALSE;
3. Të plotësojë të gjitha detyrimet e tjera të Anëtarit të ALSE të renditura në Seksionin 2.4 të rregullores së ALSE.

Përveç sa më sipër, Anëtari si edhe përfaqësuesi i tij që nënshkruan këtë marrëveshje, deklarojnë se informacioni i dhënë në Formularin e Aplikimit është i plotë dhe i saktë se dhe çdo ndryshim i këtij informacioni do t'i njoftohet menjëherë ALSE me shkrim. Përfaqësuesi që nënshkruan këtë marrëveshje deklaron gjithashtu se ka zotësi të plotë për të nënshkruar këtë marrëveshje dhe Formularin e Aplikimit në emër dhe për llogari të Aplikantit.

Data : _____

Plotësuar nga : _____

Pozicioni : _____

Nënshkrimi : _____

Drejtori Ekzekutiv

(vula)

Shtojca 1.1: Formular Aplikimi për Anëtarësim në Bursa Shqiptare e Titujve ALSE

**FORMULAR APLIKIMI PËR ANËTARËSIM NË
BURSA SHQIPTARE E TITUJVE ALSE**

Shoqëritë komisionere që kërkojnë të anëtarësohen pranë ALSE duhet të plotësojnë Formularin e Aplikimit dhe ta dorëzojnë atë së bashku me dokumentacionin (original ose të njëzuar me origjinalin) e kërkuar sipas formularit më poshtë në përputhje me Nenin 2301/1 (i) të Rregullores së ALSE.

Shoqërive komisionere që kërkojnë të anëtarësohen pranë ALSE, u kërkohet të përditësojnë çdo informacion apo dokument të paraqitur si pjesë e procesit të aplikimit. Për çdo informacion i cili do të rezultoj të jetë i pasaktë apo i paplotë pas dorëzimit të aplikimit, do të kërkohen informacione shtesë. Çdo aplikim duhet të shoqërohet me mandat pagesën, që vërteton kryerjen e pagesës të tarifës së aplikimit në ALSE.

Aplikimet e plotësuara duhet të dërgohen në të dyja format e mëposhtme:

- Postë elektronike në adresën: anetaresimi@alse.al
- Dorazi/Postë pranë: Bursa Shqiptare e Titujve ALSE, Rr.Nikolla Tupe,Nr.1,Kati 3,Ap.3.

FORMULAR APLIKIMI PËR ANËTARËSIM NË ALSE

A. Informacion i Përgjithshëm mbi Shoqërinë Komisionere	
Emri i Shoqërisë Komisionere	-----
Administratori	-----
Fusha e Aktivitetit	-----
Origjina Kapitalit (vendas/ i huaj)	-----
Nr. NUIS	-----
Nr. dhe Data Licencës nga AMF	-----
Nr. i Brokerave të Bursës	-----
Adresa e Selisë	-----
Tel./Faks	-----
Faqja e Internetit	-----
Posta Elektronike	-----
B. Brokerat e Bursës:	C. Personi i Kontaktit për Aplikimin:
Brokëri 1	Emër
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Mbiemër
<i>Nr. Licencës nga AMF</i>	Pozicioni
<i>Data licencës nga AMF</i>	Tel/Fax
<i>Brokëri ETS</i>	E-mail

Brokeri 2 _____ <i>Fusha e Aktivitetit</i> _____ <i>Nr. Licencës nga AMF</i> _____ <i>Data licencës nga AMF</i> _____ <i>Broker ETS</i> _____	Shënime _____ _____ _____
---	------------------------------------

D. Llojet e Tregjeve dhe Titujt (vendosni kryq mbi të gjitha opsionet që do zbatohen)

Shënoni llojin e tregut për të cilin aplikoni: <input type="checkbox"/> Tregu Zyrtar Kryesor; <input type="checkbox"/> Tregu Zyrtar Standard; <input type="checkbox"/> Tregu Hyrës; <input type="checkbox"/> Të gjithë Tregjet.	Shënoni llojin e anëtarësimit bazuar në titujt që do të tregtoni: <input type="checkbox"/> GSM - Anëtar në Titujt të Emetuar nga Qeveria; <input type="checkbox"/> ESM - Anëtar në Titujt e Kapitalit; <input type="checkbox"/> DSM - Anëtar në Titujt e Borxhit; <input type="checkbox"/> OSM - Anëtar në Titujt të Tjerë; <input type="checkbox"/> ASM - Anëtar në të Gjithë Titujt.
---	---

E. Natyra e Anëtarësimit (vendosni kryq mbi të gjitha opsionet që do zbatohen)

Shënoni llojin e anëtarësimit sipas pjesëmarrjes për të cilin aplikoni: <input type="checkbox"/> Anëtar i Drejtpërdrejtë; <input type="checkbox"/> Anëtar Sponsorizues; <input type="checkbox"/> _____	Shënoni llojin e anëtarësimit sipas personit për të cilin do të kryeni veprime: <input type="checkbox"/> Në emër e për llogari të vetë Anëtarit; <input type="checkbox"/> Në emër e për llogari të klientëve të Anëtarit; <input type="checkbox"/> Në emër/llogari të Anëtarit dhe klientëve të tij
---	--

F. Brokerat e Platformës ETS

<u>Brokeri i ETS</u>	<u>Lloji i Tregut</u>	<u>Lloji i Anëtarit</u>	<u>Tregtim për Llogari</u>	<u>Provimi ETS</u>
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____

G. Klerimi & Shlyerja (plotëso të dhënat në opsionin e zbatueshëm)

Për Titujt e emetuar nga Qeveria Shqiptare dhe Banka e Shqipërisë: <input type="checkbox"/> Aplikon si Pjesëmarrës i Drejtpërdrejtë/Tërthortë: Nr. i llogarisë në AFISAR: _____ Data e anëtarësimit si Pjesëmarrës i Drejtpërdrejtë/Tërthortë në AFISAR: _____/_____/_____ (DD/MM/YYYY) <input type="checkbox"/> Aplikon nëpërmjet një Anëtari CSM, i cili është Pjesëmarrës i Drejtpërdrejtë/Tërthortë në AFISAR Identifikimi i Anëtarit Klerues e Shlyerës (CSM) në AFISAR: _____	Për Titujt e tjerë: <input type="checkbox"/> Aplikon si Anëtar CSM: Nr. i llogarisë në ALREG: _____ Data e anëtarësimit si Anëtar Klerues e Shlyerës (CSM) në ALREG: ____/____/_____ (DD/MM/YYYY) <input type="checkbox"/> Aplikon nëpërmjet një Anëtari CSM Identifikimi i Anëtarit Klerues e Shlyerës (CSM) në ALREG: _____
---	--

Data e nënshkrimit të kontratës me anëtarin CSM, i cili është pjesëmarrës i Drejtpërdrejtë/Tërthortë në AFISAR (CSM) : ___/___/___ (DD/MM/YYYY)	Data e nënshkrimit të kontratës së pjesëmarrjes të tërthortë në ALREG: ___/___/___ (DD/MM/YYYY)
--	---

H. Lista e Dokumentacionit të Kërkuar për Anëtarësim (origjinale ose kopje e njëzuar)

- Marrëveshja për Anëtarësim në ALSE e nënshkruar nga Administratori i shoqërisë që aplikon
- Kopje e këtij Formulari Aplikimi e nënshkruar nga personi përgjegjës i shoqërisë që aplikon
- Ekstrakt historik nga QKB lëshuar për Aplikantin jo më shumë se një javë para datës së aplikimit
- Kopje e licencës së Aplikantit lëshuar nga Autoriteti Kompetent për të kryer transaksione me tituj
- Kopje e licencave të Brokerave të Bursës të Aplikantit, lëshuar nga Autoriteti Kompetent
- Kopje të kontratës/autorizimit të lidhur ndërmjet Aplikantit dhe Brokerit të Bursës së nominuar prej tij
- Kopje të rezultatit të Provimit të ETS për Brokerat e Bursës
- Kontrata e Aplikantit me klientët të tij, në emër dhe për llogari të të cilëve do tregtojnë tituj
- Kontrata e Aplikantit me anëtarin klerues dhe shlyerës (CSM) për klerimin dhe shlyerjen e titujve sipas llojit në AFISAR/ALREG
- Marrëveshja me AFISAR/ALREG për llogaritë në tituj të Aplikantit
- Kopje e NUIS të Aplikantit
- Kopje e vërtetimit që Aplikanti ka paguar detyrimet fiskale
- Dokument që vërteton pagesën e detyrimeve financiare për anëtarësimin në ALSE.
-
-

I. Instruksione për Plotësimin e Aplikimit

Ju lutemi sigurohuni t'i bashkëngjitni aplikimit tuaj të gjithë dokumentacionin e listuar në pikën H më sipër. Mangësi në dokumentacion mund të vonojnë shqyrtimin e aplikimit tuaj. Aplikimet janë konfidenciale dhe trajtohen në mjedise të sigurta.

Ju lutemi të keni parasysh se konform rregullores së ALSE. Ju do të duhet t'i paraqisni ALSE çdo informacion apo dokument tjetër që kjo e fundit mund të gjykojë të arsyeshëm për të shqyrtuar aplikimin tuaj.

Nëse keni pyetje për plotësimin e këtij formulari, mund t'i adresoni ato tek personat përgjegjës të ALSE në e-mailin anetaresimi@alse.al. Për çdo paqartësi lidhur me procesin e aplikimit mund t'i referoheni edhe hapësirës elektronike të ALSE www.alse.al.

Data : -----
 Plotësuar nga : -----
 Pozicioni : -----
 Nënshkrimi : -----

Drejtori Ekzekutiv

(vula)

Shtojca 2: Komisione dhe Tarifa të Bursa Shqiptare e Titujve ALSE (në LEK)

Shpjegimi	E	GB	CB	IF	O
Tarifa për Dorëzimin e Aplikimit	7,000		7,000	7,000	7,000
Komisione dhe Tarifat e Listimit					
<i>Tarifë Fillestare Listimit</i>	280,000	-	280,000	280,000	140,000
<i>Tarifë vjetor për Tregun Hyrës</i>	150,000	-	150,000	150,000	150,000
<i>Komision Vjetor i pjesmarrjes në tregëtim</i>	0.05%	-	0.05%	0.70%	0.40%
<i>Komision për Rritjen e Kapitalit (% mbi kapitalin e rritur)</i>	0.05%	-	0.05%		
<i>Tarifë mbi Emetimin fillestar (kodifikimi i titullit)</i>	70,000	-	70,000	49,000	49,000
<i>Tarifë mbi ndryshimin e emrit të kompanisë/(kodifikim i titullit)</i>	14,000	-	14,000	14,000	14,000
Komisione dhe Tarifat e Anëtarit					
<i>Tarifë Aplikimi për Anëtarësim (një herë)</i>	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000
<i>Tarifë Vjetore e Anëtarësisë (maksimumi)</i>	210,000	105,000	105,000	140,000	140,000
<i>Komision mbi Vlerën e Tregtimit vjetor</i>	0.025%	0.005%	0.015%	0.30%	0.20%
<i>Tarifë e Testimit Fizik të Brokerave</i>	14,000	14,000	14,000	14,000	14,000
<i>Tarifë e Pezullimit të Përkohshëm të Anëtarit</i>	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000
Komisione dhe Tarifat e Transaksionit					
<i>Tarifë Fikse Vjetore e Tregtimit (për çdo broker individual)</i>	49,000	35,000	35,000	28,000	28,000
<i>Tarifë Fikse për Urdhrat e Ekzekutuar (për çdo transaksion)</i>	100	100	100	100	100
<i>Tarifë mbi Anullimin e tregtimit (për çdo transaksion)</i>	7,000	7,000	7,000	7,000	7,000
<i>Tarife mbi ndryshimin e tregtimit (për çdo transaksion)</i>	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400
<i>Komision mbi Urdhrat Normal të Ekzekutuar (për çdo transaksion)</i>					
<i>0-1,000,000 ALL</i>	0.20%	0.05%	0.12%	0.08%	0.08%
<i>1.000.001-10.000.000 ALL</i>	0.16%	0.04%	0.10%	0.08%	0.08%
<i>10.000.001 < ALL</i>	0.12%	0.03%	0.08%	0.08%	0.08%
<i>Komision mbi tregtimin në Bllok (për çdo transaksion)</i>	0.1%	0.02%	0.06%	0.08%	0.08%
<i>Komisione mbi Tregtimin e Kryqëzuar të negociuar (për çdo transaksion)</i>	0.25%	0.05%	0.15%	0.15%	0.15%
<i>Komisione mbi tregtimin jashtë burse (për çdo transaksion)</i>	0.25%	0.05%	0.15%	0.15%	0.15%
Tarifat e Aksesimit të Sistemit					
<i>Tarifë për Instalimin e Aksesit në ETS (për çdo broker individual)</i>	49,000	35,000	35,000	49,000	49,000
<i>Tarifë Vjetore e Aksesit në ETS (për çdo broker individual)</i>	49,000	35,000	35,000	49,000	49,000
<i>Tarifë Vjetore e Aksesit në ETS (vetëm lexim i ekranit)</i>	28,000	28,000	28,000	28,000	28,000
<i>Tarifë e Pezullimit të Përkohshëm nga Tregtimi (për çdo broker individual)</i>	21,000	21,000	21,000	21,000	21,000

Tarifë e Pezullimit të Përkohshëm nga Tregtimi (për çdo firmë brokerimi)	42,000	42,000	42,000	42,000	42,000
Tarifat e Raportimit					
Raporti i Tregtimit (për çdo firmë brokerimi /ditore)	420	420	420	420	420
Raporti i të Dhënave Historike (për çdo dosje ose vjetore)	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400
Raporti i Performancës Ditore të Emetuesit (vjetore)	700	700	700	700	700
Raporti i Performancës Mujore të Emetuesit (vjetore)	4,200	4,200	4,200	4,200	4,200
Raporti i të Dhënave ISIN (web/vjetore)					
Tarifat e Inspektimit					
Kontrulli i Prospektusit dhe Dokumentave të listimit	14,000	14,000	14,000	14,000	14,000
Tarifa mbi Blerjen me Bashkim, Blerjen me Përthithje dhe Bashkimi, Blerja dhe Ndarja e Kompanive	70,000				
Shërbime të Tjera					
Tarifat e Shpërndarjes së të Dhënave (për median dhe investitorët)					
Instalimi dhe Lidhja Fillestare (një herë)	49,000	49,000	49,000	49,000	49,000
Lidhja Teknike Vjetore (vjetore)	49,000	49,000	49,000	49,000	49,000
Informacion mbi Tarifat e Tregut në Kohë Reale (vjetore)	105,000	105,000	105,000	105,000	105,000
Lajme në Kohë Reale nga Emetuesit (për media/vjetore)	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000
30" Vonesë në Aksesin e të Dhënave të Tregut (në media)	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000
Tarifa e Aksesimit në Nivel Profesional (për përdorues/vjetor)	28,000	28,000	28,000	28,000	28,000
Tarifa e Aksesimit në Nivel Individual (për përdorues/vjetor)	3,500	3,500	3,500	3,500	3,500
Të Dhëna mbi Peshën e Indekseve (për kompanitë/vjetor)	14,000				
Të Dhëna mbi Fundin e Ditës së Tregtimit (për përdorues/vjetor)	700	700	700	700	700
Lista e Çmimeve Zyrtare Ditore (vjetor)	49,000	49,000	49,000	49,000	49,000
Shpërndarja e Informacioneve Kryesore për Emetuesin në 24 orë(vjetore)	14,000	14,000	14,000	14,000	14,000
Shpërndarja e Lajmeve Pa Limit nga Emetuesi (vjetor)	35,000	35,000	35,000	35,000	35,000
Informacion për Emetuesin në Lidhje me Çmimet e Titujve të Tij (vjetor)	14,000	14,000	14,000	14,000	14,000

1. E = Tituj kapitali, GB = Tituj Borxhi Qeveritar, CB = Tituj Borxhi Privat,, IF = Fonde investimi, O = Të tjera
2. Tarifat e Listimit të Titujve të Borxhit janë të llogaritura për çdo kod ISIN .
3. Tarifat e aksesit në sistem janë të llogaritura për çdo Firmë Brokerim apo Broker Fizik të lejuar për këtë akses në sistem.
4. Çmimet e raporteve janë të llogaritura sipas faqeve të raporteve (450 LEK/faqja).

5. Transaksionet tregtare janë të llogaritura në bazë të volumit të tregimit për çdo transaksion dhe për çdo palë në transaksion.
6. Sipas Ligjit të Titujve, letrat me vlerë të qeverisë (Bonot e Thesarit dhe Obligacionet e Thesarit), listohen pa ndonjë tarifë.
7. Komisionet dhe tarifat janë të shprehura në vlera pa TVSH.
8. Tarifat e anëtarësimit në ALSE për subjektet që do të anëtarësohen pas datës 1 Korrik të çdo viti do të paguajnë gjysmën e tarifës vjetore.

Shtojca 2.1: Përmbledhje e Komisioneve dhe Tarifave sipas Kategorisë së Anëtarësimit

Tarifa Anëtarësimi (fikse)

Kategoritë e Anëtarësimit në ALSE	Aplikimi	Vjetore/Firma Brokerimi	Provimi/Broker	Total
GSM	70,000	105,000	14,000	189,000
DSM		210,000		294,000
ESM		210,000		294,000
OSM		140,000		224,000
ASM		300,000		384,000

Tarifa Tregtimi (fikse)

Kategoritë e Anëtarësimit në ALSE	Vjetore/Broker
GSM	35,000
DSM	70,000
ESM	49,000
OSM	28,000
ASM	100,000

Tarifa Tregtimi (operationale)

Kategoritë e Anëtarësimit në ALSE	Komisione për transaksion
GSM	0.02% - 0.05%
DSM	0.06% - 0.15%
ESM	0.10% - 0.25%
OSM	0.08% - 0.20%
ASM	0.01% - 0.20%

Tarifa Aksesimi (fikse)

Kategoritë e Anëtarësimit në ALSE	Instalimi/PC	Vjetore/Broker	Vjetore/Firma Brokerimi	Total
GSM	35,000	35,000		70,000
DSM	70,000	70,000		140,000
ESM	49,000	49,000		119,000
OSM	49,000	49,000		98,000
ASM	100,000	100,000		200,000

Tarifa totale për Firmat e Brokerimit (fikse)

Kategoritë e Anëtarësimit në ALSE	Dorëzim Aplikimi	Anëtarësim	Tregtim	Akses në ETS	Total
GSM	7,000	189,000	35,000	70,000	301,000
DSM		294,000	70,000	140,000	511,000
ESM		294,000	49,000	119,000	469,000
OSM		224,000	28,000	98,000	357,000
ASM		384,000	100,000	200,000	691,000

Shtojca 4: Marrëveshje Pranimi për Listim/Tregtim në Bursa Shqiptare e Titujve ALSE

**MARRËVESHJE PRANIMI PËR LISTIM/TREGTIM NË
BURSA SHQIPTARE E TITUJVE ALSE**

Emërtimi i Shoqërisë Emetuese: _____

NUIS: _____

Klasa e Titujve që do Emetohen (*shënjo mbi klasat e mëposhtme*):

Tituj Kapitali Tituj Borxhi Fonde Investimi Tituj të tjerë të transferueshëm

Në lidhje me aplikimin për Listim/Tregtim në ALSE, dhe në rast se ky aplikim miratohet nga ALSE, Aplikanti pranon dhe merr përsipër të zbatojë kushtet dhe afatet e mëposhtme.

Aplikanti që listohet/tregtohet në ALSE merr përsipër dhe pranon:

1. Të zbatojë legjislacionin shqiptar të titujve në përgjithësi dhe rregulloret, njoftimet apo udhëzimet e ALSE-s si edhe vendimet e marra apo penalitetet e vendosura nga ALSE, siç mund të ndryshohen herë pas here nga ALSE;
2. Ta paguajë në kohën e duhur të gjitha tarifat dhe detyrimet e emetuesit siç llogariten nga ALSE në përputhje me rregulloren dhe kushtet e saj, siç mund të ndryshohen herë pas here nga ALSE;
3. Të plotësojë të gjitha detyrimet e tjera të Emetuesit të ALSE të renditura në Seksionin 6 të rregullores së ALSE.

Përveç sa më sipër, Emetuesi si edhe përfaqësuesi i tij që nënshkruan këtë marrëveshje, deklarojnë se informacioni i dhënë në Formularin e Aplikimit për Listim/Tregtim është i plotë dhe i saktë si dhe çdo ndryshim i këtij informacioni do t'i njoftohet menjëherë ALSE-s me shkrim. Përfaqësuesi që nënshkruan këtë marrëveshje deklaron gjithashtu se ka zotësi të plotë për të nënshkruar këtë marrëveshje dhe Formularin e Aplikimit për Listim/Tregtim në emër dhe për llogari të Emetuesit.

Data : _____
Plotësuar nga : _____
Pozicioni : _____
Nënshkrimi : _____

Drejtori Ekzekutiv

(vula)

Shtojca 4.1: Formular Aplikimi për Listim/Tregtim në Bursa Shqiptare e Titujve ALSE

FORMULAR APLIKIMI PËR LISTIM/TREGTIM BURSA SHQIPTARE E TITUJVE ALSE

Emetuesit që kërkojnë të listohen/tregtohen pranë ALSE duhet të plotësojnë Formularin e Aplikimit për Listim/Tregtim dhe ta dorëzojnë atë së bashku me dokumentacionin (origjinal ose të njësuar me origjinalin) e kërkuar sipas formularit më poshtë në përputhje me Nenin 6201 të Rregullores së ALSE.

Emetuesve që kërkojnë të listohen/tregtohen pranë ALSE u kërkohet të përditësojnë çdo informacion apo dokument të paraqitur si pjesë e procesit të aplikimit. Për çdo informacion i cili do të rezultojë të jetë i pasaktë apo i paplotë pas dorëzimit të aplikimit do të kërkohen informacione shtesë. Çdo aplikim duhet të shoqërohet me mandat pagesën që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës së aplikimit në ALSE.

Aplikimet e plotësuara duhet të dërgohen në të dyja format e mëposhtme:

- Postë elektronike në adresën: listimi@alse.al;
- Dorazi/Postë pranë: Bursa Shqiptare e Titujve ALSE, Rr.Nikolla Tupe, Nr.1,Kati 3, Ap. 3.

FORMULAR APLIKIMI PËR LISTIM/TREGTIM NË ALSE

A. Informacion i Përgjithshëm Mbi Emetuesin	
Emri i Shoqërisë Emetuese:	-----
Forma Ligjore:	-----
Administratori:	-----
Aksionerët (ndarja në përqindje):	1. ----- 2. ----- 3. ----- 4. Lista Bashkangjitur
Adresa e Selisë Qëndrore të Shoqërisë në Shqipëri :	-----
Fusha e Aktivitetit:	-----
Origjina Kapitalit (vendas/ i huaj):	-----
Nr. NUIS:	-----
Tel./Faks:	-----
Faqja e Internetit:	-----
Posta Elektronike:	-----
B. Agjenti i Listimit/Tregtimit :	C. Emetuesi (Pika e Kontaktit të Emetuesit)
Emër: -----	Emër: -----
Mbiemër: -----	Mbiemër: -----
Institucioni: -----	Pozicioni: -----
Pozicioni: -----	Tel/Fax: -----
Tel/Fax: -----	E-mail: -----
E-mail: -----	-----

D. Qëllimi i Emetimit (shënjonit mbi opsionet që do zbatohen):		
<input type="checkbox"/> Listim	<input type="checkbox"/> Tregtim	<input type="checkbox"/> Listim dhe Tregtim
E. Lloji i Emetimit (shënjonit mbi opsionet që do zbatohen):		
<input type="checkbox"/> Ofertë Publike Fillestare IPO	<input type="checkbox"/> Ofertë Publike Sekondare SPO	
F. Llojet e Tregjeve Dhe Titujt (shënjonit mbi opsionet që do zbatohen):		
<input type="checkbox"/> Tregu Zyrtar Kryesor (niveli I)	<input type="checkbox"/> Tregu Zyrtar Standard (niveli II)	<input type="checkbox"/> Tregu Hyrës
G. Klasat e Instrumentit Të Emetuar (shënjonit mbi opsionet që do zbatohen):		
<input type="checkbox"/> TITUJ BORXHI		
<input type="radio"/> Publik <input type="radio"/> Tituj Afatshkurtër të BSH ____ (muaj) <input type="radio"/> Obligacione bashkiake ____ (muaj/vite) <input type="radio"/> Të Tjera _____ (specifiko)		<input type="radio"/> Privat <input type="radio"/> Letra Tregtare ____ (muaj) <input type="radio"/> Obligacione të konvertueshëm ____ (vite) <input type="radio"/> Obligacione korporate ____ (vite) <input type="radio"/> Obligacione Hipotekore ____ (vite)
<input type="checkbox"/> TITUJ KAPITALI	<input type="checkbox"/> FONDET E INVESTIMEVE	<input type="checkbox"/> TITUJ TË TJERË TË TRANSFERUESHËM
<input type="radio"/> Aksione <input type="radio"/> Dividend <input type="radio"/> Garancitë	<input type="radio"/> Fonde të Hapura (Open End Funds) <input type="radio"/> Fonde të Mbyllura (Closed-End Funds) <input type="radio"/> ETFs	<input type="radio"/> _____ <input type="radio"/> _____ <input type="radio"/> _____
H. Detaje Të Llojit Të Titullit Që Do Listohet/Tregtohet		
Emërtimi i Titullit që do të listohet/tregtohet:	_____	
Numri i Titujve që do të Listohen/Tregtohen:	_____	
Vlera Nominale e Titullit që do të Listohet/tregtohet:	_____	
Monedha në të cilën do të listohen/tregtohen:	_____	
Çmimi i Propozuar i Listim/Tregtim-it	_____	
Data e maturimit (nëse ka):	_____	
I. Detaje të Llojit të Titullit të Listuar më Parë në një Ofertë Private (në qoftë se ka pasur një të tillë)		
Lloji i Titullit që Emetuar:	_____	
Numri i Titujve që janë Emetuar:	_____	
Vlera Nominale e Titullit që është Emetuar:	_____	
Monedha në të cilën është Emetuar:	_____	
Çmimi me të cilin është Emetuar:	_____	
Data e Maturimit (nëse ka):	_____	
J. Lista e Dokumentacionit të Kërkuar për Listim/tregtim (originale ose kopje e njësuar)		
<input type="checkbox"/> Aplikim me shkrim, duke përdorur formularin standard të miratuar nga ALSE (Shtojca 2 bashkëlidhur) <input type="checkbox"/> Marrëveshje Listim/Tregtim, duke përdorur marrëveshjen standard të miratuar nga ALSE (Shtojca 1 bashkëlidhur)		

- Kopje e kontratës së lidhur ndërmjet Aplikantit dhe Agjentit të tij për listim/tregtimin e parë (për atë klasë titujsh)
- Kopje e prospektit të miratuar nga AMF ose në rastë përjashtimi nga ky detyrim një dokument ekuivalent
- Kopje e vendimit nga organi ose organet përkatëse të Emetuesit që përmbajnë rezoluta të cilat autorizojnë aplikimin për pranim në listim dhe/ose tregtim, si dhe emetimin e Titujve
- Kontrata e Aplikantit me antarin klerues dhe shlyerës CSM apo ALREG (sipas rastit), për klerimin dhe shlyerjen e Titujve, apo veprimeve korporative dhe pagesave të dividendëve (nëse ka)
- Ekstrakt historik i përditësuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- Kopje e NUIS të Aplikantit.
- Kopje e vërtetimit që Aplikanti ka paguar detyrimet fiskale.
- Dokument që vërteton pagesën e detyrimeve financiare për listim/tregtim në ALSE.
-
-

K. Instruksione për Plotësimin e Aplikimit

Ju lutemi sigurohuni t'i bashkëngjitni aplikimit tuaj të gjithë dokumentacionin e listuar në pikën J më sipër. Mangësi në dokumentacion mund të vonojnë shqyrtimin e aplikimit tuaj. Aplikimet janë konfidenciale dhe trajtohen në mjedise të sigurta.

Ju lutemi të kini parasysh se konform rregullores së ALSE, Ju do të duhet t'i paraqisni ALSE çdo informacion apo dokument tjetër që kjo e fundit mund të gjykojë të arsyeshëm për të shqyrtuar aplikimin tuaj.

Nëse keni pyetje për plotësimin e këtij formulari, mund t'i adresoni ato tek personat përgjegjës të ALSE në emailin listimi@alse.al. Për çdo paqartësi lidhur me procesin e aplikimit mund t'i referoheni edhe hapësirës elektronike të ALSE www.alse.al.

Data : -----
 Plotësuar nga : -----
 Pozicioni : -----
 Nënshkrimi : -----

Drejtori Ekzekutiv

(vula)

Shtojca 5: Kostot e Arbitrazhit për t'u Paguar tek Bursa Shqiptare e Titujve ALSE nga Palët në Mosmarrëveshje

Nr.	Shpjegimi	Tarifa	Shënim
1	Aplikimi i një pretendimi në lidhje me një mosmarrëveshje mes palëve	5.000 ALL	Për palën aplikuese
2	Kostot Administrative	20.000 ALL	Për përpunimin e informacionit dhe përgatitjen e dokumentave për Komisionin e Arbitrazhit
3	Vendimi i Arbitrazhit që miraton një marrëveshje të arritur mes palëve (neni 7701)	10.000 ALL	Për secilin arbitër, pjesë e Komisionit të Arbitrazhit
4	Vendimi i Arbitrazhit (neni 7702)	15.000 ALL	Për secilin arbitër, pjesë e Komisionit të Arbitrazhit
5	Emetim i kopjes origjinale të Vendimit të Arbitrazhit	5.000 ALL	Për secilën palë

Shënim: Tarifat janë të shprehura në vlera pa TVSH.

Shtojca 6: Kostot e Komitetit të Disiplinës për t'u Paguar tek Bursa Shqiptare e Titujve ALSE nga Palët përkatëse

Nr.	Shpjegimi	Tarifa	Shënim
1	Kostot Administrative	20.000 ALL	Për përpunimin e informacionit dhe përgatitjen e dokumentave për Komitetin e Disiplinës
2	Vendimi i Komitetit të Disiplinës që miraton një marrëveshje të arritur mes palëve	5.000 ALL	Për secilin anëtarë, pjesë e Komitetit të disiplinës
3	Vendimi i Komitetit të Disiplinës	15.000 ALL	Për secilin anëtarë, pjesë e Komitetit të Disiplinës
4	Sekretari i Komitetit të Disiplinës	10.000 ALL	Nga secilia palë e Komitetit të Disiplinës
5	Emetim i kopjes origjinale të Vendimit të Komitetit të Disiplinës	5.000 ALL	Për palën kërkuese

Shënim: Tarifat janë janë të shprehura në vlera pa TVSH.
Bursa ALSE është e përjashtuar nga pagesa e Kostove Administrative.